



**BASHKITË PËR NË EVROPË**  
Një projekt i financuar nga BE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E BRENDSHME**

# **BASHKITË NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN**

**Raporti i Vlerësimit  
për Vitin 2019**

**Korrik 2020**





**BASHKITË PËR NË EVROPË**  
Një projekt i financuar nga BE




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E BRENDSHME**

# **BASHKITË NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN**

**Raporti i Vlerësimit për Vitin 2019**

**Korrik 2020**





Raporti i 3<sup>te</sup> thekson ecurinë e pushtetit vendor në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian për sa i përket realizimit gjatë të vitit 2019 detyrimeve në kuadër të kritereve dhe angazhimeve të procesit të integrimit evropian.

Njësitë e Integrimit Evropian në secilën bashki kanë koordinuar organizimin e brendshëm të grumbullimit të të dhënave ndërsa orientimi dhe monitorimi i procesit të raportimit është realizuar nga Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

#### **SHENIM**


Ky botim u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetem e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmeërisht pikeëpamjet e Bashkimit Evropian.






# Tabela e Përmbajtjes

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>9</b>
Hyrje .....	17
<b>I. KRITERI POLITIK.....</b>	<b>19</b>
1. DEMOKRACIA .....	20
1.1. Qeverisja .....	20
1.2. Avokati i Popullit.....	36
1.3. Shoqëria civile .....	37
1.4. Shteti i së drejtës.....	42
1.4.1. Lufta kundër korrupsionit .....	42
1.5. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave.....	46
<b>II. KRITERI EKONOMIK .....</b>	<b>53</b>
2.1 Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale.....	54
<b>III. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT .....</b>	<b>59</b>
3.1 Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi dhe rural .....	60
3.2. Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare.....	66
3.3 Kapitulli 14: Politika e transportit .....	69
3.4 Kapitulli 15: Energjia.....	75
3.5 Kapitulli 16: Taksat .....	79
3.6 Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi .....	82
3.7 Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumentave strukturorë.....	92
3.8 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore .....	95
3.9 Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria .....	113
3.10 Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura.....	116
3.11 Kapitulli 27: Mjedis dhe ndryshimi i klimës .....	126
3.12 Kapitulli 32: Kontrolli financiar .....	140



## SHKURTIME

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara në Shqipëri
SHBSH	Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
SHAV	Shoqata për Autonominë Vendore
PV	Plan Veprimi
RV	Raport Vjetor
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
NjA	Njësi Administrative
BE	Bashkimi Evropian
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
KK	Këshilli Konsultativ për vetë-Qeverisjen Vendore
KM	Këshilli i Ministrave
KE	Komisioni Evropian
SNRAP	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020
DPPS	Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale
ILKPKDI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PAK	Person me Aftësi të Kufizuara
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
NjQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
PKVIRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane 2016-2020
PVIRE	Plani Vendor për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane
QQ	Qeveria Qëndrore
QV	Qeveria Vendore
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTE	Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKVPAK	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë
PVMIM	Plan Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve
SNKDQV	Strategjia Ndërsektoriale Kombëtare e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2015-2020
SKEE	Strategjia Kombëtare për Eficiencën Energjike
SKPA	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022
ZIN	Qendra e Integruar me një Ndalesë
SSC	Sistemi i Sigurimit të Cilësisë
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asocimit
MIM	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve
RAT	Reforma Administrative Territoriale
SZHAP	Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020
GP	Grup Pune





## Përshëndetja e Z. Zef Mazi

**Kryenegociator i Shqipërisë  
në negociatat për Aderimin e Shqipërisë  
në Bashkimin Evropian**

Republika e Shqipërisë ka hyrë në një fazë kyçe historike në ecjen e saj drejt BE<sup>se</sup>. Pas vendimit politik të Këshillit Evropian në mars 2020 për hapjen e negociatave për aderimin e Shqipërisë në BE, pritet miratimi i kuadrit negociues dhe vendimi për mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare.


Qeverisja vendore ka rëndësi të vecantë në këtë proces. Ajo përbën element thelbësor në demokratizimin e vendit, në intensifikimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendim-marrëse. Pa një sistem solid, të qëndrueshëm, të efektshëm të qeverisjes vendore nuk mund të konsiderohet i plotë dhe thellësisht demokratik sistemi politik i vendit. Pushteti vendor luan rol kyç për zbatimin e kërkesave për përafrimin e legjislacionit tonë me legjislacionin Evropian dhe zbatimin e tij. Nuk është rastësi që rreth 70 përqind e legjislacionit të Bashkimit Evropian do të duhet të zbatohet saktë, në mënyrë të plotë dhe të drejtpërdrejtë nga pushteti vendor nga bashkitë. Analizat e deritanishme dhe përvojat e vendeve anëtare të BE<sup>se</sup> e konfirmojnë këtë realitet.

Vlerësimi i arritjeve të bashkive në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kërkesat për anëtaresimin e Shqipërisë flet qartë dhe saktë për këtë rol të rëndësishëm. Janë bërë hapa të ndjeshëm përpara, ndërkohë mbetet ende rrugë për të bërë. Raporti konfirmon ecurinë në zbatimin e legjislacionit të përfaruar të BE-se sipas fushave dhe funksioneve që mbulon qeverisja vendore.

Organet drejtuese të pushtetit vendor, Njësitë e Integritimit Evropian në secilën bashki, stafet e tyre, duhet dhe do të jenë gjithnjë e më shumë të vëtedijshëm për detyrimet dhe detyrat e vështira, por tepër frutdhënëse që do kryejnë në vijimësi. Sa më mirë dhe në kohë të jemi të përgatitur, aq me e lehtë rruga që do të përshkohet, më i shpejtë përafrimi, më e lartë thithja e fondeve të ndjeshme të BE<sup>se</sup> për ecjen përpara.

Shpreh optimizmin dhe bindjen se bashkitë, pushteti vendor, do ngrihen në lartësinë e momentit që, së bashku, të përballohen me sukses të plotë, në kohë gjithë sfidat dhe detyrimet. Përfitimi i gjithë komuniteteve do të jetë i madh, i ndjeshëm, i prekshëm.

Shqipëria ka bërë hapa cilësore përpara. Ajo ka përmbushur me qëndrueshmëri kriteret politike. Shqipëria ka ngritur Ekipin Negociator për negociatat për aderimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kapacitetin tim si Kryenegociator, angazhimi dhe mbështetja e strukturave që drejtojnë do jetë e plotë, profesionale, në kohë për gjithë bashkitë. Kjo do sigurojë që ky proces, në tërë gjerësinë e tij, dhe fokus në pushtetin vendor, të ecë përpara në mënyrë të harmonishme, të koordinuar mirë, pozitive, duke zgjidhur së bashku gjithë sfidat e këtij procesi madhor dhe jetik. Vetëm kështu do demonstron seriozitet maksimal dhe përkushtim për të ardhmen e vendit tonë në BE.







# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE


Raporti i tretë kombëtar i vlerësimit të arritjeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore përfshin arritjet për vitin 2019 në funksion të procesit të integritit evropian në fushat kryesore të cilat lidhen me kriterin politik, kriterin ekonomik dhe aftësinë për të realizuar detyrimet e anëtarësimit.

## KRITERI POLITIK

### Demokracia

**Janë bërë përpjekje për të përmirësuar koordinimin dhe procesin e konsultimit të projektligjeve dhe projektakteve mes qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore të cilat kanë ndikim në ushtrimin e funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet funksionimit efektiv të Këshillit Konsultativ (KK).** Në vitin 2019, janë realizuar 6 takime të KK, në të cilat është diskutuar për 6 projekt-ligje dhe 36 projekt-akte, dhe 10 programe dhe strategji sektoriale. Është konsoliduar institucionalizimi i procesit të konsultimit ndërmjet QQ dhe Vetëqeverisjes Vendore, ç'ka duket edhe në volumin më të madh të akteve të kaluara në KK (40% më shumë se në 2018), është siguruar mbledhja e mendimeve dhe propozimeve të bashkive mbi projektligjet dhe projektaktet para miratimit të tyre nga QQ, dhe është rritur transparenca e procesit të informimit dhe konsultimit duke përfshirë shoqatat e NJQV, si dhe konsultimin on-line të projekt akteve.

**Kanë vijuar përpjekjet për fuqizimin e kapaciteteve të administratës publike,** lidhur me zbatimin e legjislacionit për nëpunësin civil, koordinimin efektiv të proceseve me të gjitha njësitë e burimeve njerëzore për përmirësimin e procedurave dhe performancën e administratës publike, ristrukturimin i institucioneve të varësisë së Kryeministrit dhe ministrive të linjës (proçes në vijim). Ka përfunduar dhe është funksional portali i administratës publike [administrata.al](http://administrata.al), dhe është kryer trajnimi i 200 nëpunësve të menaxhimit të burimeve njerëzore (MBNJ) në të gjitha bashkitë e vendit. **Përmirësimi i sistemit të trajnimeve të ASPA ka qenë një tjetër objektiv i vazhdueshëm** gjatë 2019. Është zhvilluar manuali i hartimit të pyetjeve të testimit në ASPA, janë ofruar rekomandime për integrimin e 12 parimeve të qeverisjes së mirë të adoptuara nga Këshilli i Evropës në kurrikulat ekzistuese për administratën vendore, si dhe është hartuar një metodologji për futjen e sistemit të krediteve në ASPA. Mesatarja e nëpunësve vendore të trajnuar mbi legjislacionin e nëpunësit civil është më e lartë krahasuar me 2018, duke arritur në rreth 18 persona; gjithsej 1,693 nëpunës vendor të Bashkive kanë ndjekur programe trajnimi nga ASPA në fusha të ndryshme tematike. Qëndrueshmëria financiare për trajnimet mbetet një sfidë; niveli mesatar i fondit të shpenzuar nga bashkitë për trajnime ka qenë 0.39% i buxhetit vendor. Sfidat tjera mbeten përmirësimi i sistemeve të performancës për integrimin e objektivave të organizatës në tregues performance të strukturave / dhe shërbimeve të Bashkive, rritja e kapaciteteve të administratës publike në fushën e kompetencave funksionale, organizimi i trajnimeve në nxitjen e inovacionit në sektorin publik, dhe mundësia e organizimit të trajnimeve në nivel rajoni.



**Është përmirësuar përfaqësimi i femrave në organet drejtuese të bashkive dhe në pozicione drejtimi në administratën vendore.** 13% ishte shkalla e përfaqësimit të femrave në postin e Kryetarit të Bashkisë në 2019 mbas zgjedhjeve lokale të 2019, kundrejt 14.75% në vitin 2015, ndërsa mesatarja e përfaqësimit të femrave në pozicionin e nën Kryetarit të Bashkisë për të gjitha bashkitë ishte 34.9% në vitin 2019<sup>1</sup>; është rritur mesatarja e përfaqësimit të femrave në nivel vendi si anëtare të Këshillave Bashkiakë në 41.02% në 2019, krahasuar me 34.8% (në vitin 2015). **Në administratën vendore,** niveli i përfaqësimit të femrave me status të nëpunësit civil (NC) ishte 60.7% e numrit të përgjithshëm të nëpunësve civil të bashkive, në 2019, ndërsa numri gjithsej i femrave në pozicione drejtuese në administratën vendore ka qenë rreth 35.9 %

**Është rritur shkalla e dixhitalizimit të shërbimeve publike dhe siguruar një shtrirje më e madhe e qeverisjes elektronike në nivel vendor.** Në vitin 2019, qendrat e integruara me Një-Ndalesë (One-Stop-Shop) janë ngritur dhe veprojnë në 41 bashki (67% e bashkive), ose 18 % p.p. me shumë krahasuar me vitin 2019. Numri mesatar i shërbimeve të ofruara është në nivel të krahasueshëm me 2018. Objektiv në vijim është rritja e numrit të shërbimeve administrative që ofrohen nga zyrat OSSH, shtrirja e qendrave të integruara në të gjitha NJQV dhe edukimi qytetar për të kapërcyer hendekun dixhital.

**Transparenca e financave vendore evidenton ulje në tregues që lidhen me pjesëmarrjen qytetare.** Edhe pse 93.4% e bashkive raportojnë se kanë hartuar buxhetin e tyre me metodën me pjesëmarrje, duke shënuar rritje të lehtë me 1.4 p.p krahasuar me 2018, në dëgjesa publike mesatarisht kanë marrë pjesë 567 qytetarë për 57 bashki. Treguesi ka ulje kundrejt 2018<sup>2</sup>. Në nivel vendi, janë realizuar rreth 382 dëgjesa publike në procesin e hartimit dhe konsultimit të PBA ose mesatarisht 6.6 dëgjesa për bashki (N=58). Ky është një numër më i ulët i dëgjesave të raportuar në 2019, kundrejt 567 dëgjesave publike të organizuara në 2018. Buxheti vendor vazhdon të publikohet nga pjesa më e madhe e bashkive në faqen zyrtare të Bashkisë ose në website [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al). Mbetet ende sfida përmirësimi i procesit të konsultimeve mbi projekt-buxhetin e Bashkive, cilësia e planit afat-mesëm të buxhetit (PBA) dhe dëgjesave publike për ekzekutimin e buxhetit.

**Trajtimi i kërkesave të qytetarëve për informacion ose i ankesave të tyre është përmirësuar:** Niveli mesatar i përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave të qytetarëve ishte 92.59% në vitin 2019, që është +10.59 p.p më i lartë se 2018, ndërsa shkalla e publikimit të akteve normative të miratuara nga organi vendimmarrës në Bashki kundrejt numrit gjithsej të akteve të miratuara ka qenë mesatarisht 64.75%, ose 8.75 p.p. më e lartë krahasuar me 2018. Megjithatë, nuk ekzistojnë ende sisteme të menaxhimit të performancës së qeverisjes vendore për të mundësuar një vlerësim më cilësor të reagimit të bashkive ndaj qytetarëve. Instalimi i regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve dhe mbikëqyrja e përditësimit të regjistrit nga ana e koordinatorëve për të drejtën e informimit është planifikuar në 2023 sipas Planit të Veprimit 2019-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.

**Më pak raporte me rekomandime janë dërguar nga institucioni i Avokatit të Popullit në NJQV.** Në 2019, janë raportuar gjithsej 270 rekomandime për 55 bashki, me një vlerë mesatare 4.9, që është më i ulët, krahasuar 11 rekomandime mesatarisht në 2018. Rreth 72.95% e rekomandimeve të Avokatit të Popullit janë adresuar nga bashkitë ndërsa pjesa tjetër e tyre ishte në proces shqyrtimi nga nëntë bashki, brenda afateve kohore të përcaktuara më ligj.

1 Nuk u gjetën të dhena për numrin e femrave në postin e zv. Kryetarit të Bashkisë mbas zgjedhjeve lokale të 2015  
2 Mesatarisht raportuar 908 qytetarë në dëgjesat publike në 2018

**Organizatat e Shoqërisë Civile janë përfshirë më aktivisht** në proceset e formulimit të politikave dhe vendimmarrjes vendore në 2019. Gjithsej 270 rekomandime janë dërguar në NJQV ose 7% më shumë krahasuar me 2018; rreth 72.6% e rekomandimeve të OSHC janë marrë në shqyrtim nga bashkitë (mesatarisht 3.5 rekomandime, në krahasim me 3 rekomandime mesatarisht të dhëna në 2018), nga të cilat 49.6% janë pranuar nga Këshillat Bashkiake. Rreth 29.5% e bashkive kanë dhënë grante për Organizatat vendore të Shoqërisë Civile (71 grante gjithsej) për zbatimin e projekteve në nivel vendor më interes të përbashkët. Mbetet sfidë forcimi i kapaciteteve të brendshme të OSHC, fuqizimi i mëtejshëm i rolit të tyre në hartimin e politikave vendore dhe vendimmarrjen e organeve të QV, dhe rritja e financimit nga bashkitë për zbatimin e projekteve nga OSHC.

### Të drejtat e njeriut

**Kanë vijuar përpjekjet për të rritur kapacitetet e qeverisjes vendore nëpërmjet trajnimeve dhe ngritjes dhe funksionimit të mekanizmave të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe vendore në nivel rajoni dhe bashkie për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut.** Rreth 42.6% e bashkive kanë marrë pjesë në 114 programe trajnimi për standartet e të drejtave dhe praktikat e trajtimit të rasteve të shkeljes së tyre; numri i nëpunësve të trajnuar në 2019 është ulur krahasuar me 2018. Bashkëpunimi me Organizatat e Shoqërisë Civile për trajtimin e rasteve të dhunimit të të drejtave të njeriut evindenton përmirësim nga 42.6% të bashkive, ose 11.6 p.p. më shumë krahasuar me 2018. Mbeten sfida krijimi i infrastrukturës sociale (ambjenteve të posaçme) në NJQV për trajtimin e specializuar të rasteve, përmirësimi i bashkëpunimit me të gjithë aktorët në nivel bashkie dhe rritja e kapaciteteve profesionale të nëpunësve social.

**Është përmirësuar efienca dhe efektiviteti i veprimeve në luftën kundër korrupsionit.** Në 2019, janë raportuar gjithsej 162 ankesa nga bashkitë për shkelje të procedurave administrative, përfshirë çështje që lidhen me prokurimin publik. Caktimi i përgjegjësive dhe detyrave të koordinatorit anti-korrupsion në nivel vendor është kryer nga 55.7% e bashkive, ose 2.7 p.p. më i lartë krahasuar me vitin 2018. Hartimi i Planit Vendor të Integritetit (PVI) nga bashkitë ka progres të lehtë, rreth 26.2% e bashkive kanë miratuar PVI, ose +11.2 p.p më shumë, krahasuar me vitin 2018, por vetëm vetëm 37.5% e tyre (N=16) e kanë përfshirë planin vendor të integritetit në parashikimet e buxhetit vendor dhe PBA; trajnimet në fushën e anti-korrupsionit janë ndjekur nga 39% e bashkive. Mbeten sfida caktimi i koordinatorit vendor anti-korrupsion nga të gjitha bashkitë dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të tyre, hartimi i PV në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit Anti-korrupsion.

## KRITERI EKONOMIK

### Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Shqipëria u rendit në vendin e 82 ndërmjet 190 ekonomike në lehtësimin e bërjes biznesit, duke zbritur nga vendi 63 në 2018 në renditjen e 82 në 2019<sup>3</sup>. Ndërkohë progres është realizuar nga NJQV për hartimin dhe miratimin e një dokumenti të zhvillimit strategjik në nivel vendor. Në 2019, 42 bashki kanë miratuar Planin e Zhvillimit Vendor, që evidenton rritje të lehtë me 1.85 p.p. krahasuar me vitin 2018. Aktiviteti stimulues nga bashkitë për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla është i limituar, vetëm 54% e bashkive kanë raportuar për mbështetje të biznesit, krahasuar me 56% në 2018; janë

3

Burim: World Bank Doing Business (2020)

raportuar 110 aktivitete stimuluese, ose mesatarisht 2.08. Bashkitë kanë bashkëpunuar me disa projekte me financim të huaj në mbështetje të iniciativave lokale për punësimin e të rinjve në agrobiznes, artizanat, zhvillimin e turizmit, etj.

## AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

### Bujqësia dhe zhvillimi rural

**Është bërë një progres i lehtë drejt rritjes së kapaciteteve të NJQV në lidhje me sistemin e informacionit dhe këshillimin në bujqësi, për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit.** Zyrat e Informacionit dhe Këshillimit Bujqësor (ZIKB) janë funksionale në 31 bashki (ose 50.8% të tyre). Mesatarisht fondi i bashkisë për sektorin bujqësor dhe zhvillimin rural ka zënë rreth 7.74% të buxhetit vjetor. Shkalla mesatare e mirëmbajtjes së sistemeve të ujitjes dhe kullimit nga bashkitë është më pak se 50%. Treguesi për mirëmbajtjen e rrjetit ujtar të administruar nga bashkitë rezultoi me ulje me -2.23 p.p. në krahasim me 2018, ndërsa administrimi i rrjetit kullues me -5.58 p.p krahasuar me 2018. Janë trajnuar 91 punonjës vendor nga 32 bashki për përmirësimin e efektivitetit të zbatimit të masave vendore në harmonizim me prioritetet kombëtare dhe përmirësimin e standarteve. Rreth 26.2% e bashkive kanë raportuar dhënie të rreth 1079 granteve gjithsej për fermerët. Niveli i zbatimit të përfaqësuesit LEADER nga Bashkitë rezultoi të vijoje i ulët edhe në vitin 2019. Vetëm 12 Bashki raportojnë krijimin e Grupit Vendor të Veprimit (GVV). Mbeten sfida krijimi i infrastrukturave të përshtatshme për magazinimin e produkteve bujqësore, plotësimi i kuadrit ligjor për produktet organike dhe mbrojtjen e origjinës, vreshtat dhe verën, si dhe sigurimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

### Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare

**Është përmirësuar kuadri ligjor dhe bashkëpunimi ndërinstitucional mbi politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare.** Është diskutuar dhe konsultuar projekt-ligji për amendimin e Ligjit 10465/2011 për Shërbimin Veterinar në Këshillin Konsultativ për Vetëqeverisjen vendore. Rreth 21.3% e bashkive raportuese kanë një mbulim të plotë (100%) të tregjeve të kafshëve të gjalla me veterinerë sipas kërkesave ligjore, ndërsa niveli mesatar i mbulimit ka qenë 28.46%. Rreth 120 raste të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore dhe veterinare janë raportuar nga shërbimet bashkiake në vitin 2019, ose mesatarisht 2.2 raste për bashki. Niveli mesatar i tregjeve publike të shitjes me pakicë konform standarteve të higjienës ka qenë në nivelin 40.07% në vitin 2019, që evidenton përmirësim krahasuar me 2018 (24.5%). Mbeten sfida forcimi i ushtrimit të funksionit të monitorimit nga NJQV për tregtimin e produkteve ushqimore dhe veterinare, përmirësimi i kushteve fitosanitare, si dhe përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore për shkëmbimin e informacionit dhe cilësinë e raportimit.

### Politikat e transportit

**Rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor po tregon progres të lehtë por numri i aksidenteve mbetet i lartë** në krahasim me vendet e BE dhe të rajonit. Në 2019, aksidentet rrugore janë ulur me 13.8%, krahasuar me vitin 2018, ndërsa aksidentet rrugore me pasojë vdekjen u rritën me 6.84% në vitin 2019, krahasuar

me 2018. Shkalla mesatare e konformitetit të plotësimit të standarteve të rrjetit urban të bashkive është 53.2%, që tregon përmirësim të lehtë me 1.2 p.p. në krahasim me 2018, ndërsa shkalla mesatare e rrjetit rural që përmbush standardet e rrugëve është raportuar 32.15%. Kapacitetet administrative dhe burimet financiare në sektorin e transportit nuk janë të forta. Fondi mesatar për ndërtimin e rrugëve ka qenë ka qenë 6.15 p.p. më i lartë në 2019, krahasuar me 2018. Për sigurinë rrugore janë përdorur më pak fonde nga bashkitë në 2019 krahasuar me 2018 (-0.38 p.p.). Promovimi i lëvizjeve me këmbë dhe biçikleta nga shërbimet e bashkive ka pësuar ulje në 2019, dhe publikimi i planit të lëvizjeve të mjeteve të transportit publik në stacionet e autobuzëve është realizuar nga 31.14% ose -2.86 p.p. krahasuar me 2018.

## Energjia

**Në nivel të NJQV, progres i ulët është kryer mbi caktimin e menaxherit për eficientë e energjisë në zbatim të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Eficientë e Energjisë, 2019-2030.** Ende vetëm 14.47% e bashkive kanë caktuar menaxherin për eficientë e energjisë<sup>4</sup>. Trajnimi i nëpunësve vendorë të caktuar në kapacitetin e menaxherit për eficientë e energjisë në vitin 2019 është organizuar në nivelin 62%. Më shumë kontrolle janë kryer nga bashkitë për zbatimin e standarteve për eficientë e energjisë në ndërtesat publike dhe private, gjithsej 220 kontrolle të kryera. Mbetet përparësi plotësimi i kuadrit ligjor me akte nënligjore, hartimi i planit të veprimit për eficientë e energjisë nga të gjitha NJQV. Në nivel kombëtar, mbetet përparësi krijimi i Agjencisë së Eficencës së Energjisë dhe funksionimi efektiv i Fondit për eficientë e energjisë, zbatimi i reformave të tregut të energjisë elektrike, diversifikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe promovimi i burime alternative të energjisë së rinovueshme<sup>5</sup>.

## Taksat

**Sistemi i administrimit të taksave vendore ka përmirësim në disa tregues të performancës.** Rreth 80.33% e bashkive kanë hartuar politika tatimore, ose +1.65 p.p., krahasuar me 2018. Të ardhurat vendore janë rritur mesatarisht 25.4% në krahasim me 2018. Është rritur kontrolli nga shërbimet tatimore vendore, mesatarisht janë kryer 890 inspektime, ose +32 inspektime më shumë se niveli mesatar në 2018. Dëgjuesat publike me komunitetin e biznesit dhe shoqatat e bizneseve kanë qenë në nivel të njëjtë me 2018. Mbetet sfidë përmirësimi i mëtejshëm e administrimit të të ardhurave, qëndrueshmëria e sistemit të taksimit, si dhe fuqizimi i kapaciteteve teknike të departamenteve të taksave për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe për të aplikuar standartet evropiane për teknologjinë e informacionit (TI).

Në nivel kombëtar në 2019, është miratuar Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2019-2022 dhe plan-veprimi, është krijuar mekanizmi i bashkërendimit ndërinstucional të punës<sup>6</sup> për punësim të individëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike me një fokus të veçantë në grupet vulnerabël dhe është krijuar Agjencia Kombëtare e Punësimit si riorganizuar zyrat në disa rajone dhe në nivel vendor. Mbetet sfidë forcimi i kapacitetit dhe burimeve të qeverisjes vendore për të vlerësuar nevojat e kujdesit shoqëror në territorin e bashkive.

4 Shifra e treguesi mund të jetë më e lartë por shtatë bashki nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme

5 Raporti i Progresit për Shqipërinë i KE (2019)

6 VKM Nr 882/24.12.2019

## Politikat sociale dhe punësimi

Në nivel kombëtar në 2019, është miratuar Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2019-2022 dhe plan-veprimi, është krijuar mekanizmi i bashkërendimit ndërinstitucional të punës për punësim të individëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike me një fokus të veçantë në grupet vulnerabël dhe është krijuar Agjencia Kombëtare e Punësimit si riorganizuar zyrat në disa rajone dhe në nivel vendor. Mbetet sfidë forcimi i kapacitetit dhe burimeve të qeverisjes vendore për të vlerësuar nevojat e kujdesit shoqëror në territorin e bashkive.

Në 2019, në Këshillin Konsultativ (KK) për vetëqeverisjen vendore janë diskutuar dhe konsultuar projekt-udhëzimi “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, udhëzimi “ Për ndërthurjen e programeve sociale të strehimit dhe shërbimeve sociale të punësimit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor”, draft Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2019-2022 dhe Programi Kombëtar për Daljen nga Skema e Përfitueseve nga Ndihma Ekonomike. **Janë rritur burimet njerëzore për mbrojtjen sociale në nivel vendor**, me 127 nëpunës vendorë shtesë të punësuar në sektorin e përkrahjes sociale në 25 bashki. 211 nëpunës vendorë janë trajnuar në lidhje me prioritetet e sektorit dhe masat e zbatimit të politikave dhe në statistikat sociale. Sektori i vlerësimit të nevojave dhe referimit është funksional në 39,34% të bashkive, duke mbetur në një nivel të ngjashëm me 2019. Bashkitë kanë përdorur më shumë fonde në vitin 2019 se në vitin 2018 për mbrojtjen sociale, mesatarisht rreth 3.49% të buxhetit të tyre.

Ka përmirësim të performancës së bashkive lidhur me hartimin e planit vendor për **përfshirjen sociale**, rreth 63.9% e bashkive kanë raportuar për miratimin e planit vendor me vendim të Këshillit Bashkiak. Baza statistikore për përfshirjen sociale është ngritur në 52.46% të bashkive, ose rritje me +7.46 p.p., në krahasim me vitin 2018.

## Gjyqësori dhe të drejtat themelore

**Progres i lehtë evidentohet në krijimin e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në administratën vendore nga 91.8 % e bashkive**, ose 1.8 p.p. më i lartë se në vitin 2018; sistemi i monitorimit të rasteve nuk është funksional nga të gjitha bashkitë (mungon në 27.8% të tyre); takime të përbashkëta të grupeve ndërdisiplinore në nivel bashkie kanë qenë në nivel të krahasueshëm me vitin 2018, ose mesatarisht 11 takime për bashki. Numri i rasteve të identifikuara dhe të trajtuara për shkelje të të drejtave të fëmijëve ka qenë më i vogël, krahasuar me vitin 2018. Fondi vendor në 2019 për rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve ka qenë në nivel të ngjashëm me vitin 2018, ose mesatarisht 4% e buxhetit vendor dedikuar për mbrojtjen sociale.

**Progres është bërë për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane në nivel vendor.** Plan Vendor për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane, në zbatim të PKIRE, është hartuar dhe miratuar nga 34% e bashkive, ose +3.2 p.p. më shumë, në krahasim me 2018. Nëpunës vendorë të trajnuar mbi sistemin ROMALB kanë qenë 46 nga 27 bashki pjesëmarrëse, në të njëjtin nivel me 2018. Mbetet sfidë integrimi i këtyre pakicave nëpërmjet formimit profesional dhe përfshirja e tyre në tregun e punës. **Progres i lehtë evidentohet në disa komponentë për barazinë gjinore.** Mekanizmat në nivel vendor dhe në harmonizim të masave për të luftuar dhunën në familje janë funksionale në 85% të bashkive, ose përmirësim me +2 p.p., krahasuar me vitin 2018; rreth 31.15% e bashkive kanë përgatitur buxhetin vjetor bazuar në metodologjinë me ndjeshmëri gjinore, ose +6.16 p.p., krahasuar me vitin 2018. Rreth 172 nëpunës vendorë të trajnuar për çështje të barazisë gjinore në 2019, në nivel të njëjtë me 2018. Mbetet sfidë zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve

të nëpunësve vendorë, aplikimi i buxhetimit gjinor horizontalisht në të gjitha bashkitë dhe menaxhimi i rastit nga shërbimet sociale në bashki dhe në bashkëpunim me profesionistë të fushës.

**Për përfshirjen sociale dhe rritjen e aksesit të personave me aftësi ndryshe**, strukturat e dedikuara ose Sektori për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit në administratën vendore është ngritur nga 39.34% e bashkive, ose +3.34 p.p. më i lartë se 2018; rreth 54% e bashkive kanë hartuar dhe miratuar planin vendor për përfshirjen sociale të personave me aftësi, ose +11.48 p.p. më i lartë në krahasim me 2018. Problem për integrimin e PAK është aksesueshmeria e kufizuar në shkolla dhe infrastruktura urbane e kufizuar. Mbeten sfida zhvillimi i një databaze në nivel kombëtar për grumbullimin e të dhënave për PAK, rritja e nivelit të aksesueshmërisë në shkolla, institucione publike dhe shërbime të ndryshme, si dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore, standartizimi i modeleve për “përshtatje të arsyeshme” të vendit të punës në përputhje me nevojat dhe aftësitë për punë të PAK me qëllim rritjen e punësimit të tyre.

### Drejtësia, liria dhe siguria

Progres i lehtë është bërë në luftën kundër korrupsionit, kultivimit dhe trafikimit të drogës dhe pastrimit të parave<sup>7</sup>. Në nivel vendor, ka patur progres të mirë në dy nga tre masat kryesore në luftën kundër krimit të organizuar: Dokumenti strategjik për sigurinë publike është hartuar dhe miratuar nga 42.62% të bashkive, ose +16.4 p.p. në krahasim me 2018, strukturat e Këshillave Komunitare (KK) janë krijuar nga 49.18% e bashkive, ose +18.03 p.p. më shumë bashki, krahasuar me 2018, ndërsa krijimin e grupit të punës në luftën kundër krimit të organizuar ka qenë në nivel të njëjtë me atë të vitit 2018, bazuar në të dhënat e raportuara. Mbetet sfida krijimi i grupeve të punës dhe Këshillat Komunitarë në të gjitha bashkitë, përmirësimi i cilësisë së punës dhe eficiencës të këtyre strukturave si dhe përmirësimi i bashkërendimit të masave me institucionet shtetërore dhe aktorë të tjerë në nivel vendor.

### Arsimi

**Në nivel kombëtar, është zhvilluar legjislacioni për sektorin e arsimit parauniversitar** me impakt në nxënësit që vijnë nga shtresat e marxhinalizura dhe është përmirësuar regjistrimi i fëmijëve të grupmohës 3-5 vjeç në arsimin parashkollor në nivel kombëtar. Më shumë fond nga buxheti vendor është përdorur për rindërtimin e kopshteve ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja, mesatarisht u përdor 6.73% e buxhetit vendor në 2019 ose +3.83 p.p. më i lartë se në 2018. Mesatarisht është alokuar rreth 1.62% e buxhetit vendor për sektorin e arsimit për rregjistrimin dhe frekuentimin e shkolles nga fëmijët që i përkasin grupeve të marxhinalizuara, ose 1.2 p.p. më shumë se në vitin 2018. Mbetet sfida, për disa NJQV, rritja e fondit vendor për rindërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore dhe parashkollore për disa bashki, rritja e numrit të edukatorëve dhe ulja e numrit të fëmijëve në kopshte; rritja e kapaciteteve të administratës vendore për përgatitjen e projekteve për infrastrukturën shkollore, të menaxhimit të prokurimit publik dhe zbatimi efektiv i kontratave për infrastrukturën shkollore.

### Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

**Progres i lehtë është evidentuar në ushtrimin e funksioneve të NJQV për mbrojtjen e mjedisit**, hartimin e projekteve miqësore me mjedisin dhe ndryshimet klimaterike, grumbullimin e diferencuar të mbetjeve

7


Burim: Deklarata e Komisionit Evropian, dt. 2 Mars 2020, i cili rekomandoi hapjen e negociatave me Shqipërinë.

dhe depozitim e tyre në fusha dhe landfill që përmbushin standartet e BE. Pjesëmarrja në trajnime për mjedisin, legjislacionin mjedisor është kryer nga 77% e bashkive, gjithsej 88 persona në 2019, ose 19 nëpunës më shumë të trajnuar kundrejt 2018. Më shumë fushata ndërgjegjësimi (+91) të realizuara në 2019 nga NJQV në mbrojtje të mjedisit dhe minimizimin e ndotjes në bashkëveprim më OSHC, ose mesatarisht 6 fushata. Plani Vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve (PVMIM) është hartuar nga 46% e bashkive. Rreth **47.5% e bashkive kanë hartuar planin për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor**. Më shumë trajnime janë realizuar gjatë vitit 2019 për punonjësit vendorë të fondit pyjor, gjithsej 426 persona, krahasuar me 307 punonjës të trajnuar në 2018; rreth 64% e bashkive kanë ngritur databazën për përdoruesit e fondit pyjor dhe kullosor. Zhvillimi dhe plotësimi i legjislacionit të sektorit me akte nënligjore dhe udhëzime për zbatimin e ligjit<sup>8</sup> do të mbështetë bashkitë për ushtrimin efektiv të funksionit për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor.

### Kontrolli Financiar

Gjatë vitit 2019, Këshilli Konsultativ për Qeverisjen Vendore ka marrë pjesë në procesin e konsultimit të dy projektligjeve për “Shërbimet e pagesave” dhe “Për investimet”. **Janë rritur të ardhurat nga njësitë e qeverisjes vendore në vitin 2019** me një ritëm ndryshim prej +5.7% krahasuar me vitin 2018, si dhe **shpenzimet e përgjithshme** në një shkallë 11.3% më shumë kundrejt 2018. Bashkitë kanë kryer më shumë investime gjatë 2019 kundrejt 2018, me +3.09 p.p. Mbeten sfida për NJQV rritja e shkallës së proporcionalitetit të planifikimit të fondeve të buxhetit vendor në përputhje me prioritetet strategjike të bashkive, ulja e borxheve të prapambetura ndaj palëve të tret, aplikimi i instrumentave për përgjegjësinë menaxheriale dhe menaxhimi i rrezikut nga Njësitë e Qeverisjes Vendore si një rekomandim i KE për Shqipërinë.





## Hyrje


Ky është raporti i tretë kombëtar i vlerësimit të arritjeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në funksion të procesit të integrimit evropian në fushat kryesore të cilat lidhen me kriterin politik, kriterin ekonomik dhe aftësinë për të realizuar detyrimet e anëtarësimit.

Monitorimi i performancës mbi bazën e analizës së treguesve për sektorë dhe fusha të ndryshme, përfshijnë demokracinë vendore, shtetin e së drejtës, administratën publike, të drejtat e njeriut dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të veta të NJQV. Raporti analizon informacionin për vitin 2019, duke bërë kështu një krahasim ku është e mundur të prirjes së treguesit nga viti 2017 dhe 2018 mbi bazën e të dhënave të vlefshme. Të dhënat e raporteve të vlerësimit duke filluar nga viti 2018 publikohen on-line në adresën <https://mapping-bpe.al/goDataAnalyze/online.aspx>, si dhe në faqen e internetit të Agjensisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

Raporti i dytë për vitin 2018 u prezantua në një takim të organizuar në Vlorë më 6 Shkurt 2020 me përfaqësues të lartë të Ministrisë së Brendshme dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian, duke vijuar më pas me prezantime të hapura edhe në bashkitë e tjera.

Treguesit e performancës të bashkive të konsultuar me specialistë të fushave përkatëse në ministritë e linjës dhe institucione qendrore të tjera në 2018, janë pasuruar me disa tregues të tjerë gjinorë mbi përfaqësimin e femrave në organet drejtuese të bashkisë dhe në administratën vendore në këtë vlerësim të tretë. Në 7 Nëntor 2019 u mbajt një seminar me përfaqësuesit e Njësive të Integrimit Evropian në 61 bashkitë mbi metodologjinë e të dhënave dhe procesin e mbledhjes dhe regjistrimit në sistemin on-line, i cili u transferua në një platformë të re që mundëson minimizim e gabimeve në hedhjen e të dhënave.

Monitorimi i treguesve të performancës dhe publikimi i tyre mbi bazën e të dhënave të bashkive ofron evidence të dobishme mbi ushtrimin e funksioneve dhe shërbimeve të ndryshme si dhe një bazë krahasimi me bashkitë e tjera duke identifikuar progresin ose tendecën në ulje për periudhën kohore 2017-2019, dhe aftëson partneritetin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV. Gjithashtu është një instrument i dobishëm për të forcuar sistemin e të dhënave dhe zhvillimin e një kulture të performancës në administratën vendore të orientuar në rezultate dhe analiza mbi bazën e treguesve të matshëm.




## Sistemi i të dhënave

Raporti mbulon të 61 bashkitë bazuar në të dhënat e raportuara nga Njësitë e Integritit Evropian nëpërmjet Sistemit On-Line të Raportimit. Mbledhja e të dhënave është një proces pjesëmarrës që kërkon një raportim efektiv të më shumë se 200 treguesve për vitin e raportimit brenda datës 31 Janar të vitit pasardhës. Në situatën që të dhënat e treguesve nuk janë të disponueshme nga INSTAT dhe sistemi statistikor i bashkive është i pazhvilluar, procesi i mbledhjes dhe regjistrimit të tyre në sistem është sfidues dhe mund të shoqërohet me pasaktësi dhe mungesë të raportimit nga disa bashki për disa tregues. Bashkitë që nuk kanë ofruar/nuk disponojnë të dhëna për tregues të veçantë janë paraqitur ose në hartë ( në ngjyrë gri) ose me shpjegime në fund-shënime.

Raporti jep të dhëna të llogaritura për shumën, mesataren ose numërimin për tregues të ndryshëm për të cilat janë ofruar të dhëna të vlefshme. Treguesit janë të matshëm (numerike, ose të shprehur në përqindje), afirmative për disa objektiva dhe prioritete që lidhen me zbatimin e politikave të Qeverisë së Shqipërisë në nivel vendor. Treguesit prezantojnë situatën në secilën bashki sipas kriterëve të vlerësimit. Ata nuk janë tregues të përbërë ose tregues që maten mbi bazën e perceptimit qytetar për performancën e bashkisë së tyre.

Të gjitha të dhënat e analizuar, të cilat i përmban ky raport, veç një pjese të të dhënave në kriterin e kontrollit financiar, janë paraqitur nga bashkitë, prandaj përgjegjësia për saktësinë dhe shifrat përkatëse të të dhënave është përgjegjësi e secilës administratë bashkiake.





# I.

## KRITERI POLITIK

---

*Qëndrueshmëria e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e pakicave*

# 1. DEMOKRACIA

## 1.1. Qeverisja

*Objektivi specifik: Përmirësimi i koordinimit të qeverisë qendrore dhe vendore nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit efektiv të Këshillit Konsultativ*

Këshilli Konsultativ (KK) është forumi kryesor konsultues midis qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore<sup>9</sup> për të gjitha projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projekt-politikat dhe projekt-strategjitë të cilat rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Synimi afatgjatë i krijimit dhe konsolidimit institucional të kësaj strukture është shndërrimi i organeve të vetëqeverisjes vendore në partnerë të rëndësishëm dhe të denjë të qeverisjes qendrore për fushat e tyre të përgjegjësisë dhe të drejtave që gëzojnë. Informimi, këshillimi, përfaqësimi dhe gjithëpërfshirja si dhe bashkëpunimi dhe dialogu kanë vijuar të udhëheqin punën e Këshillit Konsultativ edhe gjatë vitit 2019.<sup>10</sup> Ndërkohë janë bërë përpjekje të mëtejshme në drejtim të rritjes së transparencës së aktivitetit të Këshillit Konsultativ nëpërmjet publikimit të gjithë akteve apo dokumentave të rëndësishme të diskutuara në takimet e KK. Gjithë aktet dhe dokumentat e rëndësishme të diskutuara publikohen në faqen e internetit të KK <https://keshillikonsultativ.qeverisjavendore.gov.al/> si dhe gjithë personave të interesuar ju jepet mundësia që të japin mendimin e tyre nëpërmjet seksionit të dedikuar “Konsultime”<sup>11</sup>. Kjo mundëson qasje më të gjerë në dhënien e kontributit për aktet ligjore dhe dokumentat e tjera të rëndësishme që ndërlihen me funksionet e qeverisjes vendore.

### Kutia 1 : Roli i Këshillit Konsultativ

Bashkimi Evropian e sheh këtë mekanizëm institucional për konsultim mes niveleve të qeverisjes si një mundësi unike dhe të frytshme për dialog.

Por pse është e rëndësishme kjo?

Të gjithë aktorët që thonë fjalën e tyre japin një shans më të madh për marrjen e vendimeve më të mira, vendime që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe shumë real në jetët e qytetarëve të zakonshëm.

Ne jemi gjithnjë e më të vëmendshëm ndaj qeverisjes vendore dhe në veçanti ndaj rolit që qeveritë vendore luajnë në procesin e integritimit të vendit në BE. Le të mos harrojmë se shumica e acquis të BE-së zbatohet në nivel vendor.

*Nga fjala e Z.Luigi Soreca, Ambasador i BE në Shqipëri në mbledhjen e KK, 1 Prill 2019.*

<sup>9</sup> Veprimtaria e Këshillit Konsultativ është e bazuar në VKM nr. 910, datë 21.12.2016, “Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, dhe VKM Nr. 751, datë 19.12.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, si dhe në Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe të Strategjisë Kombëtare Ndër-sektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore (SKNDQV).


<sup>10</sup> Procesi i konsultimit në Këshillin Konsultativ bazohet në (i) parimin e informimit, nëpërmjet njoftimit dhe vënies në dispozicion të anëtarëve të Këshillit Konsultativ, shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe nëpërmjet tyre, të gjithë njësive të vetëqeverisjes vendore të projektligjeve, projektvendimeve, projekt politikave ose projekt strategjive që propozohen nga qeverisja qendrore, (ii) parimin e këshillimit, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për projektligjet, projektaktet nënligjore, projekt politikave ose projekt strategjitë të propozuara nga qeverisja qendrore dhe që kanë ndikim në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore, (iii) parimin e angazhimit të shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJQV), dhe të vetë këtyre njësive, si dhe rritjen e transparencës, nëpërmjet përfshirjes së tyre në procesin e formulimit dhe miratimit të projektakteve, politikave dhe zgjidhjeve konkrete, (iv) parimin e bashkëpunimit dhe dialogut konstruktiv me të gjithë shoqatat përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendor.

<sup>11</sup> <https://keshillikonsultativ.qeverisjavendore.gov.al/category/konsultime/>

Në vitin 2019, janë realizuar 6 takime<sup>12</sup> të KK, në të cilat janë diskutuar 6 projektligje, 36 projektakte, dhe 10 programe dhe strategji sektoriale:

- *Projektligje të konsultuara:* “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, për disa ndryshime në ligjin nr 10 448, dt 14.07.2011,” Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar”, projektligji “Për Pyjet”, projektligji për “Një ndryshim në ligjin 10 431, datë 09.06.2011, ”Për mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, “Për shërbimet e pagesave”, dhe projektligji “Për investimet”.
- *Disa nga projekt-aktet përfshijnë:* projektvendim “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes dhe të bashkëpunimit institucional”, projektvendim “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas cdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, projektvendim “Për administrimin e kërkesave të njësisë të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit, për subvencionimin e qirasë, kriteret e dhënies dhe mënyrën e llogaritjes së subvencionit të qirasë”, projektvendimin “Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, Projektvendimin “Për kriteret për punësimin e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe të punonjësve të cilët punojnë me fëmijët”; Projektvendim “Për përcaktimin e mënyrës së zbatimit të planeve të përgjithshme vendore në fuqi, pas miratimit të hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë për njësitë e vetëqeverisjes vendore” dhe akte të tjera.
- *Disa nga strategjitë janë:* draft Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, 2019-2022, Programi Kombëtar për Daljen nga Skema e Përfituesve nga Ndihma Ekonomike.

Grafiku 1: Projektaktet e konsultuara në KK në vitin 2019 dhe totali 2018.



Edhe pse për arsye të zhvillimeve politike me zgjedhjet lokale të Qershorit 2019 dhe situatës kritike të krijuar nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, të cilat e kufizuan veprimtarinë e KK në vetëm 6 mbledhje, krahasuar me 7 të realizuara në vitin 2018, në volum aktesh ligjore ka një numër më të madh aktesh të kaluara për diskutim e shqyrtim 52 në vitin 2019 krahasuar me 40 në vitin 2018 (ose 40% më shumë).

Një nga diskutimet më të rëndësishme të KK ka qenë diskutimi<sup>13</sup> dhe miratimi i planit të veprimit në kuadër të studimit “Matrica e Kompetencave të Vetëqeverisjes Vendore<sup>14</sup>. Qëllimi i studimit është të japë për hapat që duhen ndërmarrë në vijim për të përmbushur masën e autonomisë vendore të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2019. Studimi përfshin një analizë të detajuar të rreth 400 akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë sektorët e lidhur me ushtrimin e funksioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor

12 Takime në datat 31 Janar 2019, 26 Shkurt 2019, 1 Prill 2019, 26 Shtator 2019, 21 Nëntor 2019

13 <https://keshillikonsultativ.qeverisjavevendore.gov.al/dokumenta/>

14 <https://www.bpe.al/sites/default/files/publications/Matrica-e-Kompetencave.pdf> Studimi i realizuar nga URI dhe financuar nga BE.


dhe institucional sektorial është mëse i nevojshëm për të rritur eficiencën e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore. Bazuar në analizën e rekomandimet Ministria e Brendëshme ka hartuar një plan konkret i cili përcakton afatet e duhura për rishikimin dhe harmonisimin e gjithë legjislacionit sektorial të identifikuar në studim.

Mbledhjet e Këshillit Konsultativ gjatë 2019 kanë:



- Institucionalizuar procesin e konsultimit ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore duke informuar të gjithë palët për projektvendimet, projektligjet dhe projekt strategjitë që propozohen nga Qeverisja Qendrore.
- Kontribuar në mbledhjen e vërejtjeve, mendimeve, komenteve dhe propozimeve të bashkive të cilat i janë bashkëlidhur praktikës dokumentare që shoqëron procesin vijues të vendimmarrjes në Këshillin e Ministrave ose në Kuvendin e Shqipërisë; projektligjet dhe projektvendimet e konsultuata kanë patur ndikim në funksionet dhe interesat e bashkive.
- Informuar paraprakisht Njësitë e Qeverisjes Vendore me masat që duhet të ndërmerren në kuadër të zbatimit të Ligjeve dhe VKM-ve të reja dhe të miratuara.
- Rritur transparencën duke përfshirë shoqatat dhe bashkitë në procesin e formulimit të projekt – akteve ose projekt-ligjeve.

Në krahasim me vitin 2018 pjesëmarrja e anëtarëve përfaqësues të qeverisjes vendore në KK është rritur, ndërkohë ajo e qeverisjes qëndrore ka qënë më e ulët se viti 2018.

Grafiku 2: Pjesëmarrja në total në KK në vitin 2019 krahasuar me 2018.



Grafiku 3: Pjesëmarrja në secilën mbledhje të KK në vitin 2019.




## Ngritja e Zyrave me Një Ndalesë për Shërbime Publike

Objektivi specifik: qeverisja e hapur, llogaridhënia dhe qeverisja elektronike në nivel vendor

Shtirja e sistemit të Zyrave të Integruara me Një Ndalesë (OSSH) në të gjitha Bashkitë dhe NJA ka qenë një objektivi në vijueshmëri nga Qeveria, institucionet qendrore dhe projektet me financim të donatorëve. Në vitin 2019, qendrat e integruara OSSH janë ngritur dhe veprojnë në 41 bashki (67% e bashkive), ose 18 % p.p. me shumë krahasuar me vitin 2018.

Numri i shërbimeve të ofruara nga 41 qendrat e integruara OSSH ka qenë 2,840; Treguesi mbi numrin e shërbimeve të ofruara varion në një shkallë të gjerë ndërmjet bashkive: Bashkia Tiranë (265), Bashkia Kurbin (200), Bashkia Maliq (169), Bashkia Elbasan (160) deri në vlera më të ulta, psh Bashkia Finiq (10), Bashkia Divjake (5).


Grafiku 6: Numri i shërbimeve nga Zyrat me Një Ndalesë




Ndërsa dixhitalizimi i shërbimeve rrit cilësinë dhe aksesueshmërinë në marrjen e shërbimeve administrative të ofruar nga bashkitë dhe institucionet qendrore në nivel vendor (degët territoriale), qeveria duhet të marrë në konsideratë risqet që mund të shfaqen nga grupe ose segmente të shoqërisë në formën e 'e-përjashtimit'/e-exclusion. Kjo formë vjen nga diferencat që ekzistojnë në nivelin arsimor të popullsisë, dhe specifika të tjera si mosha ose zona e banimit.

Në kuadër të Axhendës Dixhitale të QSH, 2015-2020, tre janë prioritet kryesorë: (i) shtimi dhe promovimi i shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën sipas parimeve të iniciativës Open Government Partnership, (ii) përdorimi i TIK në edukim për të kapërcyer hendekun dixhital dhe për të aftësuar rininë, (iii) konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershme.<sup>15</sup>

Grafiku 4: Zyrat e Integruara me Një Ndalesë



Grafiku 5: Numri i Zyrave me 1 Ndalesë



15 Burim: Axhenda Dixhitale e Shqipërisë, 2015-2020

## Probleme dhe sfida

- Në disa nga bashkitë mungojnë hapsirat fizike për të mundësuar ngritjen e tyre;
- Mbulimi i gjithë territorit të bashkisë me shërbime të integruara (ofrimi i shërbimeve njëtrajtësisht nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë.
- Rritja e numrit të shërbimeve administrative dhe publike që ofrohen nga qendra OSSH.
- Trajnimi i stafëve në ato bashki ku janë ngritur me synim që të sigurohet efikasitet më i lartë dhe shërbim më cilësor ndaj qytetarëve.
- Edukim qytetar për të kapërcyer hendekun dixhital dhe përdorimin e platformave për të marrë shërbimet online dhe për të reduktuar marrjen e shërbimeve në sportele.
- Ofrimi i mjeteve alternative të marrjes së shërbimeve nga qytetarët që kanë vështirësi në aplikimet online.

## Rekomandime

- Mbështetje dhe rritje e vazhdueshme e kapaciteteve vendore në mënyrë që të sigurohen shërbime efikase dhe të ndërtohet besimi tek administrata dhe qytetarët, si dhe të konsolidohen procedurat e zyrës me një ndalesë si praktika të përditshme.
- Konsolidimi i zyrave me një ndalesë si një strukturë brenda bashkive duke rishikuar strukturat e tyre organizative dhe hartimin e rregulloreve të brendshme duke përshtatur procedurat e zyrës me një ndalesë si praktikë të brendshme.
- Mbështetja e bashkive me infrastrukturën e pajisjeve për të rritur efikasitetin e sistemit të zyrës me një ndalesë, pasi ka mungesë të infrastrukturës në shumicën e NJQV-ve.
- Rekomandohet të sigurohet funksionimi i plotë i të gjitha Njësive Administrative si pika shërbimi të zyrës me një ndalesë dhe të rriten kapacitetet e tyre në lidhje me asimilimin e sistemit dhe të procedurave të reja administrative për t'i shërbyer më mirë qytetarëve.
- Standardizimi dhe unifikimi i procedurave administrative për ofrimin e shërbimeve në nivel vendor. Ri-optimizimi i proceseve të punës me qëllim lehtësimin e tyre, reduktimi i burokracisë dhe rritja e efikasitetit të ofrimit të shërbimeve.
- Rishikimi i shërbimeve administrative (veçanërisht faza e protokollit, e cila është një fazë vendimtare që do të lehtësonte dixhitalizimin e shërbimeve dhe do të sillte akses pa shkresa) me qëllim lehtësimin e tyre të mëtejshëm dhe rishikimi i bazës së tyre ligjore në mënyrë që të konsolidohet aplikimi në sistemin e zyrës me një ndalesë.
- Rritja e kapaciteteve të administratës vendore në mënyrë që të kuptohen plotësisht funksionalitetet dhe operimi i zyrës me një ndalesë dhe të përdoret siç duhet:
  - Punonjësit e sporteleve pritëse për qytetarët, si pika e parë e kontaktit, duhet të kenë një njohuri të gjerë për të gjitha shërbimet vendore si dhe duhet të përmirësojnë etikën dhe komunikimin me qytetarët për t'u përgjigjur më mirë kërkesave të tyre.
  - Punonjësit e zyrave mbështetëse në asimilimin e procedurave të reja administrative dhe në lehtësimin e përdorimit të sistemit.
- Integrimi i shërbimeve në nivel vendor (modeli i Zyrës me një Ndalesë) dhe shërbimet në nivelin kombëtar (modeli ADISA) në një vend (zyrë) për t'u shërbyer më mirë qytetarëve.
- Të gjitha shërbimet do të jenë lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët, si dhe cilësia dhe standardi i tyre do të rriten.



## Rritja e Transparencës së Financave Vendore


Nga Ministrinë e Linjës, institucionet qendrore dhe NJQV zbatohen parimet e qeverisjes së mirë për buxhetimin më pjesëmarrje dhe raportimin e performancës së buxhetit. Buxheti me pjesëmarrje mundëson informimin dhe konsultimin mbi alokimin dhe priorizimin e burimeve, si dhe rrit përgjegjësinë dhe transparencën nga institucionet publike. Të gjitha Bashkitë realizojnë konsultime publike për çështje të ndryshme më rëndësi publike. Portali elektronik për konsultimet publike është operacional, por përdorimi i tij nga qytetarët mbetet i limituar. *Konsultimet publike* për hartimin e politikave dhe zhvillimin e legjislacionit realizohen në praktikë, por udhëzimi metodologjik dhe kontrolli i cilësisë mungon. Përfshirja publike e qytetarëve është e limituar<sup>16</sup>.

Në 2019, rreth 93.4% të bashkive kanë hartuar buxhetin e tyre me metodën me pjesëmarrje; treguesi ka rritje të lehtë me 1.4 p.p krahasuar me 2018. Buxheti vendor duhet të ishte publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë ose tek website [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al) nga të gjitha bashkitë, por në realitet, 13% e bashkive kanë raportuar se nuk e kanë publikuar buxhetin vendor në 2019.


Në nivel vendi, është raportuar se 32,895 qytetarë kanë marrë pjesë në dëgjesa publike në vitin 2019 ose mesatarisht 567 qytetarë për 57 bashki<sup>17</sup>, i cili rezulton me ulje krahasuar me vitin 2018 (mesatarisht 908 qytetarë/dëgjese publike). Edhe numri i dëgjesave publike të organizuar nga bashkitë në 2019, siç edhe tregohet nga grafiku 8 më poshtë ka qenë më i ulët në krahasim me 2017, 2018, mesatarisht nga 510 në vitin 2018 në 488 dëgjese në vitin 2019.

Kategoritë apo grupet për të cilat kushtohet kujdes i veçantë për ti ftuar dhe marrë mendimin në procesin e hartimit të buxhetit janë gratë, të rinjtë, grupet vulnerabël, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat kombëtare etnike; këto kategori të veçanta, në mjaft raste përfaqësohen nga Organizatat e Shoqërisë Civile.

Grafiku 7: Buxheti me pjesëmarrje




Grafiku 8: Numri i dëgjesave publike mbi projekt-buxhetin nga NJQV



16 Progres Raporti për Shqipërinë, 2019


17 Bashkitë Prrenjas, Tepelenë, Shijak kanë raportuar zero qytetarë në dëgjesat publike, por nga ana tjetër këto bashki kanë raportuar se kanë kryer dëgjese publike; Bashkia Rrogozhinë nuk ka raportuar për kryerjen e dëgjesave publike për hartimin e buxhetit vendor.

Grafiku 9: Numri i qytetarëve në dëgjesat publike mbi projekt-buxhetin, 2019



Numri i dëgjesave publike të organizuara nga NJQV mbi zbatimin e buxhetit, realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve ka qenë më i vogël krahasuar me 2018;


Grafiku 10: Dëgjesa publike mbi realizimin e buxhetit, 2019



Në vitin 2019, 54 bashki kanë raportuar për 362 dëgjesa publike, ose mesatarisht 6.24 dëgjesa publike (N=54), ndërsa mesatarja e dëgjesave publike për zbatimin e buxhetit në 2018 ka qenë 8 takime (N=60). Shtatë bashki nuk kanë kryer dëgjesa publike mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2019<sup>18</sup>.

### Probleme dhe Sfida

- Përdorimi i mjeteve inovative të njoftimeve për konsultimin publik nga Bashkitë (psh. me anë të facebook, ose telefonit celular).
- Zhvillimi i nje kulture të orientuar nga performanca me vendosjen e objektivave te qarta dhe të matshme.
- Raportim nga NJQV mbi ekzekutimin e buxhetit mbi treguesit kryesorë të realizuar ne fund të vitit krahasuar me target të planifikuar për të gjitha programet buxhetorë, ose për programe prioritare të Bashkisë.



## Rekomandime

- Zhvillimi i nje kulture gjithëpërfshirëse të qytetarëve dhe edukimi civil në moshë të re për të përfshirë aktivisht në procesin e hartimit të politikave nga NJQV, në vendimmarrje vendore dhe rritja e kërkesës së llogaridhënies mbi zbatimin e programeve nga NJQV dhe organet e tyre drejtuese.
- Vlerësimi, analizimi dhe sigurimi i transparencës të rekomandimeve të qytetarëve të shprehura në një rubrikë në website të Bashkisë
- Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje duhet të jetë një proces me shpërndarje gjeografike në mënyrë që t'u jepet akses edhe qytetarëve që jetojnë në zona të largëta që edhe ata të ngrenë zërin e tyre. Bashkitë kanë nevojë për mbështetje për të gjetur mënyra të suksesshme për të përfshirë qytetarët në politik-bërje dhe në formësimin e komuniteteve.

## Administrata Publike

Punësimi në nivel të qeverisjes vendore është një indikator i nivelit të decentralizimit të administratës publike. Me transferimin e gjashtë funksioneve<sup>19</sup> nga qeveria qendrore në NJQV, rreth 10,239 punonjës u transferuan nën përgjegjësinë e Bashkive. Në nivel vendi, numri i punonjësve në NJQV së bashku me punonjësit e shërbimeve ka qenë 30,660 në vitin 2019<sup>20</sup> (N=60); Bashkia e Tiranës ka numrin më të madh të të punësuarve, gjithsej 5,393 punonjës.

Progresi mbi objektivin specifik “Forcimi i kapaciteteve të administratës të qeverisjes vendore” është vlerësuar mbi bazën e 18 treguesve të performancës. Për herë të parë, në këtë raport janë përfshirë disa tregues të tjerë mbi nivelin e përfaqësimit të femrave në pozicion politik (zv. Kryetar Bashkie), përfaqësimi në organin drejtues të Këshillit Bashkiak, dhe përfaqësimi i femrave në pozicione drejtimi në administratën vendore.

Në vendet e OECD dhe në nivel global, niveli i përfaqësimit të femrave në nivele të larta drejtuese dhe në parlament është më i ulët se niveli i punësimit në administratën publike, por trendi i përfaqësimit ka qenë në rritje. Në vitet e fundit, Shqipëria ka rritur angazhimin e femrave në poste ministeriale, duke u renditur e pesta në renditjen globale. Në vitin 2019, 53.3 % (ose 8 nga 15 ministra) janë femra, kurse 29.3% e deputetëve të Parlamentit të RSH janë femra<sup>21</sup> (41 nga 140 deputetë gjithsej).

- Mesatarja e përfaqësimit të femrave në pozicionin e nën.kryetarit të Bashkisë për të gjitha bashkitë ishte 34.9%; gjashtë bashki kanë një nivel prej 100%<sup>22</sup> të përfaqësimit të femrave në këtë pozicion, ndërsa mesatarja e përfaqësimit të femrave në nivel vendi si anëtare të Këshillave Bashkiakë të dalë pas zgjedhjeve lokale të Qershorit 2019 ishte 41.02%<sup>23</sup>. Vihet re një rritje të pjesëmarrjes së femrave në këshillat bashkiakë në zgjedhjet e vitit 2019 krahasuar me zgjedhjet lokale të viti 2015 ku pjesëmarrja ishte në nivelin 34.8%<sup>24</sup>. Përqindja më e madhe e përfaqësimit të femrave rezulton në Këshillin Bashkiak Dropull me 60% ndërsa përqindja më e ulët rezulton në Këshillin Bashkiak të Kavajës me vetëm 1% të raportuar. Ndërkohë duhet të përmendet se ka një ulje të lehtë në përqindjen e kryetarëve të bashkive femra, 13% gjatë zgjedhjeve të vitit 2019 ose 8 kryetarë bashkie femra, krahasuar me 14.75% ose 9 të zgjedhura në zgjedhjet lokale të vitit 2015.

19 Në 2016 me decentralizimin e funksioneve të sistemit të ujëtjes-kullimit, menaxhimi i pyjeve, arsimit parauniversitar, shërbimi i zjarrfikësve dhe pjesë të shërbimit social (në disa bashki)

20 Bashkitë Dropull dhe Shijak nuk kanë ofruar të dhëna për këtë indikator.

21 UN Women – Women in politics, 2019

22 Bashkitë Konispol, Korce, Fier, Devol, Has, Memaliaj

23 Sipas Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

24 [http://cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/Barazia\\_gjinore/kuota\\_gjinore\\_kanidimet\\_Zgjedhjet\\_%20Vendore\\_%202015.pdf](http://cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/Barazia_gjinore/kuota_gjinore_kanidimet_Zgjedhjet_%20Vendore_%202015.pdf)



ristrukturimin e institucioneve të varësisë së Kryeministrit dhe ministrive të linjës (proçes në vijim); rritjes së kapaciteteve vlerësuese të anëtarëve të komiteteve të pranimit (rekrutimit), zgjerimit dhe përmirësimit cilësor të pyetjeve të bankës së pyetjeve, bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë për përthithjen e kandidatëve potencialë (të sapodiplomuar) dhe përmirësimit të përshkrimit të punës<sup>25</sup>. Një nga arritjet në aspektet e administratës vendore është përfundimi dhe vendosja në funksion i portalit të administratës publike [administrata.al](http://administrata.al), dhe trajnimi i 100 nëpunësve të menaxhimit të burimeve njerëzore (MBNJ) në të gjitha bashkitë e vendit në dy cikle, gjithsej 200 persona të trajnuar mbi përdorimin e platformës.


Forcimi i kapaciteteve të nëpunësve civilë nëpërmjet përmirësimit të sistemit të trajnimeve të ASPA ka qenë një tjetër objektivi i vazhdueshëm. Eshte zhvilluar manuali i hartimit të pyetjeve të testimit në ASPA, si dhe janë rishikuar pjesa më e madhe e pyetjeve të testeve për programe ekzistuese të trajnimeve sipas manualit; integrimi i 12 parimeve të qeverisjes së mirë në kurrikulat ekzistuese, u hartua një metodologji për futjen e sistemit të krediteve në ASPA, si dhe janë riformuluar rreth 15 kurrikula sipas sistemit standard, trajnim për stafin e ASPA dhe trajnerëve mbi metodologjinë e vlerësimit të nevojave për trajnim<sup>26</sup> (TNA) si dhe u hartua një draft pyetsor për bashkitë mbi vlerësimin e nevojave për trajnim dhe planifikimin e trajnimeve për 2020-2021. Rezultate të tjera lidhen me zbatimin e programeve të trajnimit për trupën e lartë të nëpunësve (TND).

Sistemi e-learning për administratën vendore nuk ka qenë funksional në vitin 2019. ASPA synon të krijojë një sistem të ri online më të avancuar nëpërmjet ofrimit të trajnimeve on-line nëpërmjet sistemit të ndëraktiv të “Webinar” me Bashkitë. Me asistencën e “Projektit Bashkitë për në Evropë” është bërë e mundur sigurimi i këtij shërbimi për vitin 2020. Kjo do të mundësojë që ASPA të vijë më pranë bashkive me shërbimet e saj, dhe do të mundësojë ofrimin e shërbimeve nëpërmjet përdorimit të metodave alternative inovatore.

Në 2019, u organizuan dy cikle trainimesh nga ASPA në bashkëpunim me shkollën politike për politikanë dhe nëpunës civilë të lartë. Në ciklin e parë u regjistruan 25 veta por u çertifikuan 18 veta, ndërsa në ciklin e dytë u regjistruan 25 dhe u çertifikuan 16 veta<sup>27</sup>, gjithsej 24 persona të çertifikuar.

- Në vitin 2019 në nivel vendi, gjithsej 1,693 nëpunës dhe punonjës vendor të Bashkive kanë ndjekur programe trajnimi nga ASPA në fusha të ndryshme tematike; 1,089 persona janë trajnuar mbi legjislativën e nëpunësit civil. Mesatarja e nëpunësve të trajnuar mbi legjislativën e NC<sup>28</sup> ka qenë 18.2 për bashki në 2019 (N=60); Krahasuar me vitin 2018 dhe 2017, ky indikator ka qenë në rritje (2.5 here më shumë). Ndërsa Bashkia Maliq raporton se 125 nëpunës vendor kanë ndjekur programe të ndryshme trajnimi nga ASPA në 2019, Bashkia Sarandë raporton vetëm 1 nëpunës të trajnuar, e ndjekur nga Klos (2), Bashkia Delvinë (3), Bashkia Vlorë (3).

Grafiku 13: Nëpunës vendor të trajnuar, 2019



25 Raporti i performancës publikuar nga DAP në vitin 2019


26 KiE ëorkshop në Dhjetor 2019

27 Certifikata është validuar nga KiE, ASPA dhe Shkolla Politike

28 Bashkitë Gramsh, Durrës, Finiq, Ura Vajgurore, Shijak, Gjirokastrë, Has ndjekur trajnime mbi ligjin e NC.

- Nëpunësit e administratës vendore kanë përfituar duke ndjekur programe trajnimi edhe nga ofrues të tjerë shërbimi për trajnimet përveç ASPA, përfshirë projekte me financim të huaj – gjithsej 1,807 punonjës vendorë të trajnuar në 2019 (rreth 114 nëpunës më shumë të trajnuar nga ofrues të tjerë përveç ASPA).
- 91 nëpunës vendorë të trajnuar mbi Sistemin e Menaxhimit të Informacionit, ose mesatarisht 1.5, ndërsa mbi Kodin e Procedurave Administrative janë trajnuar 187 persona, ose mesatarisht 3 persona.


Grafiku 14: Nëpunës vendor të trajnuar, 2019



- Bashkitë planifikojnë fond shumë të vogël për trajnime. Niveli mesatar i fondit vendor për trajnime krahasuar me buxhetin vendor ka qenë 0.39%. Kryesisht fondi për trajnime mbulon kosto të disa shpenzimeve si transport, per diem.
- Nga 56 bashki është raportuar që 179 dokumenta strategjike janë përfshirë në dokumentin e planifikimit afat-mesëm të buxhetit vendor, ose mesatarisht 3 dokumentë strategjike, të cilat janë Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV), Plani i Mbrojtjes Sociale, Plani për integrimin e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, dhe plane të tjera zhvillimi. Ky tregues ka rritje, 91% e bashkive kanë kryer planifikimin në PBA të dokumentave strategjike, krahasuar me vitin 2018 (79% e bashkive).

### Probleme dhe sfida

- Bashkitë nuk alokojnë burime financiare nga buxheti i vet për qëllime trajnime, ose fondi është shumë i vogël për mbulimin e shpenzimeve të transportit. Bashkitë nuk mund të financojnë koston e trajnimit prej 5,000 ALL/ditë për punonjësit jashtë shërbimit civil për të ndjekur “programin - trajnim të avancuar, as edhe koston nga 3,000 ALL deri 7,000 ALL për trajnim të vazhdueshëm. Bashkia e Tiranës ka një fond më të madh për trajnime por legjislacioni aktual e kufizon për kontraktimin efektiv ofruesve të trajnimeve<sup>29</sup>.
- Biblioteka elektronike e-library nuk ka qenë funksionale dhe e aksesueshme nga nëpunësit vendorë. Ky system duhet të jetë funksional deri në momentin që një sistem i ri e-learning të ngrihet dhe të jetë funksional.
- Reagimi i bashkive për rishikimin e strukturave bazuar në modelet e rekomanduara në vitin 2019.
- Përmirësimi i sistemeve të performancës për integrimin e objektivave të organizatës në tregues performance të strukturave të Bashkive.
- Rritja e kapaciteteve të administrates publike në fushën e kompetencave funksionale dhe aftësisë për të vepruar bazuar në evidenca, rritja e aftësisë së monitorimit dhe raportimit.




- Dhënia e çertifikatës të trajnimit nga ASPA brenda një kohe të shkurtër mbas përfundimit të programit të trajnimit nga nëpunësi vendor.

## Rekomandime

- Zhvillimi i mëtejshëm i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njërëzore në nivelin vendor l ngritur me asistencën e Këshillit të Evropës me synim ngritjen e një Sistemi të Informatik të Integruar të Menaxhimit të Burimeve Njërëzore për nivelin vendor i cili të lidhet Thesarin dhe me bazën e të dhenavë të rregjistrit të gjendjes civile si dhe me sistemet e tjera për të mundësuar kontroll më transparent mbi pagat e administratës vendore, punësimin e tyre brenda territorit duke eliminuar dypunesimin apo abuzimet me emërimet në administratën lokale.
- Zhvillimi dhe plotësimi i bazës ligjore në plotësim të Ligjit nr139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” që mundëson NJQV të kontraktobj ofrues për trajnime për nevojat e tyre specifike, në ngjashmëri me klauzolat ligjore të VKM Nr. 138/2014 “Mbi Rregullat e Organizimit dhe Funksonimit të Shkollës Shqiptare për Administratën Publike (ASPA).
- Forcimi i sistemit meritokratik në administratën vendore përmes:
  - Forcimit të procedurave transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit të performancës së punonjësve bazuar në indikatorë të caktuar.
  - Forcimi i menaxhimit të burimeve njerëzore përmes trajnimeve dhe manualeve të mëtejshme, ndihmës së vazhdueshme për bashkitë që përballen me vështirësi në zbatimin e procedurave të burimeve njerëzore dhe përmes ndihmës për bashkitë që ende nuk e kanë asimiluar akoma përdorimin e platformës së burimeve njerëzore.
- Organizimi i rregullt i vëzhgimeve për performancën e nëpunësve vendor me synim përmirësimin e organizimit të punës dhe rritjen e performancës të bashkisë në të gjitha nivelet.
- Organizimi i programeve të trajnimeve për stimulimin e një roli më tepër aktiv për nëpunësin publik në nxitjen e inovacionit në sektorin publik.
- Të ofrohet mundësia e organizimit të trajnimeve për nëpunësit vendor në nivel rajonal.
- Planifikimi i një sistemi menaxhimi të cilësisë kompatibel me ISO:9011 / Common Assessment Framework (CAF) mund të planifikohet për tu zbatuar nga NJQ në shembullin e praktikave të mira të vendeve të BE<sup>30</sup>.
- Realizmi më i shpeshtë i Vlerësimit të Nevojave për Trajnim në mënyrë që të plotësohen nevojat dhe mungesat reale të administratës për trajnim.
- Hartimi i kurrikulave specifike të trajnimit dhe i programeve të trajnimit të përshtatura me nevojat e administratës në çdo nivel (niveli udhëheqës, drejtues dhe specialist).
- Trajnimet duhet të përfshijnë edhe anëtarët e Këshillave Bashkiakë, veçanërisht në fillim të mandatit të ri të Kryetarit të Bashkisë dhe të Këshillit Bashkiak.
- Kombinimi i trajnimeve në klasë me metodat e trajnimeve të drejtpërdrejta në punë.
- Zgjerimi nga ASPA i moduleve të trajnimit të mësimi elektronik si një instrument efikas për të përfshirë të gjithë administratën vendore.

30 CAF është një sistem vlerësimi që synon përmirësimin e Organizatave publike nëpërmjet vetëvlerësimit. Sistemi i vetëvlerësimit bazohet në dy shtylla: ‘Enablers Criteria’ që përmban 5 nen-kritere si drejtimi, strategjia dhe planifikimi, njerëzit, partneritetet dhe burimet dhe proceset; Kriteri i Rezultateve që përmban nën-kriteret: Rezultatet të orientuar nga qytetari, Përgjegjësia sociale dhe Rezultate kyçe të performancës



## Rekomandime mbi Trajnimet mbi Integrimin Evropian dhe Politikat e BE

- Në bashkëpunim dhe me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme e AMVV duhet të rris sesionet informuese për bashkitë në lidhje me strukturat e ngritura për procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.
- ASPA mund të krijojë rrjetin e zyrtarëve të trajnuar në nivelin vendor, të cilët të ndihmojnë në trajnimin e zyrtarëve të tjerë nëpërmjet komunikimit online. Trajnerët e kontraktuar nga ASPA mund të jenë pjesë e rrjetit për të marrë pjesë në diskutimet e tyre dhe rritjen e nivelit të dijeve.
- Rrjeti i profesionistëve tashmë i ngritur nga ASPA, mund të zgjerohet nëpërmjet krijimit të platformave online me vendet e rajonit e ndarë në dy grupe: 1. zyrtarët publik vendor të vendeve të rajonit që janë në të njëjtën fazë si ne në procesin e negociatave; 2. zyrtarët publikë vendor të vendeve të rajonit që janë një hap para nesh në procesin e negociatave si Serbia, Kroacia apo Mali i Zi. Në këtë mënyrë zyrtarët publikë mund të rrahin mendime dhe marrin eksperiencë nga vende të ndryshme në stadi të ndryshme (mëso nga eksperiencat e fqinjve). Një bashkëpunim i ngushtë me RESPA-n do të ishte e rekomandueshme në këtë rast.
- Duhet të realizohet njësimi i trajnimeve të ofruara nga ASPA dhe ato të ofruesve të tjerë për të njëjta tema trajnimi, në mënyrë të tillë që të rritet numri i zyrtarëve publikë vendor të trajnuar.
- AMVV dhe shoqatat e bashkive si ofruese të reja të trajnimeve në kuadër të forcimit të kapaciteteve vendore duhet të rakordojnë kalendarët e trajnimit me ASPA për të mospatur përsëritje të programeve të trajnimit të zhvilluar dhe për të ofruar kurrikula trajnimi të ndryshme nga ato që tashmë ofrohen nga ASPA.

### Objektivi specifik: rritja e transparencës në qeverisjen vendore

Procesi i njoftimit dhe konsultimit publik është rregulluar me anë të Ligjit Nr 146/2014. Bashkia kryen publikimin në rregjistrin elektronik të njoftimit për konsultim publik, të projektaktit dhe realizon publikimin në programin e transparencës<sup>31</sup> të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, si dhe dhënie të informacionit për procesin e konsultimit publik në të gjitha fazat.

Në procesin e konsultimit të politikave vendore të zhvillimit, të dokumentit të buxhetit afat-mesëm (PBA), dhe për konsultimin mbi paketën fiskale me komunitetin e biznesit, bashkitë përdorin kryesisht dëgjuesat dhe konsultimet publike me grupet e interesit, qytetarët, grupet komunitare dhe organizatat e shoqërisë civile.


Në vitin 2019, shkalla mesatare e rekomandimeve të qytetarëve, komunitetit të biznesit, OJF dhe grupeve të tjera në procesin e hartimit të dokumentit të planifikimit të buxhetit afat-mesëm ka qenë 24.2%. Mungojnë të dhënat për këtë tregues nga 22 bashki<sup>32</sup>. Bashkia e Tiranës, Bashkia Përmet, Bashkia Has dhe Bashkia Pukë raportojnë se 100% e rekomandimeve të qytetarëve janë reflektuar në dokumentin e PBA, ndërsa Bashkia Këlcyre ka pasqyruar vetëm 1.64% të rekomandimeve, e ndjekur nga Bashkia Gjirokastrë (2%).

31 Sipas ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

32 Bashkitë Kavajë, Peqin, Kucovë, Memaliaj, Prrënjës, Skrapar, Kurbin, Patos, Devoll, Bulqizë,, Shijak, Mallakastër, Klos, Maliq,, Belsh, Roskovec, Kamëz, Elbasan, Rrogozhinë, Krujë, Pustec dhe Ura Vajguore



Grafiku 15: Rekomandime të qytetarëve të përfshirë në dokumentat e planifikimit të buxhetit



Në nivel vendi, janë organizuar 382 dëgjesa publike në procesin e hartimit dhe konsultimit të PBA ose mesatarisht 6.6 dëgjesa (N=58).

### Problemet dhe sfidat

- Të rritet sensibilizimi i OJF-ve si edhe grupeve të interesit për një pjesëmarrje më aktive në dëgjesat për PBA-në; organizatat e shoqërisë civile të ofrojnë më shumë rekomandime për grupet e veçanta të komunitetit në procesin e hartimit të dokumentit të planifikimit afat-mesëm të buxhetit.
- Rritja e numrit të qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e konsultimit publik.
- Rritja e shkallës së reflektimit të rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në dokumentin e PBA/buxhetin kundrejt numrit të përgjithshëm të rekomandimeve.


### Rekomandime

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet organizatave vendore të shoqërisë civile dhe bashkive me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe motivimin e tyre për të qenë pjesë e vendimeve vendore, si edhe rritja e rolit monitorues të tyre si dhe komunitetit në mënyrë që të sigurohet trajtimi i të gjitha rekomandimeve përkatëse gjatë dëgjesave publike.
- Krijimi i një baze të dhënash të standardizuar dhe të unifikuar që mund të përfshijë statistika të ndryshme të rëndësishme për qytetarët dhe për të gjitha palët e interesuara dhe publikimi i tyre në mënyrë periodike në faqet e internetit të bashkive.

*Objektivi specifik: përmirësimi i llogaridhënies së administratës vendore*

Kuadri ligjor për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e organeve vendore është përcaktuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” të cilat rregullojnë procesin dhe vendosin disa standarde për rregjistrimin, shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve dhe kthim-përgjigjet për çështje administrative, ose aspekte të tjera të lidhura me kompetencat e bashkisë.

Grafiku 16: Shkalla e përgjigjeve të administratës vendore ndaj ankesave të qytetarëve




Ndonëse në dokumentin e politikave “Strategjia Ndërsektoriale Kombëtare e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore (SNKDQV)” parashikohet ngritja e një sistemi të menaxhimit për ankesat e qytetarëve, nuk raportohet qartë nga bashkitë nëse është realizuar një sistem i unikuar për ankesat dhe përgjigjet e qytetarëve.

Në 2019, shkalla mesatare e përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave të qytetarëve ishte 92.59%; ky tregues tregon rritje në krahasim me nivelin 82% të raportuar për vitin 2018, ose 10.59 p.p më i lartë në 2019.



Përmirësimi i llogaridhënies së administratës vendore është vlerësuar më treguesin që shpreh shkallën e publikimit të akteve të miratuar nga organi vendimmarrës në Bashki kundrejt numrit gjithsej të akteve të miratuara.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga bashkitë rezultojnë që vetëm 5 bashki kanë marrë rekomandime nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në vitin 2019.

Harta 2




Grafiku 17: Shkalla e publikimit të akteve të Këshillave Bashkiake



- Në vitin 2019, shkalla e publikimit të akteve ka qenë mesatarisht 64.75% i cili tregon rritje në krahasim me nivelin 56% të raportuar për vitin 2018.

Grafiku 18: Shkalla e publikimit të akteve të Këshillave Bashkiake, 2017-2019



#### Problemet dhe sfidat

- Ngritja e një sistemi të unifikuar dhe të integruar të menaxhimit të kërkesave/ankesave të qytetarëve dhe përgjigjeve nga administrata vendore.
- Dhënia e një informacioni të përgjithshëm në website të bashkisë mbi të dhënat e ankesave të qytetarëve dhe përgjigjeve nga administrata publike vendore.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive shtetërore në nivel rajoni dhe institucioneve vendore për adresimin e çështjeve të ngritura nga qytetarët dhe grupe të vecanta interesi.

#### Rekomandime


- Bashkitë dhe Njësitë Administrative duhet të mbështeten në konsolidimin e sistemit të Zyrës me një Ndalesë si një mekanizëm i rëndësishëm që regjistron çdo kërkesë/ankesë dhe monitoron të gjithë ecurinë e procedurës deri në momentin kur kërkesat e qytetarëve trajtohen siç duhet.
- Bashkitë duhet të sigurojnë gjithashtu edhe mekanizma të tjerë për qytetarët në mënyrë që ata të kenë forma të ndryshme aksesit/komunikimit për të trajtuar shqetësimet e tyre (kërkesa/ankesa). Këto mekanizma duhet të jenë të aksesueshëm në mënyrë të pakufizuar për çdo person që duhet të trajtojë një ankesë.
- Bashkitë të organizojnë sondazhe të rregullta mbi perceptimin e qytetarëve për shërbimet e ofruara nga bashkia për të gjitha funksionet dhe kompetencat që ushtrohen nga NJQV të përcaktuara me ligj.
- Bashkitë duhet të forcojnë mekanizmat e tyre të kontrollit të brendshëm, në mënyrë që të rrisin nivelin e llogaridhënies së tyre.

## 1.2. Avokati i Popullit

Avokati i Popullit (AP) vepron në bazë të Ligjit nr.8454/1999, plotësuar me ligjin 8600/2000, ndryshuar me Ligjin 9398/2005, shtuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 155/2014. AP trajton ankesa të cilat grupohen në: (i) ankesa jashtë juridiksionit, (ii) ankesa jashtë kompetencave, (iii) ankesa të pabazuara, (iv) ankesa me rekomandime të pranuar, (v) ankesa të pranuar pa rekomandim (të zgjidhura në favor të qytetarit, ankesa me heqje dore.

Objektivi specifik mbi përmirësimin e shqyrtimit të kapaciteteve të bashkive raportet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit është vlerësuar më anë të tre treguesve:


Grafiku 19: Rekomandime të AV për NJQV, 2019



Numri i raporteve me vërejtje dhe rekomandime të Avokatit të Popullit (AP) të paraqitur pranë bashkive. Në vitin 2019, AP ka dërguar 270 rekomandime për 55 bashki, me një vlerë mesatare 4.9; Treguesi është është më i ulët krahasuar me vitin 2018 (vlera mesatare 11 rekomandime), dhe me vitin 2017 (7 rekomandime). Numri i bashkive që kanë raportuar është më i lartë në krahasim me vitet e mëparshme.


Nga 270 rekomandime të paraqitura nga Avokati i Popullit në 2019, gjithsej janë raportuar 196 rekomandime të cilat janë adresuar nga administrata vendore, ose 72.95%; pjesa tjetër e rekomandimeve kanë qenë në proces shqyrtimi nga nëntë bashki<sup>33</sup>, brenda afateve kohore të përcaktuara më ligj. Bashkia Fier ka marrë numrin më të madh të rekomandimeve (45), nga të cilat 30 janë pranuar dhe janë në proces adresimi (30/45), pasuar nga Bashkia Sarandë (20 / 30) dhe Bashkia e Tiranës (21 / 21).

Grafiku 20: Rekomandime të AP të pranuar nga NJQV



33

Bashkitë Fier, Roskovec, Durrës, Sarandë, Konispol, Patos, Kolonjë, Divjakë, Dropull.



## Problemet dhe sfidat

- Forcimi i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit për ndjekjen e rasteve të referuara.
- Bashkitë duhet të angazhohen për të adresuar në kohë rekomandimet e Avokatit të Popullit në bashkëpunim me institucionet e tjera publike dhe aktorë të tjerë në nivel vendor.

## Rekomandime

- Bashkitë duhet të rrisin kapacitetet e tyre për hartimin e përgjigjeve zyrtare në nivelin e kërkuar drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.
- Është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me bashkitë dhe të krijohen mekanizma “detyrues” në mënyrë që bashkitë dhe të gjitha institucionet e tjera publike t’i marrin parasysh këto rekomandime të rëndësishme.
- Duhet të ngrihet një mekanizëm raportimi transparent nëpërmjet një sistemi të unifikuar on-line për të siguruar mbledhjen e informacionit të saktë dhe të detajuar nga bashkitë, të cilat të jenë publike.
- Parlamentit Shqiptar duhet të forcojë rolin monitorues për të monitoruar sistematikisht nivelin e zbatimit të rekomandimeve.


## 1.3. Shoqëria civile

Për të mbështetur fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile është realizuar rishikimi i Udhërrëfyesit 2019 – 2023; ky udhëzues përcakton dy drejtime strategjike: (i) Bashkëpunimin e institucionalizuar qeveri-shoqëri civile në politik-bërje dhe në procesin e integritit evropian, i cili përmban pesë prioritete, dhe (ii) Mundësimin e mjedisit ligjor dhe qeverisjes së të dhënave - objektiv me 4 prioritete. Zbatimi i udhërrëfyesit monitorohet nga Kryeministria. Në vitin 2019, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) ka vlerësuar 161 projekt-propozime nga organizatat OSHC dhe ka mbështetur 52 prej tyre për zbatimin e projekteve në fusha të ndryshme.


*Objektivi specifik: forcimi i rolit të shoqërisë civile dhe rritja e bashkëpunimit në nivel vendor*

Progresi i objektivit vlerësohet nga pesë tregues të përzgjedhur:

- Në 2019, gjithsej janë dhënë 270 rekomandime nga organizatat e shoqërisë civile në proceset e politik-bërjes dhe vendimmarrjes vendore për çështje të ndryshme interesi. Në krahasim me 2018, treguesi ka një rritje me 7% të numrit të rekomandimeve të raportuara nga bashkitë. OSHC në Bashkinë Durrës kanë dhënë numrin më të madh të rekomandimeve (136), pasuar nga Bashkia e Tiranës (29) dhe Bashkia Fier (16).
- Rreth 72.59% e rekomandimeve të OSHC janë marrë në shqyrtim nga bashkitë (mesatarisht 3.5 rekomandime, në krahasim me 3 rekomandime mesatarisht të dhëna në 2018).
- 49.62% e rekomandimeve të OSHC janë pranuar nga organet e vendim-marrjes vendore (N=56, mesatarisht 2.4 rekomandime). Bashkia Durrës ka numrin më të madh të rekomandimeve të pranuar (40), ose 29.4% të totalit të rekomandimeve, Bashkia Përmet 14/14 ose 100% të rekomandimeve, dhe Bashkia Shkodër 12 (ose 100% të rekomandimeve).



Grafiku 21: Rekomandime të OSHC pranuar nga NJQV në procesin e vendimmarrjes vendore



## Kutia 2: Tirana fituese e “Kryeqyteti Rinor Evropian 2022”<sup>34</sup>

Kryeqyteti i Shqipërisë, Tiranë është shpallur fituese e “European Youth Capital 2022”. Ky çmim jepet nga Forumi Evropian Rinor, i cili mes 5 qyteteve zgjodhi Tiranën si kryeqendrën e të rinjve për vitin 2022. Njoftimi i fituesit shoqërohej me mesazhin “Urime Tirana! Ju keni treguar një angazhim të madh për të ndërtuar një trashëgimi të qëndrueshme që do t’i vendosë të rinjtë në zemrën e qytetit tuaj”. Kryeqyteti Rinor Evropian krijon një ndikim pozitiv në shumë fusha:

- ✓ Hap mundësi të reja
- ✓ Sjell ndryshim pozitiv
- ✓ Inkurajon pjesëmarrjen aktive
- ✓ Promovon vullnetarizmin
- ✓ Nxiti identitetin evropian
- ✓ Diversiteti dhe përfshirja e kampionëve
- ✓ Forcon organizatat rinore
- ✓ Rrit investimet në rininë
- ✓ Përmirëson zërin e Tiranës në Evropë
- ✓ Kthen qytetin e Tiranës në një pikë takimi ndërkombëtar
- ✓ Lidh të rinjtë e vendeve të ndryshme evropiane




Kryeqyteti Rinor Evropian është një titull i dhënë nga Forumi Rinor Evropian i krijuar për të fuqizuar të rinjtë, forcimin e pjesëmarrjes së të rinjve dhe forcimin e identitetit evropian. Çdo vit, një qytet i ri evropian i jepet mundësia të shfaqë idetë, projektet dhe aktivitetet e tij inovative që synojnë të ngrejnë zëra të rinj dhe të sjellin një perspektivë të re rinore për të gjitha aspektet e jetës së qytetit. Aplikimi për këtë çmim ishte fryt i bashkëpunimit të ngushtë të ekipit të Bashkisë Tiranë dhe Këshillit Rinor si dhe mbështetjen dhe bashkëpunimin e një sërë organizatash rinore në Tiranë.

<sup>34</sup> Fituesi u zgjodh nga një juri e pavarur që përbëhej nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të mëposhtme: Parlamenti Evropian, Komiteti i Rajoneve, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian, Këshilli i Komunave dhe Rajoneve Evropiane, Këshilli Këshillimor i Rinisë i Këshillit të Evropës, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Fondacioni Schëarzkopf Evropa e Re, Nisma e Shoqërisë së Hapur për Evropën, IDEA Ndërkombëtare, EurActiv, Lëvizja Evropiane Ndërkombëtare, Eurodesk dhe Forumi Rinor Evropian.

- Në 2019, vetëm 18 bashki (ose 29.5% e bashkive) kanë dhënë 71 grante për Organizatat vendore të Shoqërisë Civile për zbatimin e projekteve në nivel vendor për çështje të punësimit të rinjve, zhvillimin e turizmit, agro-biznesin, ruajtjes dhe kultivimit të traditave në handicraft dhe projekte në fusha të tjera të interesit. Ky tregues është në të njëjtin nivel me vitin 2018. Bashkia e Shkodrës ka dhënë numrin më të madh të granteve (18), pasuar nga Bashkia e Lezhës (10), Bashkia e Përmetit (7) dhe Bashkia e Poliçan (5); Bashkitë që kanë dhënë vetëm 1 grant për OSHC janë bashkitë e Tropojës, Durrës, Shijak, Librazhd, Elbasan.
- Vlera totale e financuar nga Bashkitë për zbatimin e marrëveshjeve të granteve nga OSHC në partneritet me shërbimet e bashkive ka qenë 204,553,056 Lekë.

Grafiku 22: Grante nga NJQV për projekte në partneritet me OSHC, 2019



Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor<sup>35</sup> (ReLOaD) ka mbështetur zbatimin e 40 projekteve të reja për 12 bashkitë partnere gjatë vitit 2019.

### Problemet dhe sfidat

- Administrimin efektiv të projekteve bazuar në kriteret dhe standartet më të mira të ciklit të menaxhimit të projekteve.
- Mungesa e kapaciteteve financiare nga bashkitë për financimin ose co-financimin e projekteve në bashkëpunimin me agjencitë donatore.

### Rekomandime

- Forcimi i kapaciteteve të OSHC dhe nëpunësve publikë vendorë në hartimin e projekteve të reja dhe mbështetjen e iniciativave qytetare dhe grupeve në nevojë në partneritet me bashkitë.
- Fuqizimi i kapaciteteve të OSHC për të luajtur më me efikasitet rolin e tyre monitorues dhe avokatisë për të përcjellë zërin e komunitetit
- Përfshirja më e madhe e OSHC nga ana e bashkive në procesin e politik-bërjes vendore dhe monitorimin e zbatimit të planeve vendore, dhe përmirësimin e standardeve për shërbime të ndryshme të përcaktuara në ligj.
- Rritja e numrit të aplikimeve nga bashkitë në partneritet me OSHC në përgjigje të thirrjeve për projekt-propozime nga agjencitë donatore.

35 Projekti ReLOaD financohet nga fondi BE (IPA)

## KONKLUZIONE MBI DEMOKRACINË

Në 2019, përfaqësimi i femrave në pozicionin e nën.kryetarit të Bashkisë për të gjitha bashkitë ishte 34.9%, ndërsa mesatarja e përfaqësimit të femrave si anëtare të organit vendim-marres (Këshillit Bashkiak) ka qene 41.02% kundrejt 34.8% që ishte mbas zgjedhjeve lokale të 2015. Nëpunës civil femra në administratën vendore kanë qenë 2,595 (ose 60.7% të numrit të përgjithshëm të NC). Niveli i femrave në pozicione drejtimi (sekretar përgjithshëm, drejtor, drejtues i Njësisë Administrative) është më i ulët se niveli i punësimit të femrave në administratën vendore - 35.9%.

**Vazhdojnë përpjekjet për të forcuar kapacitetet e administratës vendore, ndërkohë që menaxhimi i burimeve njerëzore dhe qëndrueshmëria financiare e trajnimit mbeten një sfidë.**


Në 2019, vëmendje ka patur përmirësimi i koordinimit të proceseve të drejtuara nga njësitë e burimeve njerëzore, rritja e performancës së administratës publike, ristrukturimi i institucioneve të varësisë dhe agjensive shtetërore, zgjerimi dhe përmirësimi cilësor i bankës së pyetjeve, bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë për përthithjen e kandidatëve potencialë dhe të sapodiplomuar; është bërë funksional portali i administratës publike [administrata.qj](http://administrata.qj), dhe është kryer trajnimi i 200 nëpunësve të menaxhimit të burimeve njerëzore (MBNJ) mbi përdorimin e platformës.

Kanë vijuar përpjekjet për përmirësimin e sistemit të trajnimeve të ASPA: është hartuar manuali i hartimit të pyetjeve të testimit në ASPA, janë rishikuar pjesa më e madhe e pyetjeve të testeve për programe ekzistuese të trajnimeve sipas manualit; integrimi i parimeve të qeverisjes së mirë në kurrikulat ekzistuese, është hartuar një metodologji për futjen e sistemit të krediteve në ASPA, si dhe janë riformuluar rreth 15 kurrikula sipas sistemit standard. Më shumë trajnime janë realizuar nga ASPA në vitin 2019 në krahasim me vitet 2017 dhe 2018; 1,693 nëpunës dhe punonjës vendorë të Bashkive të trajnuar nga ASPA në fusha të ndryshme tematike; 1089 persona të trajnuar mbi legjislacionin e nëpunësit civil.

Zhvillimi i mëtejshëm i kuadrin ligjor për qeverisjen vendore që të mundësojë kontraktimin e ofruesve të shërbimeve për trajnime të financuar nga burimet e vetë bashkise dhe në ngjashmëri me modalitetet e përcaktuara në VKM Nr. 138/2014 "Mbi Rregullat e Organizimit dhe Funksionimit të Shkollës Shqiptare për Administratën Publike (ASPA) do të mundësonte përdorimin e më shumë fondeve për trajnime sipas nevojave specifike të bashkive. Mbetet sfidë përmirësimi i sistemeve të performancës për integrimin e objektivave të organizatës në tregues performance të strukturave të Bashkive (nivel drejtorie dhe sektori, shërbimi), si dhe rritja e kapaciteteve të administratës publike në fushën e kompetencave funksionale dhe aftësive për të vepruar bazuar në evidenca, rritjes së aftësisë së monitorimit dhe raportimit për treguesit e performancës në sektorë të ndryshëm të qeverisjes vendore. Një system i menaxhimit të cilësisë kompatibel me ISO:9011 mund të planifikohet për tu zbatuar nga NJQV në shëmbullin e praktikave të mira të vendeve të BE.

**Është bërë progres drejt zgjerimit të sistemit të zyrave të integruara me një ndalesë (One-stop-Shop) të cilat në fund të 2019 ishin funksionale në 41 bashki (67% të bashkive), ose 18 % p.p. me shumë krahasuar me vitin 2018. Mesatarisht 47 shërbime administrative janë ofruar nga OSSH.**

**Trajtimi i kërkesave të qytetarëve për informacion apo i ankesave të tyre si pjesë e forcimit të llogaridhënies së pushtetit vendor është përmirësuar.** Gjithashtu është përmirësuar shkalla e llogaridhënies së administratës vendore e shprehur me nivelin e publikimit të akteve të miratuara nga organi vendimmarrës në Bashki






kundrejt numrit gjithsej të akteve të miratuara. Në vitin 2019, ky tregues ka qenë mesatarisht 64.75% i cili tregon rritje në krahasim me nivelin 56% të raportuar për vitin 2018 administrative të bashkisë së tyre.

Rritja e transparencës së financave vendore: 93.4% e bashkive kanë hartuar buxhetin e tyre me metodën me pjesëmarrje; treguesi ka rritje të lehtë me 1.4 p.p krahasuar me 2018. Në 2019, në dëgjuesat publike për planifikimin e buxhetit vjetor kanë marrë pjesë rreth 32,895 qytetarë ose mesatarisht 567 qytetarë për 57 bashki (me vlerë më të vogël krahasuar me 2018). Shkalla mesatare e rekomandimeve të qytetarëve, komunitetit të biznesit, OJF që janë reflektuar në dokumentin e planifikimit të buxhetit afat-mesëm ka qenë 24.2%. Vlera e treguesit do të rezultonte më e lartë, por 22 bashki nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme. Ka nevojë për forcimin e zërit të bashkive të vogla dhe të mesme dhe Këshilli i Qarkut mund të lehtësojë dialogun për aspekte të mire-qeverisjes vendore në nivel territori më të madh se bashkia.

**Vëmendje i kushtohet shqyrtimit dhe trajtimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të raporteve të Avokatit të Popullit.** Rreth 270 rekomandime janë paraqitur nga AP për 55 bashki, me një vlerë mesatare 4.9 që është më e ulët në krahasim me 2018; 72.95% e rekomandimeve janë adresuar nga administrata vendore bashkive, ndërsa pjesa tjetër e rekomandimeve ka qenë në proces shqyrtimi nga nëntë bashki brenda afateve kohore të përcaktuara më ligj. Mbetet sfidë për bashkitë forcimi i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit për ndjekjen e të gjitha rasteve të referuara në kohë.

**Konsolidimi i shoqërisë civile në nivel vendor mbetet një sfidë.** Më shumë rekomandime janë dhënë nga shoqëria civile në proceset e politik-bërjes dhe vendimmarrjes vendore në 2019 për çështje të ndryshme interesi – gjithsej 270 rekomandime (ka rritje me 7% të numrit të rekomandimeve në 2018), nga të cilat 49.6% janë pranuar nga Këshilli Bashkiakë. Rreth 29.5% e bashkive kanë dhënë grante për Organizatat vendore të Shoqërisë Civile (71 grante gjithsej) për zbatimin e projekteve në nivel vendor për çështje të punësimit të rinjve, zhvillimin e turizmit, agro-biznesin, ruajtjes dhe kultivimit të traditave në handicraft dhe projekte në fusha të tjera interesi; ky tregues është në të njëjtin nivel me vitin 2018. Mbetet sfidë forcimi i kapaciteteve të OSHC, përfshirja e tyre më e madhe në hartimin e politikave të zhvillimit vendor, monitorimi i zbatimit të planeve vendore të veprimit dhe monitorimi i cilësisë të shërbimeve publike të ofruara nga administrata vendore përkundrejt standarteve të miratuara me ligj.

Harta 3



## 1.4. Shteti i së drejtës


### 1.4.1. Lufta kundër korrupsionit

Një nga prioritetet dhe rekomandimet kryesore të Bashkimit Evropian për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë është lufta kundër korrupsionit. Progresi në arritjen e rezultateve në këtë fushë vlerësohet nëpërmjet tre objektivave specifike: (i) forcimit të regjimit dhe zbulimit të kontrollit të pasurive të zyrtarëve publike si dhe menaxhimit të konfliktit të interesit, (ii) ngritja e kapaciteteve të administratës së qeverisjes vendore në luftën kundër korrupsionit, (iii) miratimi i politikave anti-korrupsion në nivel vendor. Draft Plani i Veprimit 2019-2023, është rishikuar në përputhje me objektivat e strategjisë kundër korrupsionit dhe të pasaportës së indikatorëve (37 indikatorë performance), dhe 93 masa konkrete antikorrupsion të ngritura mbi bazë rezultati, performance e impakti.

*Objektivi specifik: përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit.* Objektivi është vlerësuar nëpërmjet katër treguesve të performancës:

- Në 2019, nga Bashkitë (N=58) janë rregjistruar gjithsej 162 ankesa, ose 2.7 ankesa për bashki për shkelje të procedurave administrative përfshirë prokurimin publik.
- Mesatarisht 2 persona të zgjedhur në bashki kanë kryer deklarimin e pasurisë në përputhje me ligjin<sup>36</sup>. Mbas zgjedhjeve të datës 30 Qershor 2019, dhe për arsye të ndryshimeve të strukturave në disa bashki, personat e zgjedhur dhe nëpunës të lartë të punësuar kanë plotësuar formularin e deklarimit e deklarimit të pasurisë.
- Vetëm 12 bashki<sup>37</sup> (19%) kanë patur raste të deklarimit të konfliktit të interesit, gjithsej 353 raste, ose mesatarisht 5.98 për bashki. Bashkia Konispol ka patur numrin më të madh të rasteve (168), pasuar nga Bashkis Gjirokastër (100), ndërsa Bashkitë e Tiranë, Vlorës, Kukës, Librazhd dhe Has kanë patur 1 rast.
- Caktimi i nëpunësit publik në kapacitetin e koordinorit vendor anti-korrupsion në zbatim të Planit të Veprimit në luftën kundër korrupsionit është kryer nga 55.7% e bashkive<sup>38</sup>, duke qëndruar në të njëjtin nivel krahasuar me 2018.

Grafiku 23: Caktimi Koordinatorit Vendor anti-korrupsion



Harta 4



36 Ligji nr.9049/2003, I ndryshuar "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike"


37 Bashkitë Konispol, Gjirokastër, Divjakë, Pustec, Kuçovë, Maliq, Vlorën Tiranë, Kukës, Librazhd, Has.

38

## 5.2 Objektiv i specifik: ngritja e kapaciteteve të administratës së qeverisjes vendore për të luftuar korrupsionin

- Në 2019, tridhjetë e nëntë përqind (39%) e bashkive kanë ndjekur trajnime në fushën e anti-korrupsionit, ose mesatarisht 1 trajnim për bashki (N=52), gjithsej 46 trajnime. Niveli i trajnimeve për vitin 2019 është i njëjtë me vitin 2017 por më i ulët se trajnimet në 2018 (mesatarisht 2 trajnime të kryera për bashki). Bashkia Peqin ka patur numrin më të madh të trajnimeve të ndjekuar, 11 bashki kanë ndjekur një program trajnimi.
- Bashkitë që nuk kanë zyra shërbimi të integruara me një ndalesë kanë patur vështirësi në përditësimin e regjistrit elektronik të bashkisë të kërkesave dhe ankesave sipas afateve të përcaktuar në legjislacion<sup>39</sup>, ose mungesa të paisjeve të zyrës<sup>40</sup>.

Grafiku 24: Pjesëmarrje në trajnime në fushën anti-korrupsion



### Kutia 3 : Praktika të mira në përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe ankesave

**Bashkia e Dibrës** përditëson dhe mirëmban regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve të dhëna ndaj qytarëve.

**Bashkia e Tiranës, Cërriku, Gramsh, Mallakastër, Maliq** e përditësojnë rregjistrin cdo tre muaj.

**Bashkia e Korcës, Shkodrës, Maliq** menaxhon përditësimin cdo muaj.

**Bashkia e Durrësit** kryen përditësimin periodik për ankesat dhe prokurimet publike, kërkesat për informacion bazuar në të drejtën e informimit.

**Bashkia Berat** realizon përditësimin në mënyrë periodike, sidomos për ankesat referuar prokurimeve publike dhe kërkesat për informacion për sektorë të tjerë.

**Bashkia Vlorë:** Koordinatorin për të drejtën e informimit menaxhon dhe përditëson regjistrin e kërkesave për informacion. Regjistri i organizuar në periudha tre-mujore.

**Bashkia Krujë** realizon përditësimin cdo 6-muaj.

**Bashkia Patos** nuk ka ende një sistem të integruar, por regjistri i ankesë-kërkesave bëhet sipas ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".


39 Bashkia Bulqizë  
40 Bashkia Devoll

Në 2019, rreth 47.5% e bashkive kanë përditësuar periodikisht rregjistrin elektronik të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve. Një pjesë e bashkive ofrojnë informacion në ëbsite të bashkisë si pjesë e programit të transparencës. Ka raste që bashkitë nuk kanë një database por e mbajnë rregjistrin në formë tjetër në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit. Vlera e treguesit në 2019 është më ulët se vlera e raportuar nga bashkitë në 2018 (57%).

Nga të dhënat e raportuara rezulton se rreth 37.7% e bashkive në 2019 kanë ngritur mekanizmin e monitorimit dhe vlerësimit (M&V) për ofrimin e shërbimeve publike dhe ndihmën ekonomike.

Grafiku 25: Përditësimi i rregjistrit elektronik të NJQV


■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna



Harta 5

Grafiku 26: Mekanizmi i M&V për shërbimet publike


■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna



Harta 6

Grafiku 27: Plan Integriteti në nivel vendor, 2019

■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna



Harta 7




### 5.3 Objektivi specifik: miratimi i politikave anti-korrupsion në nivel vendor

Një nga masat e parashikuara në Planin e Veprimit Anti-Korrupsion 2018-2020<sup>41</sup>, të drejtuar nga Ministria e Drejtësisë, është hartimi dhe miratimi i planit vendor të Integritetit.

Treguesi mbi Planin Vendor të Integritetit evidenton progres me +8.2 p.p më i lartë kundrejt 2018; Bashki që raportojnë mbi miratimin e Planit të Veprimit Anti-Korrupsion në 2019, janë Bashkitë e Vau të Dejës, Memaliaj, Tepelenë, Selenicë, Peqin dhe Kurbin.

Grafiku 28: Plan Integriteti në nivel vendor i miratuar nga KB, 2017-2019



Nga 16 bashki që kanë miratuar planin vendor të integritetit, rreth 37.5% e tyre kanë përfshirë në parashikimet e buxhetit vendor, mjetet financiare për zbatimin e masave të planit vendor. Mungesa e përfshirjes së masave të planit vendor në planifikimin e buxhetit dëmton zbatimin efektiv të tij.

#### Problemet dhe sfidat

- Zbatimi i planit të Veprimit Anti-korrupsion dhe zbatimi i legjisllacionit.
- Ndërgjegjësim ende i ulët dhe informimi i qytetarëve për të denoncuar rastet e shkeljeve dhe praktikat korruptive si dhe parandalimi i tyre.
- Vonesa në caktimin e koordinatorit vendor anti-korrupsion nga të gjitha bashkitë dhe trajnimi i tyre.
- Mungesa e specialistëve të teknologjisë së informacionit për sigurimin e përditësimit dhe mirëmbajtjen e sistemit të të dhënave (databazës).
- Marrja e masave nga bashkitë për zbatimin e detyrimit të politikave kombëtare në luftën kundër korrupsionit dhe parashikimin e detyrimeve në buxhetet vendore dhe PBA.
- Mungesa e bashkërendimit të duhur ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore për të siguruar zbatimin e masave të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit Anti-korrupsion.

#### Rekomandime

- Hartimi i Planeve Vendore Kundër Korrupsionit për secilën bashki, si një objektivi i parashikuar në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 .
- Rritja e kapaciteteve të bashkive për hartimin e planeve vendore kundër korrupsionit. Kapacitetet duhet të rriten përmes trajnimeve përkatëse nga Ministria e Drejtësisë.

41

Planin është hartuar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

- Bashkitë duhet të ndërtojnë një sistem për të raportuar, ndjekur dhe zgjidhur rastet e korrupsionit. Ato duhet të hartojnë gjithashtu edhe disa rregulla të brendshme për të ndjekur rreziqet e korrupsionit në nivelin vendor, si dhe të vendosin disa sanksione për shkeljet administrative për të zvogëluar rastet e korrupsionit.
- OShC-të vendore duhet të rrisin rolin e tyre në luftën kundër korrupsionit, të rrisin njohuritë dhe të përmirësojnë kapacitetet e tyre në funksion të monitorimit dhe rritjes së vetëdijësitit të komunitetit dhe administratës vendore për çështjet anti-korrupsion.
- Përmirësimi i koordinimit ndërmjet ministrive respektive dhe NJQV si dhe mbështetje me ekspertizë nga institucionet qendrore në draftimin e planit vendor të integritetit për luftën kundër korrupsionit.
- Pajisja me një regjistër elektronik për bashkitë që nuk e kanë ende funksionale sipas udhëzimit të legjislacionit.
- Marrja e masave nga bashkitë për zbatimin e detyrimit të politikave kombëtare në luftën kundër korrupsionit dhe parashikimin e detyrimeve në buxhetet vendore dhe PBA.
- Sigurimi i bashkërendimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore për të siguruar zbatimin e masave të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit Anti-korrupsion.

## KONKLUZIONE MBI SHTETIN E SË DREJTËS

**Zbatimi i rregullave të deklarimit të pasurive dhe të kontrollit të konfliktit të interesit ka treguar progres në 2019 krahasuar me vitet 2017, 2018.** Të gjithë kryetarët e bashkive kanë dorëzuar në vitin 2019 deklaratën e pasurive sipas legjislacionit; mesatarisht 2 nëpunës për bashki kanë plotësuar deklaratën. Kjo tregon përmirësim krahasuar me vitin 2017 dhe 2018. Rreth 19% e NJQV kanë raportuar për 353 raste të deklarimit të konfliktit të interesit (ose 9% më shumë bashki në krahasim me 2018).

Rrjeti i koordinatorëve vendorë kundër korrupsionit është ngritur në 55.7% (ose 2.7 p.p. me shumë se 2018, dhe 19.7 p.p. se 2017). Mesatarisht 1 trajnim për bashki është ndjekur në fushën e anti-korrupsionit.

**Mekanizmi i monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve publike** dhe ndihmës ekonomike është ngritur dhe berë funksional nga 23 bashki (ose 37.7%). Ngritja e këtij mekanizmi është shumë e rëndësishme për të siguruar ofrimin me cilësi dhe me standarte të shërbimeve publike dhe administrative që ofrohen nga NJQV.

**Harmozimi i masave të planit kombëtar anti-korrupsion, 2018-2020 dhe planeve vendore të integritetit ka progres.** Ndonëse vlera e treguesit është në nivelin e 26.2% të bashkive në 2019 dhe ka rritje krahasuar me vitin 2018 (15% e bashkive), planet vendore duhet të ishin hartuar nga pjesa më e madhe e bashkive.


### 1.5. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave

*Objektivi specifik: ngritja e kapaciteteve të vetëqeverisjes vendore për të zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut*

Kuadri ligjor për të drejtat e njeriut në Shqipëri është i plotë dhe në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe që përfshin ligjet për mbrojtjen nga diskriminimi dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare<sup>42</sup>. Në zbatim

42

Kushtetuta e RSH, ligji Nr. 10221 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Ligji Nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare".



të politikave kombëtare, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe NJQV kanë hartuar planin kombëtar dhe planet vendore që synojnë zbatimin e masave për sigurimin e standarteve të të drejtave të njeriut dhe pakicat kombëtare, njohjen e diversitetit kulturor dhe promovimin e kohezionit social për grupet më vulnerabël.

- Ngritja e kapaciteteve të nëpunësve publikë vendorë për zbatimin e standarteve të të drejtave të njeriut ka vijuar në vitin 2019 nga 42.6% e bashkive; gjithsej janë kryer 114 programe trajnimi, ose mesatarisht 2 trajnime për çdo bashki (N=26).
- Gjithsej janë trajnuar 98 nëpunës vendorë<sup>43</sup> mbi zbatimin e standarteve të të drejtave të njeriut. Rezulton se trajnimet për vitin e raportimit kanë qenë rreth 2.8 herë më pak në krahasim me 2018. Më shumë nëpunës të trajnuar kanë qenë nga Bashkia Shkodër (20), Bashkia Përmet (12), Bashkia Mirditë (12), pasuar nga Bashkia Përmet (8).

Bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile për zbatimin e projekteve dhe iniciativave në nivel vendor në mbrojtje dhe në zbatimin e të drejtave të njeriut dhe me interes të përbashkët me NJQV, është evidentuar nga 26 bashki në 2019 (ose 42.6% të bashkive). Në krahasim me 2018, niveli i bashkëpunimit të bashkive me OSHC është rritur me 11.6 p.p. Bashkia e Tiranës, Elbasanit dhe Shkodrës kanë mundur bashkëpunimin me numrin më të madh të organizatave OSHC në projekte në mbrojtje të të drejtave të njeriut.



#### Kutia 4- Bashkëpunimi i Bashkisë Përmet me organizatat e shoqërisë civile

Në Bashkinë Përmet ushtrojnë veprimtarinë një numër i vogël i organizatave të shoqërisë civile, por ato janë mjaft aktive. Bashkëpunimi i bashkisë me to ka qenë dhe vazhdon të jetë i mirë. Ky bashkëpunim fokusohet në disa aspekte:


**Mbështetje e drejtpërdrejtë me grante:** Bashkia Përmet është një ndër 12 bashkitë fituese të Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (RELOAD) të financuar nga BE. E gjithë skema e grantit shërbeu për të mbështetur projektet e OSHC-ve në përputhje me prioritetet e Bashkisë Përmet. Në kuadër të këtij programi në 2019 u hap thirrja e dytë dhe përfutuese kanë qenë 5 OSHC me një buxhet total prej 7,446,080 lekë. Thirrja e tretë do të hapet në vitin 2020 me fonde të vetë Bashkisë. **Mbështetje financiare dhe jofinanciare në organizimin e aktiviteteve:** Bashkia Përmet ka mbështetur gjatë vitit 2019 financiarisht disa OSHC si Klubi i Shkrimtarëve "Naim Frashëri", CESVI, Pro Përmet, Slow Food etj në organizimin e eventeve të rëndësishme për promovimin e territorit si Dita e Verës, Terra Madre Day, Ditët Naimiane etj. Bashkia ka ofruar mbështetje në ambiente, bazë materiale, burime njerëzore për të gjitha organizatat që kanë implementuar projekte në Përmet. Bashkia mbështeti organizatën Pro Përmet në ndërtimin e inkubatorit të produkteve tipike lokale duke vendosur në dispozicion një prej objekteve në pronësi të saj (me një sipërfaqe truall 3315 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 415 m<sup>2</sup>)

**Përfshirja në vendim-marrjen vendore:** Disa organizata të shoqërisë civile janë mjaft aktive në proceset e politik- bërjes dhe vendim-marrjes vendore. Bashkia Përmet është e hapur dhe i shqyrton me kujdes rekomandimeve e tyre. Në vitin 2019 100% e rekomandimeve të tyre janë pranuar dhe ato kanë luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin e dokumentave strategjikë

43

Bashkia Shkodër ka patur numrin më të madh të personave të trajnuar (20 nëpunës).

Grafiku 29: Raste të referuara të shkeljes së të drejtave të njeriut




Raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut janë referuar nga 15 bashki, gjithsej 166 raste në vitin 2019, ose rreth dy herë më pak se numri i rasteve të referuara në vitin 2018. Bashkia Berat ka raportuar numrin më të madh të shkeljeve të të drejtave të njeriut (38 raste), pasuar nga Bashkia Has (29 raste); rreth 59% e bashkive nuk kanë patur raste të referuar të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Nga grupet ndërinstitucionale që funksionojnë në nivel vendor më përfaqësimin e stafit të bashkisë, në vitin 2019 janë trajtuar gjithsej 475 raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut, ose mesatarisht 8.64 raste për 55 bashki raportuese; 17 bashki ose rreth 27.8% e bashkive kanë menaxhuar rastet, kurse 62.29% e bashkive nuk kanë patur raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut të trajtuara nga grupet ndërinstitucionale.

Harta 8




Harta 9





Grafiku 30: Raste të referuara të shkeljes së të drejtave të njeriut



### Problemet dhe sfidat

- Numri i vogël i organizatave të shoqërisë civile në fushën e të drejtave të njeriut.
- Vështirësitë për të identifikuar rastet e shkeljeve për shkak të ngurrimit të qytetarëve për t'i raportuar në bashki ose zyra të tjera, dhe mungesa e koordinimit të procesit të identifikimit të rasteve me institucionet e tjera lokale.
- Ngritja e strukturave efektive në Bashki që trajtojnë rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut.
- Mungesa e ambjenteve të përshtatshme në bashki ose institucione të tjera vendore për trajtimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut; ngritja e qendrave speciale në territorin e bashkisë do të lehtësonte trajtimin e rasteve.
- Ekziston një numër i madh çështjesh me interes publik që përfaqësohen para gjykatave vendase, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Strasburgut, në lidhje me sa më poshtë vijon: shkeljet e të drejtave të njeriut për ujë, për sigurimin e kujdesit të duhur shëndetësor, për një mjedis i pastër dhe të shëndetshëm, jo-diskriminimi dhe barazia, e drejta e votës, e drejta për të mos iu nënshtruar torturave, trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese, e drejta e kompensimit në raste të fatkeqësive natyrore, e drejta për informim, konsultime publike, etj.
- Shkelje e parimit të transparencës dhe qeverisjes së hapur për shkak të nivelit të zbatimit të ligjit për njoftimin publik dhe konsultimin nga institucionet në nivel qendror dhe vendor, duke mos respektuar kërkesat për afatet dhe procedurat e konsultimit publik. Kjo do të thotë që institucionet publike kanë ende punë për të bërë për të zbatuar të gjitha kërkesat e ligjit.



### **Kutia 5: Praktika të mira në trajtimin e rasteve të shkeljes të të drejtave të njeriut nga grupet ndërinstitucionale**

**Bashkia e Tiranës** ka trajtuar 223 raste të fëmijëve në situatë rruge dhe zgjidhur strehimin e një rasti nga komuniteti LGBTI

**Bashkia e Shkodrës** ka trajtuar, në bashkëpunim me institucionet publike vendore dhe organizatat joqeveritare, 17 raste të shkeljes së të drejtave të njeriut.

**Bashkia Prrenjas** ka trajtuar 15 raste të shkeljes së të drejtave të njeriut të trajtuar nga grupet ndërinstitucionale

**Bashkia Patos** ka mbështetur 12 raste me seanca psikologjike, vlerësimin e rasteve, mbështetje ekonomike dhe materiale.


**Bashkia e Mirditës** ka trajtuar dy raste të grave të dhunuara në familje.

**Bashkia Berat** ka patur numrin më të madh ta rasteve të referuara. Referuar burimit të shërbimeve të kësaj bashkie, individët shfaqin pretendime përse i përket shkëljes të të drejtave të tyre por ato gjejnë argumentimin dhe resolution nga Bashkia.

**Bashkia Vlorë:** Nëpunësit e Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social bashkëpunojnë me Qendrën Psikosociale Vatra në rastet e shkeljes së të drejtave të femijeve dhe grave të dhunuara/ ose të trafikuar në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Policisë Vendore, apo grupet ndërinstitucionale të ngritura për rastet e parashikuara.

### **Rekomandime**

- Rritja e bashkëpunimit të bashkive dhe OShC-ve që kanë në fokus të drejtat e njeriut.
- Përmirësimi i punës së grupeve ndërinstitucionale që trajtojnë rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut.
- Rritja e bashkëpunimit midis institucioneve dhe OSHC-ve për të përfituar nga trajnimet që ofrohen dhe rritja e pjesëmarrjes së nëpunësve vendorë në trajnimet që ofrohen.
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet OSHC dhe pushtetit vendor për mbështetjen e rasteve që kanë nevojë për financimin e dokumentave noteriale për aplikimin në programet e kujdesit social.
- Rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë për reduktimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut.
- Shtimi i njohurive dhe rritja e vetëdijes për standardet e të drejtave të njeriut për zyrtarët vendorë përmes trajnimeve/seminareve të ndryshme.
- Ngritja e qendrave të banimit për raste urgjente dhe sigurimi i banesave sociale për individët në nevojë, duke siguruar të drejtën e strehimit për çdo person.
- Rritja e besimit të qytetarëve në sistemin e referimit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sepse megjithëse ekziston një sistem i mirë dhe funksional, shpesh janë vërejtur përgjigje formale dhe shmangie nga kompetencat institucionale.




## KONKLUZIONE MBI TË DREJTAT E NJERIUT

*Kanë vijuar përpjekjet për të rritur kapacitetet e qeverisjes vendore nëpërmjet trajnimeve dhe ngritjes dhe funksionimit të mekanizmave të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe vendore në nivel rajoni dhe bashkie për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Vetëm 42.6% e bashkive kanë marrë pjesë në programe trajnimi për standartet e të drejtave dhe praktikave të trajtimit të rasteve të shkeljes së tyre, ndërsa numri i nëpunësve të trajnuar është ulur krahasuar me 2018. Në nivel vendi, gjithsej 166 raste të referuara ose dy herë më pak se në vitin 2018. Përmirësimi i koordinimit dhe efikasitetit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm (grupet ndërinstitucionale) është i domosdoshëm për të trajtuar në kohë dhe sipas protokolleve rastet shkeljeve të të drejtave të njeriut.*

*Është raportuar bashkëpunim i mirë me Organizatat e Shoqërisë Civile për trajtimin e rasteve të dhunimit të të drejtave të njeriut nga 26 bashki në 2019 (ose 42.6% të bashkive). Treguesi evidenton rritje të rasteve të bashkëpunimit me OSHC me 11.6 p.p. krahasuar me 2018. Ndonëse të dhënat tregojnë rritje të bashkëpunimit me shoqërinë civile, shumë bashki nuk kanë patur bashkëpunim me organizata të specializuara në këtë fushë.*

*Krijimi i një mjedisi të sigurtë në bashki, përmirësimi i komunikimit nga nëpunësit vendorë dhe rritja e ndërgjegjesimit të qytetarëve për të dëshmuar rastet e dhunimit të të drejtave të njeriut mbetet një sfidë. Krijimi i infrastrukturës sociale (ambjenteve të posaçme) në NJQV për trajtimin e specializuar të rasteve në bashkëpunim efikas me të gjithë aktorët që operojnë në nivel bashkie është i nevojshëm dhe duhet të jetë në vëmendje të vendim-marrjes të bashkive.*





## II. KRITERI EKONOMIK

---

*Ekonomi tregu funksionale dhe aftësia për të trajtuar  
konkurrencën e BE-së dhe forcat e tregut*

## 2.1 Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

*Objektivi specifik: përmirësimi i mjedisit të biznesit*


“Shqipëria ka realizuar progress dhe është mesatarisht e përgatitur për zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Në 2019, ekonomia e vendit pati rritje dhe papunësia u ul ndonëse mbetet e lartë. Përpjekje janë kryer për të zhvilluar tregun financiar jo-bankar. Klima e biznesit është përmirësuar në disa aspekte dhe formalizimi i punës u rrit, ndonëse informaliteti ende mbetet i lartë. Me qëllim përmirësimit e funksionimit të ekonomisë së tregut funksionale, rekomandohet (i) konsolidimi fiskal i mëtjetshëm dhe zhvillimi i planit për të rritur të ardhurat dhe për të adresuar informalitetin, (ii) monitorimi dhe kontrolli i detyrimeve fiskale që lindin nga partneriteti Publik-Privat dhe borxhet, (iii) përmirësimi i aksesit për financim duke forcuar detyrimet kolaterale dhe rritjen e përfshirjes financiare, (iv) përmirësimi i relevancës së tregut të punës, cilësia dhe targetimi i politikave të tregut aktiv të punës përfshirë rritjen e aftësisë të forcës së punës”<sup>44</sup>.

Progresi mbi objektivin specifik vlerësohet nga pesë (5) tregues përformance: 42 bashki kanë miratuar planin e zhvillimit strategjik në Këshillin Bashkiak (ose 68.85% e bashkive); treguesi tregon rritje të lehtë me 1.85 p.p. krahasuar me vitin 2018.

Në vitin 2019, 33 bashki (54%) kanë realizuar aktivitete stimuluese për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla në disa fusha në zbatim të planeve të zhvillimit vendor; gjithsej janë ndërmarrë 110 aktivitete stimuluese (mesatarisht 2.08 për bashki). Bashkitë kanë bashkëpunuar me disa projekte me financim të huaj duke financuar deri në nivelin 20% për disa iniciativa të punësimit të të rinjve<sup>45</sup>, si psh. në kultivimin e artit-kulinar tradicional tek të rinjtë<sup>46</sup>, trajnimi i të rinjve për rritjen e bletëve dhe financimi i disa paisjeve<sup>47</sup>, në fushën e turizmit, iniciativa për të trajnuar të rinjtë në njohjen e vlerave historike dhe arkeologjike të zonës në kapacitetin e guidës turistike<sup>48</sup>, në fushën e mjedisit “Vjosa explorer”<sup>49</sup>, punësimi i të rinjve në prodhimin e sapunit organik<sup>50</sup>, të rinjtë për qytetin dhe grate në shërbimin publik<sup>51</sup>, prodhimi i handicraft<sup>52</sup>. Projekti EMBRACE<sup>53</sup> synon mbështetjen e start-up për të rinjtë dhe grupet e tjera të interesuara. Bashkia e Tiranës ka ofruar numrin më të madh të aktiviteteve stimuluese (10) duke ruajtur nivelin e 2018, Bashkia Fier dhe Prrenjas (7) nga 5 aktivitete të ofruara në 2018, Bashkia Gramsh (7) nga 8 aktivitete në 2018, dhe Bashkia Kamëz (7) nga zero aktivitete të raportuara në 2018.

Grafiku 31: Dokument strategjik zhvillimi në nivel vendor

■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna




Harta 10



- 44 Burimi: Raporti i Progresit i KE-së për Shqipërinë (2019)
- 45 Projekti ReLOaD i zbatuar në 12 bashki
- 46 Bashkia Korçë
- 47 Bashkia Librazhd
- 48 Bashkia Durrës
- 49 Bashkia Përmet
- 50 Bashkia Roskovec
- 51 Bashkia Tropojë
- 52 Bashkia “Korçë, Librazhd,
- 53 Një projekt i financuar nga BE (IPA II)


Grafiku 32: Aktivitete stimuluese në mbështetje të biznesit të vogël e të mesëm



Planet vendorë të zhvillimit janë një instrument i rëndësishëm për priorizimin e projekteve dhe alokimin e duhur të fondeve. Disa bashki përballen më vështirësi për mbështetjen e aktiviteteve stimuluese dhe zbatimin e projekteve strategjike për arsye të burimeve financiare të vogla<sup>54</sup> dhe të kapaciteteve të pamjaftueshme njerëzore dhe teknike<sup>55</sup>. Rreth 59% e bashkive raportojnë ofrimin e shërbimeve në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

- Nga bashkitë raportuese, gjithsej 110 rekomandime të bashkive janë dhënë në ndihmesë të bizneseve të vogla dhe të mesme (N=47); Bashkia Shkodër raporton numrin më të madh të rekomandimeve (40) krahasuar me 30 në 2018, Bashkia Dropull (15) nga 10 në 2018, Bashkia Gjirokastër zero, nga 10 të raportuara në 2018 dhe Bashkia Sarandë (1) duke mbetur në të njëjtin nivel me 2018.
- Në vitin 2019, është raportuar krijimi i 7402 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ose mesatarisht 134.5 (N=55), që rezulton më pak se në vitin 2018 (8245 ndërmarrje të reja).
- Bashkia e Tiranës raporton numrin më të madh të kompanive të vogla dhe të mesme të krijuara në 2019 (1888), ose 43 më pak krahasuar me 2018, pasuar nga Bashkia Durrës (1616), ose 315 më pak se në 2018, Bashkia Roskovec (482) ose 477 më shumë se 2018, pasuar nga Bashkia Krujë (411) ose 56 më pak se 2018.

Grafiku 33: Shërbime të organizuara në mbështetje të biznesit




Harta 11



54 Bashkia Shkodër

55 Bashkia Divjakë, Dropull, Mallakastër, Përmet

Grafiku 34: Numri i ndërmarrjeve të reja në 2019



### Kutia 6. Sfidat e bashkive në ofrimin e shërbimeve në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

**Bashkia e beratit:** Nevojitet forcimi i bashkëpunimit me biznesin për zgjerimin e aktiviteteve të tilla

**Bashkia Elbasan:** Zgjerimi i partneritetit dhe rritja e interesit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që të përfshihen në iniciativa të ndryshme lokale dhe kombëtare

**Bashkia e Fushë-Arrëz:** Të përfshihen në planin strategjik të bashkise shërbime që mbështesin zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

**Bashkia Kolonjë:** Stimulum sipas kërkesave dhe zhvillimi i panairëve të ndryshme mbi orientimin e këtyre ndërmarrjeve.

**Bashkia Konispol:** Rritja e mbështetjes ndaj qytetarëve dhe iniciativave në sipërmarrje.

**Bashkia Roskovec, Mallakastër:** Sfidë është nxitja e bizneseve të reja dhe ndihmesa me politikat fiskale për mbarëvajtjen e biznesit të tyre në rrugën e suksesit.

**Bashkia Sarandë:** Kërkohet më shumë bashkëpunim për të nxitur iniciativën private në ngritjen e ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Trajnimet në këtë fushë kanë munguar, përvoja është e kufizuar dhe kapacitetet administrative janë tepër të limituara.

**Bashkia Shkodër:** Mungesë informacioni mbi tregun e punës nga kërkuesit. Nga ana tjetër edhe ofruesit nuk janë të informuar për kualifikimin e punëkërkuesve. Instrumenta të pamjaftueshëm për promovimin e produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative.

**Bashkia Tiranë:** Njëpërmjet shërbimeve që ofrohen ndaj bizneseve, bashkia synon t'u vijë në ndihmë dhe të mbështesë zhvillimin dhe konsolidimin e biznesit të vogël dhe të mesëm në qytetin e Tiranës

**Bashkia Vau i Dejës:** Kryerja e shërbimeve më cilësore dhe shtrirja e tyre në të gjithë territorin e bashkisë, përfshirë Njësitë Administrative malore.




## Problemet dhe sfidat

- Burime të kufizuara financiare nga bashkitë për të mbështetur subjektet e reja të biznesit nëpërmjet skemave të granteve konkurruese që mund të nxisin ngritjen e subjekteve të reja të biznesit dhe ndërmarrjeve të inovacionit.
- Mbështetja e bashkisë për zhvillimin e NVM-ve duhet të përfshihet në buxhetin vendor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm.
- Ndryshimi i shpeshtë i tatim-taksave dhe rritja e ngarkesës fiskale.
- Përmirësimi i mjedisit të biznesit duke ofruar shërbime cilësore për t'i bërë qytetet dhe rajonet më tërheqëse për investimet vendase dhe të huaja dhe për të rritur konkurrencën shqiptare në rajon.
- Zbatimi korrekt i akteve nënligjore dhe rregullave nga administrata tatimore.

## Rekomandime

- Mbështetje bashkive për hartimin dhe zbatimin e Planeve të Përgjithshme Vendore dhe Planeve Sektoriale Vendore, në mënyrë që të mbështesin zhvillimin e ekonomisë vendore dhe bazën e saj të biznesit përmes programeve dhe shërbimeve që ndihmojnë komunitetin e biznesit të punojnë më mirë dhe lehtësojnë investimet në zonën vendore.
- Planet vendore duhet të shkojnë përtej planifikimit të territorit, por të integrojnë zhvillimin ekonomik me sektorë të tjerë, siç janë industria, ndërmarrjet, bujqësia dhe agro-përpunimi, turizmi, etj., brenda një territori.
- Të gjitha bashkitë duhet të hartojnë Planet e Zhvillimit të Turizmit me orientime dhe masa të qarta, të mbështetura nga veprime afatshkurtra dhe afatmesme, me qëllim trajtimin e sfidave të spikatura, si dhe të udhëzojnë dhe koordinojnë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit nisur nga këndvështrimi i planifikimit të përdorimit të tokës brenda një zone.
- Bashkitë duhet të gjejnë mekanizma vendorë për të forcuar lidhjen e sektorit të biznesit vendor me këshillin bashkiak për çështje biznesi, si dhe me aktorët e tjerë kryesorë.
- Bashkitë duhet të krijojnë një mjedis biznesi më mbështetës dhe konkurrues përmes udhëheqjes dhe hartimit të politikave dhe nismave pro-biznesit.
- Përmirësimi i shërbimeve vendore për komunitetin e biznesit duke lehtësuar procedurat administrative përmes sistemit të zyrës me një ndalesë.




## KONKLUZIONE MBI EKZISTENCËN E NJË EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE

**Mbështetja e NVM-ve nuk është e njëtrajtshme nga të gjitha bashkitë,** ndërsa raportohet nga disa bashki krijimi i ndërmarrjeve të reja, një numër jo i vogël i tyre mbyllet. Numri i ndërmarrjeve të reja në 2019 është më i vogël krahasuar me 2018 (-10.2 p.p). Ekzistojnë praktika të mira nga disa bashki, por në përgjithësi konstatohet se iniciativa dhe rekomandime nga shërbimet bashkiake në mbështetje të bizneseve janë përgjithësisht shumë të vogla. Ndonëse 42 bashki kanë miratuar planet e përgjithshme vendore, mungojnë masat e integruara në këto plane në mbështetje të ndërmarrjeve të reja dhe parashikimi i fondeve të nevojshme në planifikimin e buxhetit afat-mesëm. Në vitin 2019, 33 bashki (54%) kanë realizuar 110 aktivitete stimuluese për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

**Bashkitë kanë burime të kufizuara financiare për të mbështetur subjektet e reja të biznesit.** Sfidë mbetet ndihmesa e bizneseve me politika fiskale stimuluese për mbarëvajtjen e biznesit sipas potencialeve ekonomike që ofrojnë zonat por edhe të mbështetura nga institucione qendrore të specializuara dhe qendrat hub për start-up. Vetëm 12 bashki kanë bashkefinancuar iniciativat në hapjen e disa bizneseve në partneritet me projekte me financim të huaj. Biznesi social është ende një realitet i munguar.

**Përmirësimi i mjedisit të përgjithshëm të biznesit në nivel kombëtar,** politika të dhura fiskale dhe ngritja e mëtejshme e kapaciteteve të administratës tatimore në nivel qendror dhe vendor, si dhe lehtësimi i procedurave të ndryshme nga bizneset do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e bizneseve duke i bërë produktet shqiptare më tepër konkurruese në rajon.



### III.


## AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

*Aftësia për të marrë përsipër angazhimet e anëtarësimit, në veçanti, aftësinë për të zbatuar rregullat, standardet dhe politikat e acquis në mënyrë efektive, si dhe angazhimin për bashkimin politik, ekonomik dhe monetar.*


### 3.1 Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi dhe rural

Grafiku 35: Ngritja e Zyrave të Informacionit dhe Këshillimit Bujqësor në NJQV

Po Jo Nuk ka të dhëna



Harta 12




“Shqipëria ka një nivel përgatitje në bujqësi dhe zhvillimin rural. Për periudhën e raportimit, është bërë një progres i mirë në krijimin e strukturave për Instrumentin IPA për Zhvillimin Rural (IPARD II) dhe sistemin e këshillimit. Për periudhën 2019-2020, autoritetet shqiptare duhet të (i) Zhvillojnë Sistemin e Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS), që përfshin përmirësimin e fermave dhe regjistrin e kafshëve, miratimin e një plan zbatimi për rregjistrin e Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (Integrated Administration and Control System (IACS)), rritin kapacitetet e nevojshme administrative për zbatimin e masave të tjera lidhur programin IPARD II dhe përdorimin e plotë të fondeve të programit, (iii) plotësojnë kuadrin ligjor për produktet organike dhe mbrojtjen e origjinës, treguesit gjeografikë dhe veçoritë tradicionale të garantohen, vreshtat dhe verën, si dhe sigurimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative për zbatimin e tij<sup>56</sup>”.

Objektivi specifik (11.1): rritja e kapaciteteve të administratës vendore në sistemin e bujqësisë, zhvillimit rural dhe këshillimor

- Zyrat e Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor (ZIKB<sup>57</sup>), bazuar në të dhënat e ofruara, janë ngritur dhe bërë funksionale në 31 bashki (ose 50.8% të tyre)<sup>58</sup>
- Në vitin 2019, vlera mesatare e alokimit të fondeve, pjesë e buxhetit vendor, për bujqësinë dhe zhvillimin rural ka qenë 7.74%. Treguesi tregon zbritje me -1.26 p.p. në krahasim me vitin 2018<sup>59</sup>.

Harta 13: Alokimi i fondit për sektorin e bujqësisë



56 Burimi: Raporti i Progresit i KE-së për Shqipërinë (2019).


57 Ligji 9817 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, neni 30, pika a.

58 Shënim: Në vitin 2018 është raportuar që ZIKB funksionin në 34 bashki (56% të tyre); ka një pasaktësi në ofrimin e të dhënave; 1 bashki nuk ka raportuar.


59 Bashkia e Divjakës ka raportuar një nivel prej 80% të buxhetit vendor në 2019 të alokuar për bujqësinë dhe zhvillimin rural, Bashkia Lushnje 65% të buxhetit, Bashkia Dropull 45%.

- 32 Bashki (ose 52.45% e tyre) kanë ndjekur trajnime me tematika të ndryshme të lidhura me bujqësinë dhe zhvillimin rural; gjithsej 91 punonjës vendor të trajnuar, ose mesatarisht 1.6 trajnime.

Grafiku 36: Trajnime të punonjësve të Zyrave të Informacionit dhe Këshillimit Bujqësor, 2019




Grafiku 37: Trajnime të punonjësve të Zyrave të Informacionit dhe Këshillimit Bujqësor, 2017-2019



Objektivi specifik: përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë, përmirësimi i infrastrukturës rurale, zhvillimi i balancuar territorial dhe ekonomik i zonave rurale.


Treguesit e performancës në lidhje me këtë objektiv specifik përfshijnë: (i) përmirësimin e menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes, (ii) përmirësimin e menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit të kullimit (iii) grante të dhëna për fermerët.

Grafiku 38: Shkalla e mirëmbajtjes së rrejtit ujëtës, 2019




- Në vitin 2019, sistemi i ujitjes është mirëmbajtur nga 57 bashki në një nivel mesatar prej 35.77% të rrejtit. Treguesi rezultoi me zbritje me -2.23 p.p. në krahasim me 2018. Bashkitë Vorë, Kavajë dhe Malësi e Madhe kanë raportuar zero përqind mirëmbajtje dhe pastrim të sistemit ujtar ndërsa Bashkia Tiranë edhe këtë vit nuk ka ofruar asnjë të dhënë.
- Sistemi i kullimit, mesatarisht në nivel kombëtar, është mirëmbajtur në një nivel prej 38.42% të rrejtit. Edhe ky tregues vjen me zbritje, krahasuar me 2018 (- 5.58 p.p.). Bashkitë Tiranë, Skrapar, Malësi e Madhe, Tropojë, Dibër, Pukë dhe Has nuk kanë kryer mirëmbajtje të sistemeve të kullimit (raportuar zero vlerë për treguesin).


Grafiku 39: Shkalla e mirëmbajtjes së sistemit kullues, 2019



Grafiku 40: Shkalla mesatare e mirëmbajtjes së rrejtit të kullimit e administruar nga NJQV, 2017-2019



- 16 bashki raportojnë se kanë dhënë 1079 grante gjithsej nga buxheti vendor për përmirësimin e produktivitetit dhe cilësisë të produkteve të fermerëve të tyre, në mjete teknologjike dhe markimin e produkteve; bashkitë e tjera raportojnë mungesën e dhënies së granteve. Bashkia Dibër ka raportuar numrin më të madh të granteve (150), pasuar nga Bashkia Finiq (140), Bashkia Malësi e Madhe (130), Bashkia Krujë (129), ndërsa Bashkia Mirditë (3).




**Objektivi specifik: zbatimi i metodës LEADER**


Niveli i zbatimit të përçasjes LEADER<sup>60</sup> nga Bashkitë si një përçasje për zbatimin e strategjisë së integruar të zhvillimit rural, rezultojnë të vijoje i kufizuar edhe në vitin 2019. Vetëm 12 Bashki raportojnë krijimin e Grupit Vendor të Veprimit (GVV).

Ngritja e Grupeve Lokale të Veprimit të cilat shërbejnë si grupe burimore kombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile, politik-bërjen, planifikimin strategjik, advokimin etj do ketë një ndikim të rëndësishëm në planifikimet për fusha të ndryshme të zhvillimit të ekonomisë dhe në mënyrë direkte në hartimin e skemave të mbështetjes së bujqësisë, qofshin këto nga fondet e buxhetit të shtetit ashtu edhe nga fondet e BE-së.

Harta 14



Grafiku 41: Përfitues nga grantet për bujqësinë



60 Metoda LEADER lidhet me fuqizimin vendor nëpërmjet zhvillimit të strategjisë vendore në bujqësi dhe rritjes së mundësisë për përthithjen e fondeve. Instrument për zbatimin e metodës është krijimi i Grupit Vendor të Veprimit (GVV), i cili është me përfaqësi nga aktorë të ndryshëm: sektori publik, sektori privat (fermerë, etj) dhe shoqëria civile. Qëllimi është të mbështeten fermerët dhe aktorët tjerë të rëndësishëm nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të strategjisë së integruar të zhvillimit rural

Objektivi specifik: përshpejtimi i regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)


Regjistrimi i titujvë të pronës në bujqësi dhe marrja e Aktit (AMTP) është një prioritet i Planit të Veprimit të rishikuar të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore. Sipas të dhënave të raportuara nga bashkitë (N=58) rezulton se mesatarja e shkallës së rregjistrimit ka qenë 35.19%<sup>61</sup>.

Harta 15




Grafiku 42: Ngritja e Grupit Vendor të Veprimit

■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna




Grafiku 43: Tituj të pronësisë në bujqësi (AMTP) të rregjistruar



Në mënyrë të veçantë për këtë proces bashkitë raportojnë një sërë problematikash që lidhen me nevojën e përmirësimit të kapaciteteve njërëzore dhe teknologjisë për përpunimin e informacionit me qëllim që të mundësohet shkurtime të kohës në përpunimin e çertifikatave të pronësisë. Numri i lartë i personave në emigracion të cilët nuk kanë informacion dhe interes për të plotësuar dokumentacionin për kalimin e AMTP nga përdorim në pronësi. Numri i madh i dosjeve të bllokuara për shkak të mbivendosjes, si dhe konflikteve mes pronareve të cilat kthehen më pas pengesa në realizimin e procedurave. Niveli i ulët i regjistrimit të sipërfaqeve të tokës bujqësore, mungesa e koordinimit dhe mosfunksionimi si duhet nga ZVRPP, menaxhimi i zonave kadastrale si dhe përfundimi i regjistrimit fillestar të pasurive, janë disa probleme me të cilat ndeshen bashkitë.

61 Shënim: Të dhënat e raportuara nga bashkitë japin një nivel mesatar më të ulët se viti 2018 (-13.81 p.p.). Meqë ky tregues është kumulativ, gjykohet se treguesi nuk pasqyron shkallën faktike të rregjistrimit të AMTP. 12 bashki nuk kanë ofruar të dhëna.






## Problemet dhe sfidat

- Mungesë vëmendje nga vendim-marrësit e bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e zyrave të informimit dhe këshillimit në bujqësi (ZIKB) dhe aplikimin e përqasjes LEADER.
- Nevoja për rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të ZIKB aty ku janë ngritur. Punonjësit e drejtorive bujqësore në Bashki duhet të marrin pjesë më aktivisht në ndjekjen e programeve të trajnimit sipas tematikave që lidhen me bujqësinë dhe zhvillimin rural, por shpesh ndeshet pamundësia për të ndjekur shpesh programet e trajnimeve për shkak të mungesës së burimeve financiare për të marrë pjesë në trajnime.
- Progresi në rregjistrimin e AMTP është i ngadaltë dhe larg parashimit të SKNDQV.
- Infrastruktura e dobët rrugore në disa zona rurale dhe malore krijon vështirësi për transportin e produkteve bujqësore në tregjet e caktuara.
- Grante të pakta për fermerët nga buxhetet vendore. Financimi i tyre është kryesisht nga program IPARD II.
- Informimi në kohë i publikut dhe palëve të interesuara mbi skemat mbështetëse nga grantet për bujqësinë dhe zhvillimin rural, dhe asistimi në procedurat e aplikimit.
- Shkalla e mirëmbajtjes së sistemeve të ujitjes dhe kullimit mbetet problematike
- Mungesë e një institucioni në vend që të mundësojë kontrollin e cilësisë së pesticideve dhe farërave që importohen dhe përdoren nga fermerët

## Rekomandime

- Krijimi i një infrastrukture të përshtatshme për magazinimin e produkteve bujqësore që të sigurohet ruajtja e tyre konform standardeve.
- Forcimi i strukturave të sektorit të bujqësisë në bashki dhe organizimi i tyre me specialistë të arsimit përkatës të kësaj fushe.
- Rritja e aksesit në informacionin që bashkia duhet të sigurojë në lidhje me sektorin bujqësor duke përdorur mjete informacioni për të gjitha kategoritë e popullsisë së angazhuar në këtë sektor.
- Përdorimi i një sistemi informimi për informacionin bujqësor dhe zyrat këshilluese bujqësore për fermerët. Krijimi i një baze të dhënash për sektorin bujqësor jo vetëm që do të ndihmonte bashkitë për monitorimin e sektorit, por do të pasqyronte gjithashtu edhe më qartë situatën duke mundësuar parashikime dhe strategji të vlefshme për gjetjen dhe orientimin e tregjeve në favor të fermerëve dhe grupeve të interesit.
- Bashkitë fqinje duhet të koordinohen në funksion të zbatimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës bujqësore duke siguruar koherencë dhe përparësi të ndërhyrjeve në infrastrukturë sipas ndikimeve që ata do të kenë në territorin e dy ose më shumë bashkive.
- Rritja e kapaciteteve në lidhje me administrimin e skemave financiare të granteve përmes kryerjes së trajnimeve/seminareve për specialistët e sektorit të bujqësisë në bashki.
- Bashkitë duhet të informojnë rregullisht të gjithë fermerët dhe grupet e interesit për skemat e financimit të granteve, duke siguruar akses të barabartë për të gjithë palët e interesuara, së bashku me koordinimin me qeverinë qendrore në mënyrë që atyre t'u ofrohet ndihmë dhe mbështetje për të aplikuar me sukses në skemat e granteve.
- Hartimi i kritereve për decentralizimin asimetrik të çështjeve të ndryshme në interes të qeverisë qendrore në lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin rural në mënyrë që ky funksion të realizohet më mirë.
- Mundësimi i eksperimentimit shkencor për krijimin e farërave të reja që tu përshtaten më mirë tokave bujqësore në vendin tonë do të ishte pozitiv për sektorin.



## KONKLUZIONE MBI BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

**Është bërë një progres i lehtë drejt rritjes së kapaciteteve të pushtetit vendor në lidhje me sistemin e informacionit dhe këshillimin në bujqësi, si dhe në lidhje me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit.** Zyrat e Informacionit dhe Këshillimit Bujqësor (ZIKB) janë funksionale në 31 bashki (ose 50.8% të tyre)<sup>62</sup>. Në nivel vendi, mesatarisht fondi i bashkisë për sektorin bujqësor dhe zhvillimin rural është rreth 7.74%. Në vitin 2019, janë trajnuar 91 punonjës të sektorit nga 32 Bashki; rreth 50% e bashkive nuk kanë marre pjesë në programe që mundësojnë zhvillimin e kapaciteteve të punonjësve vendorë për përmirësimin e efektivitetit të zbatimit të masave vendore në harmonizim me prioritetet kombëtare, rritjen e standarteve, prodhimin e produkteve bio, dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore në tregjet e rajonit.

Mirëmbajtja e **infrastruktura ujitëse dhe kullimit** është në nivel të krahasueshëm me vitin 2018. Shkalla mesatare e mirëmbajtjes së sistemeve të ujitjes dhe kullimit nga bashkitë është më pak se 50%. Ndërkohë që në disa bashki infrastruktura e kullimit dhe ujitjes mbetet e amortizuar dhe nevojitet shtimi i investimeve për përmirësimet në infrastrukturë.

**Grantet nga fondet e bashkive për fermerët janë të pakta. Vetëm 16 bashki (ose 26.2% e tyre) kanë raportuar dhënie të rreth 1079 granteve për fermerët, ose mesatarisht 67 grante (N=16).**

**Rregjistrimi i titujve të pronës në bujqësi dhe marrja e Aktit (AMTP) mbeten ende në nivele të ulta dhe nuk paraqet progres.** Për më tepër bashkitë paraqiten me mangësi dhe mungesë saktësie në mbajtjen dhe raportimin e të dhënave.

### 3.2 Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare

Në zbatim të legjislacionit të sektorit<sup>63</sup> dhe Ligjit 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore”, strukturat veterinarë të NJQV bashkëpunojnë me strukturat e shërbimit veterinar rajonal dhe të drejtorive rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në qarqe për zbatimin e masave profilaktike, për kufizimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, si dhe për shkëmbimin e menjëhershëm të informacionit. Në vitin 2019, si rezultat i bashkëpunimit ndër-institucional, ndërmjet shërbimit veterinar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, AKU dhe Shërbimit veterinar të NJQV është përmirësuar kontrolli në thertore të therjes së kafshëve me matrikuj dhe të shoqëruara me çertifikatën veterinarë që sjell një impakt pozitiv në gjurmimin e zinxhirit ushqimor dhe sigurinë ushqimore tek konsumatori. Ligji i amenduar i Shërbimit Veterinar ka përcaktuar fusha, detyra dhe hapësira të reja të bashkëpunimit midis Shërbimit veterinar shtetëror dhe Njësive të qeverisjes vendore.

Në zbatim të Planit Kombëtar të Integritit<sup>64</sup>, është punuar për përafrimin e legjislacioni veterinar në RSH me legjislacionin e vendeve të BE<sup>65</sup>. Inspektoriatet e kontrollit në nivel rajoni kanë hartuar programet e kontrollit mbi sëmundjet kryesore zoonotike dhe infektive me përhapje të shpejtë dhe rezikshmëri të lartë në gjedh dhe bagetite të imta<sup>66</sup>.

62 Shënim: Në vitin 2018 është raportuar se ZIKB funksionin në 34 bashki (56% të tyre); ka një pasaktësi në ofrimin e të dhënave; 1 bashki nuk ka raportuar.

63 Ligji 10465/2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

64 MBZHR / Drejtoria e Rregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Bujqësisë

65 Urdher Ministri, nr.559, dt. 10.10.2019, “Për përcaktimin e kritereve për planet kombëtare për të përshpejtuar çrrënjosjen e brucelozës, tuberkulozitet dhe leukozës në gjedhë”. Urdher Ministri nr. 685, dt. 19.19.2019, “Mbi kushtet e shëndetit të kafshëve për importet e zogjve të caktuar dhe kushtet e karantinës së tyre”.


66 Burim: Drejtoria e Rregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit / Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Objektivi specifik: përmirësimi i kushteve sanitare dhe veterinare me qëllim që të mbrohet shëndeti i konsumatorëve


Ky objektivi specifik vlerësohet me anë të katër treguesve të performancës<sup>67</sup>:

- 27 bashki (ose 44.26% e tyre) kanë ofruar të dhëna për këtë tregues, si rrjedhim nuk mund të përgjithësohet konkluzioni në nivel vendi. Analiza e të dhënave evidenton që 21.3% e bashkive raportuese për këtë tregues kanë një mbulim të plotë (100%) të tregjeve të kafshëve të gjalla me veterinerë sipas kërkesave ligjore, ndërsa niveli mesatar i mbulimit ka qenë 28.46%.
- Niveli mesatar i tregjeve të kafshëve të gjalla të liçensuara<sup>68</sup> kundrejt numrit total të tregjeve në territorin e bashkisë është raportuar 19.25% (N=54).
- Mesatarja e tregjeve publike të shitjes me pakicë konform standarteve të higjienës kundrejt numrit total të tregjeve në territorin e bashkisë ka qenë në nivelin 40.07% (N=57).
- 120 raste të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore dhe veterinare janë raportuar nga shërbimet bashkiake në vitin 2019, ose mesatarisht 2.2 raste (N=54).

Harta 16: Mbulim i tregjeve të kafshëve të gjalla me veterinerë



Grafiku 44: Numri i rasteve të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore të raportuara nga NJQV



67 Treguesi i pestë i raportuar për vitin 2018 mbi numrin e inspektorëve veterinarë në Bashki nuk është më relevant për shkak të amendimit të ligjit nr. 10465/2011, i ndryshuar


68 Treguesi i pestë i raportuar për vitin 2018 mbi numrin e inspektorëve veterinarë në Bashki nuk është më relevant për shkak të amendimit të ligjit nr. 10465/2011, i ndryshuar

## Problemet dhe sfidat

- Ka probleme të koordinimit dhe bashkëpunimit e partneritetit<sup>69</sup> për shkëmbimin e informacionit lidhur me (i) situatën epizotike në territorin e njësisë të qeverisjes vendore, (ii) në kontrollet zyrtare në tregjet e kafshëve të gjalla, (iii) në kontrollet zyrtare në thertore (iv) në kontrollin e tregëtimit të kafshëve të zbuturimit, (v) në kontrollin e kafshëve të shoqërimit dhe qenve të rrugëve.
- Probleme në gjetjen e mjediseve, si varreza për mbeturinat e thertoreve dhe groposjen e tyre.
- Probleme me kapacitetet e bashkive për çështje të veçanta dhe me rëndësi si dhe mbi përpunimin dhe shkëmbimin i informacioneve për sigurinë ushqimore dhe veterinare.
- Përmirësimi i cilësisë së takimeve të përbashkëta ndërmjet shërbimeve në nivel të NJQV dhe shërbimeve veterinare në nivel rajoni (struktura të administratës qendrore).
- Tregtimi vetëm në tregjet e kafshëve të gjalla dhe vetëm kafshë të matrikulluara dhe të shoqëruara me certifikatën veterinare të lëvizjes së kafshëve.
- Lëvizja e kafshëve të shoqërimit në ambientet publike, parqe e të tjera dhe të racave agresive me maska mbrojtëse nga pronarët e tyre.
- Ngritja e tregjeve sipas standarteve higjieno-sanitare por edhe ngritja e inspektoriateve lokale të kontrollit të produkteve dhe tregjeve për të eliminuar në maksimum rastet abuzive lidhur me sigurinë ushqimore.
- Nevoja për të intensifikuar aktivitetet lidhur me ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin sit e tregëtareve dhe të qytetareve lidhur me sigurinë ushqimore dhe veterinare

## Rekomandime

- Bashkitë duhet të ndërmarrin fushata për të rritur vetëdijësimin dhe për t'i orientuar konsumatorët drejt tregjeve të monitoruara dhe të licencuara.
- Identifikimi i tregjeve joformale, forcimi i kontrolleve nga strukturat bashkiake dhe koordinimi me strukturat shtetërore përkatëse siç është policia e shtetit për këto tregje informale me qëllim përmirësimin e kushteve të tregëtimit, promovimit të konkurrencës së ndershme dhe të kontributit në procesin e zhvillimit ekonomik vendor.
- Krijimi i sa më shumë mundësive për tregtarët që të rritet aksesin qytetarë-tregëtare në tregje. Krijimi i tregjeve të lëvizshme dhe të përkohshme ose ditore, ku tregtarët mund të shesin produktet e tyre sipas një kalendari të caktuar dhe zonave të veçanta. Kjo do të jetë një mundësi më e madhe për tregtarët në mënyrë që ata të shesin produktet e tyre dhe një mundësi që blerësit të kenë më shumë akses në tregje.
- Organizimi i trajnimeve/seminareve nga ekspertë të kësaj fushe me qëllim rritjen e njohurive të inspektorëve bashkiak për kontrollin e ushqimit.
- Hartimi i kriterëve për decentralizimin asimetrik të çështjeve të ndryshme në interes të qeverisë qendrore në lidhje me sigurinë ushqimore, politikat veterinare dhe fitosanitare në mënyrë që ky funksion të realizohet më mirë.



## KONKLUZIONE MBI POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARE DHE FITOSANITARE

**Progres është evidentuar lidhur me bashkëpunimin ndërinstytucional** ndërmjet shërbimit veterinar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, AKU dhe Shërbimit Veterinar të NJQV, përafrimin e legjislacionit me vendet e BE, si dhe riorganizimin e strukturave të inspektoriateve në nivel rajoni mbi kontrollin e ushtruar në thertore, gjurmimin e zinxhirit ushqimor dhe sigurinë ushqimore tek konsumatori. Mbulimi i tregjeve me veterinerë është i plotë nga 21.3% e bashkive raportuese; 120 raste të shkeljeve të sigurisë ushqimore janë raportuar në vitin 2019. Mesatarisht në nivel vendi, vetëm 40.07% e tregjeve të shitjes me pakicë plotësojnë standartet e higjienës.

### 3.3 Kapitulli 14: Politika e transportit

*BE ka rregulla të përbashkëta për standartet teknike dhe të sigurisë, standartet sociale, ndihmën shtetërore dhe liberalizimin e tregut në transportin rrugor, hekurudhat, rrugët ujore brenda territorit të shtetit, transportin e kombinuar, aviacionin dhe transportin detar.*


Referuar Raportit të Progresit të KE për Shqipërinë, 2019, vendi ka njëfarë niveli të përgatitjes në fushën e politikës së transportit, megjithëse vetëm një përparim i kufizuar u arrit për periudhën e raportimit. Rekomandimet e vitit 2018 janë adresuar pjesërisht. Përpjekjet duhet të fokusohen (i) në zbatimin e planit kombëtar të rishikuar të transportit (ANP3) dhe zhvillimin e një strategjie kombëtare për sistemet inteligjente të transportit, (ii) të miratojë legjislacionin për të zbatuar reformën e sektorit hekurudhor<sup>70</sup>. Kapacitetet administrative në të gjithë sektorin e transportit duhet të forcohen, veçanërisht në transportin hekurudhor. Financimi për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore është i pamjaftueshëm, duke rezultuar në përkeqësimin e vazhdueshëm të tij. Përpjekje më të mëdha janë të nevojshme për të harmonizuar legjislacionin e Shqipërisë për inspektimet e automjeteve tregtare, sistemet e menaxhimit të trafikut dhe sigurinë rrugore (përfshirë edukimin për sigurinë rrugore dhe zbatimin e sigurisë rrugore).

Progresi i bashkive në fushën e transportit është vlerësuar nëpërmjet 13 treguesve të performancës të asocuar me tre objektiva specifike:


*Objektivi specifik: rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor*

- *Rrjeti i rrugëve urbane që menaxhohet nga bashkitë (N=59) ka nivel variabël të përmbushjes të standardeve, që varion nga 100% deri në vlerat të ulta 0.5% ( Bashkia Lushnje).*

<sup>70</sup> Shqipëria nënshkroi Traktatin e Komunitetit të Transportit (Korrik 2017) në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Trieste dhe e ratifikoi atë në shkurt 2018.




Grafiku 45: Shkalla e konformitetit të rrjetit urban me standartet





Vlera mesatare e konformitetit të plotësimit të standarteve të rrjetit urban të bashkive është 53.2%; treguesi evidenton përmirësim të lehtë me 1.2 p.p. në krahasim me 2018.

Grafiku 46: Shkalla e konformitetit të rrjetit urban me standartet kombetare, 2017-2019




- Mesatarisht, 32.15% e rrjetit rural të bashkive përmbush standartet e rrugëve. Treguesi luhatet nga niveli 93% (Bashkia Fier), vijon me 80% (Bashkia Durrës) deri ne 3.2% (Bashkia Pogradec). Bashkitë Lushnjë, Kavajë, Kolonjë, Tiranë, Maliq, Sarandë, Pustec nuk kanë raportuar për këtë tregues.

Grafiku 47: Shkalla e përmbushjes se standarteve të sinjalistikës, 2017-2019




- Plotësimi i standarteve të sinjalistikës për rrjetin e rrugëve që administrohet nga bashkia mesatarisht është 36,13%; treguesi evidenton përmirësim të lehtë më 1.13p.p.
- Fondi vendor i bashkisë për mirëmbajtjen e rrugëve ka qenë i vogël, mesatarisht 8.54% e fondit të buxhetit vendor në 2019 është alokuar për mirëmbajtjen e rrugëve (N=59). Treguesi ka përkeqësim të lehtë me -0.06 p.p. krahasuar me 2018.

Harta 17: Shkalla e përbushjes së standarteve të sinjalistikës



Harta 18: Fondi për sigurinë rrugore në raport me buxhetin e sektorit të transportit, 2019



- Ndërtimi i infrastrukturës rrugore kërkon kryerjen e studimeve të fizibilitetit për opsione alternative dhe kosto të përballueshme përkundrejt plotësimit të disa standarteve minimale. Kjo kërkon kapacitete teknike dhe administrative nga bashkitë në përgatitjen e projekteve për tu financuar nga vetë bashkitë, si dhe Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Në 2019, mesatarisht u alokua 14.95% e buxheteve të bashkive (N=58) për ndërtimin e infrastrukturës rrugore. Të dhënat e raportuara tregojnë se bashkitë kanë parashikuar më shumë buxhet vendor për ndërtimin e rrugëve të bashkive në 2019 në krahasim me 2018 (+6.15 p.p.).

Në 2019, mesatarisht rreth 6.44% e fondit buxhetor vendor për sektorin e transportit është përdorur për sigurinë rrugore (N=55). Më pak fond nga buxheti vendor me -0.38 p.p. u përdor për sigurinë rrugore në krahasim me 2018.

*Objektivi specifik: përmirësimi i transportit publik*


Përafrimi i politikës të transportit mbi detyrimet e shërbimit publik dhe *acquis* për kontratat e shërbimit publik është një nga kërkesat për sektorin e transportit në kuadër të axhendës së integritimit evropian.

- Publikimi i planit të lëvizjeve të mjeteve të transportit publik në stacionet e autobusëve është realizuar nga 31.14% e bashkive. Të dhënat e raportuara tregojnë përkeqësim të shërbimit nga bashkitë me -2.86 p.p. në krahasim me 2018.
- Bashkitë kontraktajnë ofrues të jashtëm të shërbimit; kontratat mbulojnë edhe mirëmbajtjen e mjeteve të transportit. Vetëm 13 bashki kanë raportuar mbi fondin e alokuar nga buxheti vendor për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit publik, me nivel mesatar 5.21% të fondit për sektorin e transportit përdorur.

Harta 19




Grafiku 48: Publikimi i Planit të Transportit Publik




*Objektivi specifik: nxitja e ecjes në këmbë dhe e përdorimit të biçikletës*

- Në nivel vendi në 2019, mesatarisht vetëm 3.66% e rrjetit të rrugëve në zonat urbane ofron mundësinë e lëvizjes me biçikleta<sup>71</sup>.

Grafiku 49: Shkalla e rrjetit urban të dedikuar për lëvizjen me biçikleta, 2019




<sup>71</sup> Shënim: Meqënëse treguesi është kumulativ, gjykohet që ka gabim në raportimin e të dhënave. Treguesi për 2019 është -0.44 p.p, më i ulët se shifra e raportuar për këtë tregues në 2018.





- Rrugët në zonat urbane të bashkive janë të paisura me trotuarë, mesatarisht 56% e tyre. Treguesi është variabël në një fushë të gjerë nga 100% në 1.2%. Duhet përmendur se përqindja mesatare duhet të jetë me e lartë, pasi 5 bashki bashki nuk kanë ofruar të dhëna-Bashkia Prrenjas, Kukës, Ura Vajgurore, Pustec. Bashkia Tiranë ka raportuar në vitin 2017 se 70% e rrugeve në zonat urbane janë të pajisura me trotuarë, por në vitet 2018 dhe 2019 kjo bashki raporton se “nuk ka të dhëna” mbi këtë tregues.

Grafiku 50: Shkalla e rrjetit rrugor të zonave urbane të paisur me trotuarë



- Në vitin 2019 Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe 8 bashki u regjistruan zyrtarisht në Javën Evropiane të Lëvizshmërisë, me një sërë aktivitete të realizuara gjatë kësaj jave, sic edhe paraqitet më poshtë në të dhenat e marra nga nga vetë faqja e internetit e Komisionit Evropian<sup>72</sup>

Foto 1: Java Evropiane e Lëvizshmërisë 2019



72 <https://mobilityweek.eu/participants/?year=2019&country=AL>

## Problemet dhe sfidat

- Financimi i pamjaftueshëm për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore, dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore nga bashkitë, në sinjalistikë dhe rritjen e sigurisë rrugore.
- Mungesë transparence në publikimin e planit të lëvizjeve të mjeteve të transportit publik në stacionet e autobuzëve në territoret e bashkive.
- Kapacitetet teknike dhe administrative nga bashkitë në përgatitjen e projekteve të infrastrukturës rrugore për tu financuar nga vetë bashkia ose për të aplikuar në fondin e zhvillimit të rajoneve të limituara.
- Mungesa e sistemeve inteligjente SIT dhe kompjuterizimi i stacioneve.
- Mungesa e disa standardeve për përgatitjen e hartave të transportit urban në të njëjtin format në secilën bashki.

## Rekomandime

- Përcaktimi i akseve rrugore me përparësi sipas përfitimeve që u sjellin qytetarëve dhe ndërhyrja në rehabilitimin ose ndërtimin e këtyre segmenteve rrugorë.
- Bashkitë duhet të promovojnë konkurrencën midis operatorëve të transportit, duke promovuar kështu arritjen e standardeve më të larta të cilësisë së transportit publik.
- Zbatimi i ndëshkimeve të rrepta për shkeljet administrative që mund të kryhen nga operatorët e linjave të transportit.
- Inkurajimi i bashkive që të publikojnë oraret e autobusëve në çdo stacion autobusi dhe hartën e transportit në mënyrë që të rrisin informimin e qytetarëve dhe të ndikojnë në cilësinë e shoqërive private të transportit urban.
- Ndërtimi i stacioneve multimodale siç parashikohet në Planet e Përgjithshme Vendore të aprovuara nga secila bashki.
- Hartimi i kriterëve të decentralizimit asimetric të politikave të transportit në interes të qeverisë qendrore për ta realizuar më mirë këtë funksion.
- Rritja e transparencës në publikimin e planit të lëvizjeve të mjeteve të transportit publik në stacionet e autobuzëve në territoret e bashkive.
- Vendosja e sistemeve inteligjente SIT dhe kompjuterizimi i stacioneve.
- Rritja e km rrugë korsi për biçikleta në të gjitha bashkitë dhe promovimi më i madh për lëvizjen në këmbë dhe me biçikleta.
- Edukimi qytetar për lëvizjet rrugë për efekt të sigurisë rrugore.

## KONKLUZIONE MBI POLITIKËN E TRANSPORTIT

**Rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor po tregon progress të lehtë por numri i aksidenteve mbetet i lartë** në krahasim me vendet e BE dhe të rajonit. Në 2019, aksidentet rrugore janë ulur me 13.8%, krahasuar me vitin 2018, ndërsa aksidentet rrugore me pasojë vdekjen u rritën me 6.84% në vitin 2019, krahasuar me 2018. Kapacitetet administrative dhe burimet financiare në sektorin e transportit nuk janë të forta. Financimi për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore është i pamjaftueshëm. Fondi mesatar për mirëmbajtjen e rrugëve nga bashkitë ka qene mesatarisht 8.54%, ndërsa për ndërtimin e rrugëve ka qenë 6.15 p.p. më i lartë në 2019, krahasuar me 2018. Për sigurinë rrugore janë përdorur më pak fonde nga bashkitë në 2019 krahasuar me 2018 (-0.38 p.p.). Promovimi i lëvizjeve me këmbë dhe biçikleta nga shërbimet e bashkive ka pësuar ulje në 2019. Korsitë e biçikletave ekzistojnë vetëm në disa zona urbane të bashkive. Edukimi qytetar për sigurinë rrugore dhe zbatimi e sigurisë rrugore mbetet një sfidë.

**Përmirësimi i transportit publik dhe ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të rehatshme për qytetarët mbetet një synim.** Publikimi i planit të lëvizjeve të mjeteve të transportit publik në stacionet e autobusëve është realizuar nga 31.14% e bashkive që evidenton përkeqësim të shërbimit nga bashkitë me -2.86 p.p., krahasuar me 2018. Mirëmbajtja e mjeteve të transportit kryesisht mbulohet nga ofruesit e shërbimeve të kontraktuar nga bashkitë.

### 3.4 Kapitulli 15: Energjia

*Politika energjetike e BE-së përfshin furnizimin me energji, infrastrukturën, tregun e brendshëm të energjisë, konsumatorët, energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë, energjinë dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi.*

“Shqipëria është përgatitur mesatarisht në këtë fushë. Ka pasur përparim në sektorin e gazit dhe në linjat e interkonjeksionit. Është miratuar Strategjia e re kombëtare e energjisë 2018-2030. Sidoqoftë, vendi ka vonuar reformat e tregut të energjisë elektrike dhe duhet të përshpejtojë zbatimin e masave të reformës së lidhjes (connectivity reform), duke hequr pengesat ligjore dhe kontraktuale për integrimin e tregjeve të energjisë. Detyrat që shtrohen përfshijnë:



- (i) diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe promovimin e burimeve alternative të energjisë së rinovueshme duke siguruar përputhshmëri me standardet mjedisore; krijimin e një tregu të organizuar të energjisë elektrike.
- (ii) Të përfundojë ndarjen e kompanive të energjisë dhe të elimojë pengesat ligjore për të drejtën e klientëve për të ndryshuar furnizuesin e tyre me energji elektrike.
- (iii) të harmonizojë ligjin e Eficiencës së Energjisë me *Acquis*, të krijojë një fond të efikasitetit të energjisë dhe të hartojë dhe të miratojë legjislacionin dytësor për zbatimin e Direktivës së Performancës së Energjisë së Ndërtesave”<sup>73</sup>.

Progresi i bashkive në fushën e energjisë është vlerësuar nëpërmjet 6 treguesve të performancës të asocuar më dy objektiva specifike:

**Objektivi specifik: Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë.**

- Caktimi i menaxherit për eficiencën e energjisë që është kërkesë e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Eficiencën e Energjisë, 2019-2030, ka gjetur zbatim të vogël nga NJQV. Vetëm 14.47% e bashkive kanë caktuar menaxherin për eficiencën e energjisë<sup>74</sup>. Treguesi mund të jetë më i lartë por shtatë bashki nuk kanë ofruar të dhëna për këtë tregues.


Grafiku 51: Menaxheri për eficiencën e energjisë në NJQV



<sup>73</sup> Raporti i Progresit i KE për Shqipërinë (2019)


<sup>74</sup> Shënim: Ka mospërputhje të të dhënave për këtë tregues sepse në v.2018 është raportuar që 24% e bashkive kishin caktuar menaxherin për eficiencën e energjisë

Grafiku 52: Menaxheri per eficiencen e energjise ne administraten vendore, 2017-2019



- Trajnimi i personave të caktuar në kapacitetin e menaxherit për eficiency e energjisë në vitin 2019 është organizuar në nivelin 62% (ose 8 persona të trajnuar nga 13 menaxherë të caktuar).
- Mungesa nga NJQV, për caktimin e menaxherit për eficiency e energjisë në zbatim të politikës së Qeverisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, sjell vonesa në realizimin e masave të tjera nga bashkitë. Hartimi i Planit të Veprimit (PV) për eficiency e energjisë në nivel vendor është kryer nga 22.95% e bashkive në 2019.
- Një numër i vogël i bashkive, 12 bashki gjithsej kanë raportuar organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit për eficiency e energjisë në bashkëpunim edhe me aktorë të tjerë; gjithsej 40 fushata janë organizuar në 2019.


Grafiku 53: Fushata këshillimi nga NJQV për ndërmarrjet e biznesit mbi eficiency e energjisë



Objektivi specifik: Rritja e efijencës së përdorimit të energjisë: përmirësimi i zbatimit të kërkesave minimale për ndërtesat dhe shërbimet publike.

- Programe trajnimi për efijencën në përdorimin e energjisë dhe përmirësimin e zbatimit të kërkesave minimale në ndërtesat publike, në ndërtesat e banimit si dhe në ndërtesa të tjera janë ndjekur nga një numër i vogël i bashkive – gjithsej 10 bashki kanë marrë pjesë në 26 programe trajnimi në vitin 2019.
- Mungesa e caktimit të menaxherit për efijencën e energjisë nga Bashkitë sjell impakt negativ në kontrollet mbi standartet dhe kërkesat minimale për efijencën e energjisë që administrata vendore duhet të kryejë gjatë ndërtimit ose rindërtimit të godinave me natyrë shërbimi ose ndërtesa banimi. Në vitin 2019, janë raportuar 220 kontrolle nga 11 bashki<sup>75</sup> (më shumë kontrolle të kryera në 2019 krahasuar me 2018 (57 kontrolle më shumë).


Grafiku 54: Plani Veprimit për efijencën e energjisë në nivel vendor



Harta 21



Grafiku 45: Trajnime mbi PKVEE



75 Bashkia Elbasan, Kolonjë, Gjirokastrë, Patos, Berat, Tropojë, Kavajë, Gramsh, Shkodër, Përmet.

## Problemet dhe sfidat

- Vëmendje e ulët nga drejtues të bashkive për zbatimin e masave në nivel vendor të Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë lidhur me (i) caktimin e menaxherit për eficiencën e energjisë dhe (ii) hartimin e planit të veprimit për bashkinë për Eficiencën e Energjisë.
- Mungesa e akteve nën-ligjore për zbatimin e Ligjit për Eficiencën e Energjisë<sup>76</sup> krijon barriera për zbatimin efektiv të ligjit nga të gjitha institucionet qendrore dhe vendore.
- Mos zbatimi në kohë i Strategjise së Eficiencës së Energjisë, mos ngritja ende e Agjencisë së Eficiencës së Energjisë dhe mungesa e bërjes efektive të Fondit të Eficiencës së Energjisë.
- Mungesa e kapaciteteve financiare për të plotësuar gjithë masat që kërkojnë investime në këtë fushë. Kapacitete të kufizuara teknike dhe administrative të bashkive për të hartuar planin vendor për Eficiencën e Energjisë në bashkëpunim dhe koordinim me institucione qendrore të specializuara.
- Mungesa e strukturave të dedikuara dhe ndarja e qartë e kompetencave dhe menaxhimit e informacionit brenda vet bashkive<sup>77</sup>.

## Rekomandime

- Trajnimi i dedikuar për drejtuesit e bashkive që të ndërgjegjësohen për domosdoshmerinë e marrjes së masave të eficeses së energjisë në godinat publike lokale.
- Bashkitë duhet të ndërmarrin fushata informuese për qytetarët në lidhje me efikasitetin e energjisë duke rritur vetëdijesimin dhe duke inkurajuar miratimin e modeleve më efektive të konsumit të energjisë.
- Bashkëpunimi midis nivelit qendror dhe atij lokal me qëllim zbatimin e politikave fiskale për subjektet private që marrin përsipër kostot e tyre të ndërhyrjes për të rritur efikasitetin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative të energjisë.
- Hartimi i kriterëve të decentralizimit asimetrik të çështjeve të ndryshme që lidhen me energjinë në interes të qeverisë qendrore.

## PËRFUNDIME MBI ENERGJINË

**Ende nuk ka progres nga NJQV në zbatim të kërkesave të Planit të Veprimit të SKEE<sup>78</sup> për caktimin e menaxherit për eficiencën e energjisë dhe hartimin e planeve të veprimit në nivel vendor; 14 plane vendore për eficiencën e energjisë janë hartuar. Trajnimet për menaxherët vendorë për eficiencën e energjisë kanë qenë të pakta, gjithsej 8 menaxherë të trajnuar (ose 61% të menaxherëve) në 2019; ndërsa trajnime për zbatimin e standarteve minimale në ndërtesat janë kryer 26 gjithsej, me pjesëmarrjen e nëpunësve nga 10 bashki.**

76 Ligji Nr. 124/2015 "Për eficiencën e Energjisë", ndryshuar me Ligjin nr. 5/2019.

77 Bashkia e Tiranës

78 Strategjia Kombëtare për Eficiencën e Energjisë, 2019 – 2030 dhe Planit Veprimit

*Ndërgjegjesimi i qytetarëve për eficiencën e energjisë nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit nga bashkitë, në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe aktorë të tjerë, ka qenë jo i njëtrajshëm në të gjitha bashkitë - 12 bashki kanë raportuar organizimin e 40 fushatave; në nivel kombëtar, vlera mesatare e treguesit është 0.65 (me pak se 1 fushatë e kryer mesatarisht në 2018). Pra, më pak ndërgjegjesim të qytetarëve nga ana e administratës vendore. Më shumë kontrolle në ndërtimin e godinave dhe zbatimin e standarteve minimale të kryera në 2019 krahasuar me vitin 2018, gjithsej 220 kontrolle.*

### 3.5 Kapitulli 16: Taksat

*Rregullat e BE-së mbi taksimin mbulojnë taksën mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e akcizës, si dhe aspektet e taksimit të korporatave, si dhe me bashkëpunim midis administratave tatimore, përfshirë shkëmbimin e informacionit për të parandaluar evazionin fiskal.*

“Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e taksave. Një përparim është arritur përmes forcimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave (DPT) dhe krijimit të kadastrës fiskale për ndërtesat. Disa nga kërkesat lidhen me thjeshtimin e sistemit të taksave, anëtarësimin në Kornizën Gjithëpërfshirëse të OECD BEPS (erozioni i bazës dhe zhvendosja e fitimeve ‘base erosion and profit shifting’, eliminimin e vonesave për rimbursimin e TVSH dhe shmangien e prapambetjeve të mëdha”<sup>79</sup>.

Në vitin 2019, u përgatit për herë të parë Raporti i Monitorimit të Performancës së Bashkive për vitin 2018, si një instrument që shënon fillimin e dialogut ndërmjet të gjithë aktorëve, ministrive të linjës, bashkive dhe qytetarëve, me qëllim vënien e theksit tek termi “performanca e buxhetit”. Bashkitë raportojnë mbi përdorimin e fondeve publike sipas disa formateve të reja të menaxhimit financiar. Puna e NJQV në mbledhjen e të ardhurave, ka bërë që pesha e buxhetit vendor të rritet nga 2.5% e PBB-së në vitin 2013 në mbi 4% të PBB-së në 2020<sup>80</sup>.

Programi i të ardhurave për NJQV në 2019-ën u bazua në katër shtylla: (i) përmirësimin e administrimit fiskal; (ii) minimizimin e informalitetit në ekonomi; (iii) rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe (iv) nxitjen e prodhimit vendas dhe eksporteve. Kuadri ligjor për taksat vendore përbehet nga disa ligje, si: ligji nr.9632/20016, “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, VKM 132/2018 “Për taksat e ndërtesave”, Ligji 9789/2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, VKM 783/2011 “Për procedurat e ndarjes se të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me NJQV, për procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël, dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të trajtimit ligjor të Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë<sup>81</sup>.


*Objektivi Specifik: Përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në drejtim të rritjes së bazës së tatueshme.*

- Miratimi i politikave tatimore, në 2019, është kryer nga 80.33% e bashkive; indikatorit tregon përmirësim me +1.65 p.p., krahasuar me 2018.

79 Raporti i Progresit të KE, 2019, chapter 16

80 Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

81 Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; - Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”; - Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; - Ligji nr. 9723/2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015, “ Kodi i procedurave administrative”, i ndryshuar; Ligji nr. 10279/2010, “Për kundërvajtjen administrative”, i ndryshuar.




- Është rritur kontrolli i shërbimeve tatimore në 2019 – gjithsej janë raportuar 48,068 inspektime (N=54), ose mesatarisht 890 inspektime (ose 32 inspektime me shumë mesatarisht për cdo bashki).
- Bashkitë kanë organizuar gjithsej 258 dëgjesa publike me bizneset ose mesatarisht 4.37 dëgjesa, që është në nivel të njëjtë me vitin 2018, por më i lartë krahasuar me vitin 2017.
- Në vitin 2019, 82% e bashkive kanë përditësuar databazën për debitorët e tyre; treguesi shënon zbritje me -4.9 p.p., kundrejt vlerës së raportuar në 2018.
- Të ardhurat e bashkive nga taksat vendore u rritën mesatarisht 25,4% (N=59) në krahasim me vitin 2018; sipas të dhënave të raportuara, treguesi është ulur me -2.6 p.p. për periudhën e mëparshme të raportimit (2018/2017).<sup>82</sup>.


Grafiku 56: Politika Tatimore të hartuara në nivel vendor

Grafiku 57: Bazë të dhënash mbi debitorët e NJQV

■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna




Harta 22



Harta 23



82 Bashkia Malësi e Madhe dhe Devoll nuk kanë ofruar të dhëna për këtë tregues.





## Problemet dhe sfidat


- Ulja e informalitetit dhe administrimi më i mirë i të ardhurave.
- Qëndrueshmëria e sistemit të taksimit.
- Rritja e të ardhurave vendore të ndikojë në rritjen e investimeve nga NJQV për projekte në nxitje të zhvillimit ekonomik dhe social të shtresave në nevojë.
- Rritje të kapacitete profesionale dhe administrative të zyravë tatimore.
- Rritja e aftësisë inspektuese për të mbuluar territorin e zgjeruar të bashkive mbas Reformes Administrative dhe Territoriale.

## Rekomandime

- Identifikimi i dobësive të sistemit tatimor dhe identifikimi i mundësive për përmirësim.
- Forcimi, përmirësimi dhe qartësimi i administrimit dhe i politikave vendore për të ardhurat tatimore.
- Rritja e autonomisë fiskale të qeverisjes vendore, që do të thotë më shumë autonomi për njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhur me mbledhjen e të ardhurave nga burimet e tyre. Aftësia e njësisë të vetëqeverisjes vendore për të mbledhur të ardhura nga burimet e veta vendore përmes taksave siguron llogaridhënie të shtuar ndaj qytetarëve.
- Rritja e të ardhurave të NJQV-ve duhet të përqendrohet në katër taksë të fuqishme dhe efikase me bazë të gjerë:
  - Të ardhurat personale, të vlerësuara mbi një bazë më gjithëpërfshirëse;
  - Të ardhurat nga biznesi, të planifikuara për të mbështetur rritjen ekonomike;
  - Qiratë e burimeve natyrore dhe të tokës; dhe
  - Konsumi privat.
- Pushteti vendor duhet të jetë më transparent për të treguar nëse taksat vendore po përdoren apo jo për të financuar shpenzimet që i përgjigjen nevojave dhe preferencave të qytetarëve.
- Rishikimi dhe ri-përcaktimi i kuadrit ligjor për taksat dhe tarifatat vendore, veçanërisht për taksën e pasurisë, taksën e tokës urbane, taksën e bazuar në vlerën e ndërtesave, etj.
- Rritja graduale e përqindjes së PBB-së për transfertën e pakushtëzuar që i shpërndahet NJQV-të nga pushteti qendror si nevojë për të rritur financimin e pushtetit vendor.
- Qeveria duhet të krijojë mjete më transparente për të trajtuar idetë e komunitetit në lidhje me sistemin e taksave duke shtrirë faqet e internetit dhe duke zhvilluar më tej përdorimin e tij.

## PËRFUNDIME PËR TAKSAT

**Sistemi i administrimit të taksave vendore ka përmirësim bazuar në treguesit e performancës.** Rreth 80.33% e bashkive kanë hartuar politika tatimore ( treguesi evidenton përmirësim me +1.65 p.p., krahasuar me 2018). Dëgjuesat publike më komunitetin e biznesit dhe shoqatat e bizneseve, administrimi databazave të debitorëve të NJQV, dhe inspektimet e kryera nga shërbimet tatimore kanë qenë në nivel të njëjtë me vitin 2018.



Shërbimi elektronik, nëpërmjet portalit e-Albania ka lehtësuar procedurat dhe u mundëson bizneseve që të informohen për taksat dhe tarifatat e papaguara vendore, mundësim për t'i paguar online.

NJQV kanë performuar më mirë në mbledhjen e të ardhurave; kjo ka bërë që pesha e buxhetit vendor të rritet në mbi 4% të PBB-së në 2020.

Departamentet e taksave nuk kanë kapacitetin e duhur teknik për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit, dhe infrastrukturën e duhur për të aplikuar standartet e El për teknologjinë e informacionit (TI).

### 3.6 Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi

Rregullat e BE-së në fushën sociale përfshijnë standarde minimale për ligjin e punës, barazinë, shëndetin, sigurinë në punë dhe mosdiskriminimin. Ato gjithashtu promovojnë dialogun shoqëror në nivelin evropian. Miratimi i legjislacionit sekondar dhe ristrukturimi i shërbimeve të punësimit dhe edukimit të formimit profesional, intensifikimi i përpjekjeve për të zbatuar strategjinë e mbrojtjes sociale 2019-2023, me një fokus të veçantë në grupet vulnerabël, forcimi i kapacitetit dhe burimeve të qeverisjes vendore për të vlerësuar nevojat e kujdesit social në territorin e tyre janë disa nga kërkesat e lidhura me politikat sociale të BE<sup>83</sup>.

Në Këshillin Konsultativ (KK) për vetëqeverisjen vendore janë diskutuar gjatë 2019 projekt-udhëzimi "Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, udhëzimi " Për ndërthurjen e programeve sociale të strehimit dhe shërbimeve sociale të punësimit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor", draft Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2019-2022 dhe Programi Kombëtar për Daljen nga Skema e Përfituesve nga Ndhima Ekonomike.

Progresi në zbatimin e politikave në fushën sociale dhe punësimin në nivel vendor lidhet me tre objektiva specifike dhe vlerësimin e 23 treguesve të performancës.

#### Objektivi specifik: mbrojtja sociale në nivel vendor


Strategjia e Mbrojtjes Sociale, 2019-2022, adreson objektiva të matshme për mbrojtjen sociale në Shqipëri dhe ndërthur politika dhe programe për të reduktuar varfërinë duke zvogëluar ekspozimin e familjeve dhe njerëzve ndaj rreziqeve dhe duke rritur kapacitetin e tyre për të mbrojtur veten nga rreziqet dhe mungesën e të ardhurave.

- Lidhur me burimet shtesë njerëzore në sektorin e përfshirjes sociale në bashki, janë raportuar 127 nëpunës vendorë, ose mesatarisht 2.19 nëpunës (N=58). Ky tregues është në të njëjtin nivel me vitin 2018, dhe pak më i ulët, krahasuar me 2017. Kapacitetet njerëzore në bashki janë rritur me nëpunës shtesë për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e ndihmës ekonomike (NE) me rreth 131<sup>84</sup>, ose mesatarisht 2.18 për bashki (N=60). Shtesat në staff kanë ndodhur në 25 bashki.

83 Raporti i Progresit të KE (2019)


84 Shënim: të dhënat e ofruara nga bashkitë mund të kenë pasaktësi, sepse numri i nëpunësve shtesë për sektorin social është më i madh ose i barabartë me numrin e nëpunësve përgjegjës për administrimin e monitorimin e NE.

Grafiku 58: Nëpunës vendor të trajnuar për masat për mbrojtjen sociale



- Zhvillimi i aftësive profesionale të stafit për sektorin e përkrahjes dhe mbrojtjes sociale ka vijuar nëpërmjet trajnimeve në 2019 – gjithsej 211 nëpunës vendore të trajnuar në lidhje me politikat kombëtare, masat për mbrojtjen sociale dhe statistikat sociale sipas standardeve të BE. Elbasani ka raportuar numrin më të madh të personave të trajnuar gjatë vitit 2019.

Grafiku 59: Nëpunës vendor të trajnuar mbi masat për mbrojtjen sociale, 2017-2019





- Rreth 44.26% e bashkive kanë hartuar Raportin e Vlerësimit për mbrojtjen sociale në vitin 2019<sup>85</sup>. Të dhënat e treguesit tregojnë zvogëlim në krahasim me 2018 (55.7%) dhe 2017 (49.1%).
- Sektori i vlerësimit të nevojave dhe referimit është funksional në 39,34% të bashkive, në nivel të njëjtë më 2018, por i përmirësuar në krahasim me 2017 (32.7%).
- Bashkitë alokojnë nga buxheti i tyre vendor në nivelin e 6% të fondit të NE i cili përdoret për të mbështetur individë ose familje që janë në nevojë por që kanë dalë jashtë skemës së NE për arsye të ndryshme (psh. mosplotësimi i kriterëve për të qenë përfitues të skemes). Mesatarisht bashkitë kanë përdorur rreth 3.49% të buxhetit të tyre për mbrojtje sociale të shtresave në nevojë në vitin 2019. Më shumë fonde janë alokuar nga bashkitë për mbrojtjen sociale, krahasuar me 2018 (2.85% e buxhetit vendor mesatarisht).

- Ligji për strehimin social<sup>86</sup> përcakton kuadrin, standartet dhe mënyrën e administrimit dhe shpërndarjes së banesave sociale për kategori të ndryshme të shtresave në nevojë duke ju dhënë përparësi fëmijëve jetimë në moshë madhore, nënave me fëmijë dhe të divorcuara dhe viktimat e trafikimit. Në 2019, mesatarisht rreth 2.35% e rasteve të strehimit social të trajtuar nga bashkitë<sup>87</sup> janë ofruar për viktimat e trafikimit (N=59).
- Në 29 bashki ne vitin 2019 (ose 47.54% e tyre) funksionojnë qendra ditore të kujdesit social për moshën e tretë, dhe shtresat në nevojë përfshirë qendrat komunitare për pakicat rome dhe egjiptiane; gjithsej 75 qendra të raportuara. Bashkitë mbështesin funksionimin e këtyre qendrave; gjithashtu, OSHC dhe projekte më financim të huaj kanë dhënë mbështetje dhe trajnime për stafin e qendrave ditore dhe komunitare, si dhe pajisjen me mjete e materiale didaktike dhe edukative të nevojshme për funksionimin e tyre.

Grafiku 60: Raport Vlerësimi vjetor për mbrojtjen sociale

Grafiku 61: Sektor i Vlerësimi të Nevojave dhe Referimit i ngritur

■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna



Harta 24

Harta 25



86 Ligji nr.22/2018 “mbi Strehimin Social”


87 Bashkitë Vlorë, Himarë, Peqin, Mallakastër dhe Berat

- Në nivel vendi, rreth 10,372 persona në nevojë kanë frekuentuar qendrat ditore ku kanë marrë shërbime të ndryshme, ose mesatarisht 181 persona (N=57). Numri i personave të shërbyer gjatë vitit 2019 ka qenë më i lartë, krahasuar me 2018 (mesatarisht 173 persona).


Harta 26: Shkalla e planifikimit të fondit vendor për mbrojtje sociale



Harta 27: Numri i qendrave ditore të kujdesit social



Grafiku 62: Persona në nevojë që kanë frekuentuar dhe marrë shërbime nga qendrat ditore të kujdesit social




**Objektivi specifik: përfshirja sociale në nivel vendor**

Ka përmirësim të performancës së bashkive lidhur me hartimin e planit vendor për përfshirjen sociale - 63.9% e bashkive kanë raportuar se kanë miratuar planin vendor me vendim të Këshillit Bashkiak; treguesi evidenton rritje +17.9 p.p., krahasuar me vitin 2018.

Në vitin 2019, gjithsej 88 nëpunës vendor janë trajnuar lidhur me metodologjinë e matjes së treguesve të mbrojtjes, ose 22 persona më shumë krahasuar me 2018; bashki pjesëmarrëse në trainime kanë qene 31 ose 5 bashki më shumë krahasuar me 2018.

**Grafiku 63: Plan Lokal për Përfshirjen Sociale**


Po Jo Nuk ka të dhëna





**Harta 28**



**Grafiku 64: Plan Lokal për Përfshirjen Sociale i miratuar nga NJQV, 2017-19**




**Grafiku 65: Trajnime mbi metodologjinë e matjes së treguesve të mbrojtjes e përfshirjes sociale**




Baza statistikore për përfshirjen sociale është ngritur dhe bërë funksionale në 52.46% të bashkive në vitin 2019; treguesi evidenton përmirësim me +7.46 p.p., në krahasim me vitin 2018. Bashkitë që raportojnë mbi bërjen funksionale të bazës së të dhënave në 2019 janë Bashkitë Kukës, Berat, Polican, Memaliaj, Mallakastër dhe Belsh.

Grafiku 66: Bazë të dhënash për përfshirjen sociale



- Punëkërkuess të papunë që janë mbuluar nga skema e NE, në nivel vendi janë raportuar gjithsej 13,216 persona, ose mesatarisht 249 persona (N=53). Shifra në realitet duhet të jetë më e lartë sepse disa bashki nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme për treguesin.
- Gjithsej, 2211 nxënës kanë ndjekur arsimin profesional të cilët kanë përfituar bursa për vitin shkollor.


Grafiku 67: Progresi në ngritjen e bazës së të dhënave statistikore



Harta 29



Harta 30: Punëkërkuess të papunë të mbuluar nga skema në bashki





### **Kutia 7 : Vështirësi të bashkive në ushtrimin e funksionit të mbrojtjes sociale**

**Bashkia Berat:** Rritja e numrit të punonjëve që mbulojnë PAK

**Bashkia Bulqizë:** Vonesa e sjelljes së dosjeve nga Drejtoria Rajonale dhe KMCAJ sjellin vonesa në kryerjen e pagesave dhe pakënaqësi tek qytetarët.

**Bashkia Devoll, Kamëz, Maliq:** Ngritja e një qendre ditore për personat me aftësi ndryshe.

**Bashkia Dibër, Mallakstër:** Ofrimi i shërbimeve për një numër relativisht të lartë të PAK.

**Bashkia Durrës:** Sesibilizim i vazhdueshëm dhe mbajtja e kontakteve për ti përfshirë në aktivitete.

**Bashkia Korçë:** 5-6 karroca të dhuruara nga bashki në bashkëpunimi me shërbimin social shtetëror, dhe 4-5 karroca të tjera në bashkëpunim me OJF.

**Bashkia Klos:** Evidentimi i rasteve që janë përfitues të skemës për PAK.

**Bashkia Lezhë:** Rritja e numrit të PAK nga vit në vit.

**Bashkia Mirditë:** Evidentimi i rasteve dhe ndihmës në përgatitjen e dokumentacionit dhe orientimin tek institucionet përkatëse.

**Bashkia Roskovec:** Eshtë parashikuar kalimi i pagesës së paaftësisë në formë elektronike në 2020; ka nevojë për trajnime të administratorëve sociale në NJA.


**Bashkia Shkodër:** Zbatimi i vendimeve sipas afateve të përcaktuara nga KMCAJ-I, dhe kryerja e pagesave brenda afateve ligjore.

**Bashkia Tiranë:** Transformimi i skemës sociale (cash) më shportën e shërbimeve bio-psiko-sociale.

**Bashkia Tropojë:** Mbetet sfidë ofrimi i shërbimeve shtesë për përfituesit e skemës PAK.

#### **Problemet dhe sfidat**

- Nivel i ulët i investime në ndërtimin e banesave sociale.
- Venia në zbatim e programeve sociale të strehimit për të gjitha kategoritë përfituese.
- Shtrirja e shërbimeve në të gjithë territorin e bashkive dhe konsolidimi i shërbimeve të ofruara.
- Ngritja e qendrave ditore për personat me aftësi ndryshe në cdo bashki.
- Vonesa në trajtimin e dosjeve nga Drejtoria Rajonale dhe KMCAJ sjellin vonesa në kryerjen e pagesave dhe pakënaqësi tek qytetarët, prandaj sfidë mbetet zbatimi i vendimeve sipas afateve të përcaktuara nga KMCAJ, dhe kryerja e pagesave brenda afateve ligjore.
- Transformimi i skemës sociale (cash) me shportën e shërbimeve bio-psiko-sociale.
- Zhvillimi i aftësive të stafit vendor që punojnë në strukturat e Shërbimeve Sociale të Bashkisë dhe aftësitë e raportimit (d.m.th. hartimi i përvitshëm i Raportit të Vlerësimit për Mbrojtjen Sociale në nivel lokal).
- Kalimi i pagesës së paaftësisë në formë elektronike kërkon trajnime të administratorëve sociale të NJA të bashkive.
- Burime të kufizuara njerëzore, teknike dhe financiare për krijimin e bazës së të dhënave statistikore sipas treguesve të BE-së për përfshirjen sociale nga të gjitha bashkitë në vend.





## Rekomandime


- Raportimi i plotë mbi treguesit e performancës të sektorit të përkrahjes dhe mbrojtjes sociale nga të gjitha bashkitë. Trajnim i vijueshëm për të rritur cilësinë e administrimit të sektorit dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara tek qytetarët.
- Bashkitë duhet të sigurojnë një staf të mjaftueshëm sipas legjislacionit në fuqi për të përmbushur të gjitha nevojat e grupeve në nevojë dhe duhet të rrisin kapacitetet e tyre përmes trajnimeve të vazhdueshme për problemet e grupeve të ndryshme të shënjestëruara në mënyrë që të ofrojnë shërbime sociale me cilësi dhe efikasitet.
- Rishikimi i planeve të para sociale vendore me qëllim harmonizimin e planeve sociale me kuadrin ligjor dhe me strategjinë kombëtare të aprovuar.
- Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave reale për secilin grup të marginalizuar dhe përfshirja e të gjithë këtyre grupeve në planet sociale me qëllim që ato të hartohen në mënyrë realiste. Bashkitë duhet të marrin parasysh edhe trajtimin e problemeve/nevojave të territoreve të tyre rurale në planet sociale.
- Rishikimi i planeve sociale gjatë fazave të zbatimit të tyre, pasi planet sociale që kanë objektiva afatgjata duhet të jenë të matshme dhe të arritshme, ndërkohë që ato duhet të zërthehen në
- Shpërndarje të shërbimeve sociale në të gjitha territoret, si në ato rurale ashtu edhe në ato urbane si dhe mbështetja e bashkive për krijimin e shërbimeve të drejtpërdrejta në mënyrë që grupet e ndryshme në nevojë të marrin shërbimet sociale të mira dhe cilësore. Gjithashtu, është e nevojshme të përcaktohen standardet e shërbimit dhe kostot për njësi.
- Krijimi i një baze të dhënash për indikatorë të ndryshëm në lidhje me shërbimet sociale për grupe të ndryshme vulnerabël, si dhe krijimi i një baze të dhënash për të gjitha rastet e referimit në mënyrë që të menaxhohen me efikasitet të dhënat vendore dhe të trajtohen politikat e duhura. Është e rëndësishme të vlerësohen treguesit përkatës për të qenë pjesë e bazës së të dhënave.
- Është gjithashtu e rëndësishme të rritet cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve sociale dhe të forcohet sistemi i referimit dhe i menaxhimit të rasteve.
- Ngritja e strehëzave për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, rasteve të abuzimit të fëmijëve ose viktimave të mundshme të trafikimit në secilën bashki.
- Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese si dhe ndërtimi i infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara që do të lehtësojë lëvizjen dhe kushtet e tyre të jetesës.
- Financimi dhe krijimi i qendrave komunitare për të gjitha grupet vulnerabël në secilën bashki me qëllimin e marrjes së shërbimeve.

### Objektivi specifik: mbështetje për programet aktive të punës

Prej disa vitesh ka nisur procesi i zbatimit të një qasje sektoriale për punësimin dhe aftësimin profesional dhe është ngritur Grupi i Menaxhimit të Politikave të Integruara (GMIP); në 2019 është miratuar Strategjia për Punësim dhe Aftësim 2019 – 2022, dhe plani i veprimit dhe është krijuar Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim; Për të përmirësuar efektivitetin, është krijuar Mekanizmi i bashërendimit ndërinstitucional të punës<sup>88</sup> për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive të punës të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike<sup>89</sup>. Brenda muajit janar të çdo viti grupi ndërministror harton

88 VKM Nr 882/24.12.2019


89 Koordinimi i veprimtarisë së mekanizmit të bashërendimit ndërinstitucional të punës në nivel qendror kryhet nga grupi ndërministror, i cili përbëhet nga përfaqësues të: a) ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale; b) ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit; c) ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe infrastrukturën; ç) ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural; d) ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin; dh) ministrisë përgjegjëse për pushtetin lokal; e) Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Ministria për çështjet sociale drejton grupin ndërministror. Zbatimi i veprimtarisë së mekanizmit dhe në përputhje me fushën e përgjegjësisë shtetërore të institucioneve respektive, realizohet nga: a) Shërbimi Social Shtetëror; b) Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive; c) Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore; ç) Njësitë e vetëqeverisjes vendore



dokumentin indikativ vjetor të integritit të përfituesve të ndihmës ekonomike në tregun e punës, nëpërmjet përfshirjes së tyre në punët publike të parashikuara në buxhetin e shtetit për atë vit kalendarik në sektorët e infrastrukturës, energjisë, bujqësisë, turizmit, zhvillimit rural dhe të investimeve të parashikuara në buxhetet e bashkive.

- Numri i përgjithshëm i punëkërkuarve të trajtuar me ndihmë ekonomike por të mbështetur për të qenë pjesë e programit të formimit profesional dhe për tu përfshirë në punët publike në vitin 2019 ka qenë 4,876 individë<sup>90</sup>. Vetëm 26 bashki kanë raportuar për këtë tregues.


Grafiku 68: Të papunë që marrin NE nga NJQV



- Për integrimin e personave me aftësi ndryshe (PAK), në 2019 janë mbështetur 262 individë gjithsej nëpërmjet frekuentimit të programeve për aftësim profesional. Ky tregues rezulton të jetë më i vogël krahasuar me 2018<sup>91</sup>. Rreth 34% e bashkive kanë ofruar të dhëna për këtë tregues.
- Të rinj që kanë përfunduar arsimin universitar dhe programin e formimit profesional të cilët janë mbështetur nga shërbimet e bashkisë dhe aktorë të tjerë për hapjen e një biznesi në fushat e tyre respektive kanë qenë 179 individë në 2019; numri i bashkive mbështetëse është mjaft i vogël – 7 bashki<sup>92</sup>.
- Niveli i ndërgjegjësimit të bashkisë mbi NEET-të në territorin e saj për të ngritur dhe përditësuar një databazë të individëve që rrezikojnë varfërinë/dhe individë të skemes së NE, për tu bërë pjesë e programeve të aftësimit profesional dhe që të përfshihen në projektet e shërbimeve publike të parashikuara nga buxheti i shtetit ka qenë i vogël. Treguesi është -11.48 p.p. krahasuar me 2018.

Grafiku 69: Niveli i ndërgjegjësimit të bashkisë mbi NEET


■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna



Harta 31



90 Shifra mund të ketë pasaktësi sepse rezulton të jetë rreth 5 herë më e vogël, krahasuar me vitin 2018.  
 91 Në vitin 2018, treguesi i raportuar ishte ekuivalent me 9387 individë.  
 92 Bashkia Cërrik, Tiranë, Dibër, Berat, Shkodër, Mallakastër dhe Himarë.



Gjithsej, 163 të rinj janë mbështetur nga bashkia dhe institucione qendrore në nivel rajoni dhe vendor për integrimin e tyre në tregun e punës.


- Në bashkërendim me institucione të tjera në nivel vendor, Bashkitë<sup>93</sup> kanë mbështetur gjithsej 59 iniciativa për të rinj dhe individë të tjerë për tu integruar në tregun e punës dhe formim profesional dhe hapjen e bizneseve të reja.

### Problemet dhe sfidat

- Mungesa e fondeve dhe kapacitete profesionale në bashki.
- Mbetet sfide rritja e mjeteve financiare (buxhetit vendor) për personat që trajtohen nga skema e NE me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës, dhe bashkërendim i mirë i veprimeve ndërmjet bashkisë dhe zyrave rajonale dhe vendore të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA).
- Ngritja e qendrave të formimit profesional në bashki të tjera.
- Bashkëpunimi më i mirë ndërmjet institucioneve për të nxitur punësimin dhe në mënyrë të veçantë për shtresat në nevojë.
- Bashkëpunimi efektiv ndërmjet bizneseve dhe OJQ për hapjen e bizneseve sociale dhe rritjen e punësimit të të rinjve dhe individëve që rrezikojnë të bien në varfëri.
- Qëndrueshmëria e mbështetjes për disa iniciativa punësimi mbas përfundimit të projekteve.
- Vështirësi në ecurinë dhe qëndrueshmërinë e bizneseve start-up për ti mbijetuar konkurrencës së tregut.
- Krijimi i nje sektori në bashki në mbështetje të punësimit të të rinjve, për analizën e situatës në terren dhe fond i dedikuar për integrimin e të rinjve në bashkëveprim me institucionet e tjera.

### Rekomandime

- Pushteti qendror dhe ai vendor duhet të sigurojnë nxitjen e mundësive aktuale të punësimit përmes politikave të efektshme të tregut të punës.
- Rritja e kapaciteteve dhe përcaktimi i programeve të kualifikimit në institucionet e arsimit profesional sipas nevojave të tregut vendor të punës.
- Ndërtimi dhe forcimi i bashkëpunimit me bizneset për të mundësuar formimin profesional të të papunëve në mënyrë që ata të jenë më të kualifikuar për të kapur shanset e punësimit në përgjithësi dhe të punësimit të grupeve në nevojë në vecanti.
- Nxitja e ndërmarrjeve sociale si një mekanizëm që siguron mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël përmes ofrimit të mundësive për punësim dhe integrimin ekonomik dhe shoqëror të grupeve në nevojë duke promovuar frymën e përgjegjesisë, solidaritetit dhe të kohezionit në komunitet.
- Bashkitë duhet të mbështesin dhe zbatojnë politikat e zhvillimit të ndërmarrjeve social sipas legjislacionit në fuqi.



## PËRFUNDIME MBI POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMIN

Në nivel kombëtar në 2019, është miratuar Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2019-2022 dhe plan-veprimi, është krijuar mekanizmi i bashkërendimit ndërinstitucional të punës<sup>94</sup> për punësim të individëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike me një fokus të veçantë në grupet vulnerabël dhe është krijuar Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe riorganizimi i zyrave në disa rajone dhe në nivel vendor. Mbetet sfidë forcimi i kapacitetit dhe burimeve të qeverisjes vendore për të vlerësuar nevojat e kujdesit shoqëror në territorin e bashkive.

**Progres modest është bërë në drejtim të shtimit të burimeve njerëzore në lidhje me mbrojtjen sociale në nivel vendor.** Gjithsej, 127 nëpunës vendorë shtesë të punësuar në sektorin e përkrahjes sociale (tregues është në të njëjtin nivel me vitin 2018); 211 nëpunës vendore të trajnuar në lidhje me prioritetet e sektorit dhe statistikave sociale. Sektori i vlerësimit të nevojave dhe referimit është funksional në 39,34% të bashkive<sup>95</sup>. Bashkitë kanë përdorur më shumë fonde në vitin 2019 se në vitin 2018 për mbrojtjen sociale, mesatarisht rreth 3.49% të buxhetit të tyre.

Ka përmirësim të performancës së bashkive lidhur me hartimin e planit vendor për **përfshirjen sociale** - 63.9% e bashkive kanë raportuar për miratimin e planit vendor me vendim të Këshillit Bashkiak; Baza statistikore për përfshirjen sociale është ngritur në 52.46% të bashkive (treguesi evidenton përmirësim me +7.46 p.p., në krahasim me vitin 2018).

Numri i përgjithshëm i punëkërkuarve të trajtuar me ndihmë ekonomike por të mbështetur për të ndjekur **programet e formimit profesional dhe për tu përfshirë në punët publike** në vitin 2019 ka qenë 4,876 individë. Për integrimin e personave me aftësi ndryshe (PAK), mbështetje është dhënë për 262 individë nëpërmjet mundësisë së ofruar për të frekuentuar programet për aftësim profesional (bazuar në të dhënat e vlefshme, treguesi evidenton ulje krahasuar me 2018).

Mbetet sfidë rritja e burimeve financiare dhe njerëzore për analizën në terren dhe për nxitjen e punësimit, si dhe bashkërendimi më i mirë i veprimeve ndërmjet bashkive dhe zyrave rajonale dhe vendore të AKPA; forcimi i qendrave të formimit profesional dhe paisja e tyre me baze materiale bashkëkohore; krijimi i disa qendrave të reja të formimit profesional është specifikuar si nevojë nga disa bashki të tjera.

### 3.7 Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumentave strukturorë

*Objektivi specifik: forcimi i bashkëpunimit në zhvillimin rajonal dhe lokal në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të zvogëlojnë pabarazitë (të sigurohet kohezioni ekonomik dhe social ndërmjet rajoneve).*


- 42.6% e bashkive kanë marrë ndërmarre iniciativa me interes të përbashkët me NJQV fqinje ose jo fqinje; treguesi shënon rritje me +4.6 p.p., krahasuar me vitin 2018.

94 VKM Nr 882/24.12.2019

95 Treguesi është në të njëjtin nivel me atë të raportuar në 2018

- Në vitin 2019, gjithsej 139 iniciativa janë nënshkruar dhe zbatuar nga 29 bashki (ose 47.5% e tyre) në fusha të interesit ekonomik dhe zhvillimit kulturor.


Grafiku 70: Pjesëmarrje në iniciativa të bashkëpunimit rajonal



Harta 32



Grafiku 71: Numri i bashkëpunimeve ndërmjet NJQV



### Rekomandime

- Rishikimi dhe përcaktimi në mënyrë të qartë i kompetencave vendore, rajonale dhe qendrore me qëllim që të shmangët mbivendosja e tyre dhe të ketë një harmonizim të strukturave në çdo nivel.
- Rritja e njohurive dhe e vetëdijësimit për bashkëpunimin ndërmjet bashkive lidhur me shërbime të ndryshme vendore dhe politika të investimeve përmes praktikave të mira, manualeve, broshurave, etj.
- Rritja e bashkëpunimit të Këshillit të Qarkut dhe institucioneve të tjera të pushtetit qendror dhe vendor për një zhvillim më të mirë rajonal.
- Forcimi i bashkëpunimit midis NJQV-ve në kuadrin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar për të rritur mundësitë për të përfituar nga fondet IPA.



## Kutia 8: Praktika të bashkëpunimit ndërmjet bashkive

**Bashkia Berat:** Projekt për menaxhimin e integruar të mbetjeve, bashkëpunim me pesë NJQV: Bashkia Berat, Ure Vajguore, Skrapar, Kucove dhe Polican.

**Bashkia Bulqizë:** pjesëmarrje në Këshillin Rajonal të Sigurisë Publike.

**Bashkia Dibër:** bashkëpunim për hartimin e planeve strategjike dhe financimin e tyre.

**Bashkia Dropull:** bashkëpunim me Bashkinë e Janinës, Bashkinë e Edhësës, Bashkinë e Selanikut, Bashkinë e Korcës, si dhe binjakëzim me Bashkinë e Trikallesë.

**Bashkia Durrës:** trajnime, shkëmbim eksperiencash dhe aktivitete në kuadër të projekteve TDH, IRCA, UNDP, Nisma Arsis.

**Bashkia Fiq:** bashkëpunim në kuadër të pjesëmarrjes në iniciativë të drejtuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut dhe Këshillit të Qarkut Vlorë.

**Bashkia Fushë-Arrëz:** bashkëpunim në projekte për mjedisin, panairë, trajnime për barazinë gjinore dhe zhvillimin rural.

**Bashkia Kolonjë:** Aktivitete të promovimit të produkteve të zonës

**Bashkia Maliq:** Bashkëpunimi në fushën e shkëmbimit kulturor me Bashkinë e Korinthit.

**Bashkia Mirditë:** Pjesëmarrja në aktivitete kombëtare si “Shqipëria Punon Token” dhe “Panairi i Turizmit 2019”.


**Bashkia Pukë:** Binjakëzimi me Komunën Singa në Itali.

**Bashkia Roskovec:** Eshtë parashikuar kalimi i pagesës së paaftësisë në formë elektronike në 2020; ka nevojë për trajnime të administratorëve sociale në NJA.

**Bashkia Shkodër:** Anëtarësimi në forumin e qyteteve që lagen nga deti Adriatik dhe Jon, FAIC 2. Bashkëpunimi me Hungarian Ëtartechnology Cooperation për çështje që kanë të bëjnë me ujësjellës kanalizime. 3. Vendosja e bashkëpunimit me Bashkinë Podgoricë për iniciativë të përbashkëta në fushën e emërgjensave civile, mjedisit, turizmit, artit dhe kulturës. 4. Bashkëpunimi me Bashkinë e Strasburgut, pjesë e rrjetit evropian të solidaritetit - Klubi i Strasburgut në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. 5. Bashkëpunimi me Bashkinë e Triestes në kuadër të projektit Yes Future. 6. Bashkëpunimi me rajonin Emilia Romagna në kuadër të projektit DEAR. 7. Bashkëpunimi me rajonin Friuli Venezia Giulia.

**Bashkia Tiranë:** bashkëpunime në disa iniciativë rajonale, përfshirë angazhime me Shoqatën e Autonomisë Vendore, aplikime për projekte të përbashkëta me bashki të tjera, evente të organizuara në kuadrin e Qarkut Tiranë dhe në kuadrin e harmonizimit dhe përforcimit të kanaleve të komunikimit; shkëmbime të eksperiencave, kryesisht sa i takon praktikave të mira në fushën e energjisë, trajtimit të mbetjeve, aplikimit në projekte me financim të fondeve të BE-së, etj. Bashkia Tiranë ka iniciuar dhe krijimin e Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon, me perfaqësues nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia.

**Bashkia Vlorë:** organizime të shoqata të bashkive dhe takime të koordinuara nga qeverisja qendrore.



## PËRFUNDIME MBI POLITIKAT RAJONALE

**Bashkëpunimi ndër-bashkiak mbetet në një nivel modest dhe i ngjashëm me treguesit respektivë për vitin 2018**, për sa i përket forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe lokal për zhvillimin ekonomik, social dhe shkëmbimin e vlerave kulturore. Rreth 42% e bashkive kanë marrë ndërmarrë iniciativa me interes të përbashkët me NJQV fqinje ose jo fqinje; gjithsej 139 iniciativa të raportuara.

NJQV duhet të bëjnë më shumë përpjekje në drejtim të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndër-rajonal, dhe të harmonizojnë veprimet për çështje ndër-bashkiake, si mjedisi, transporti, mobiliteti, eficienta energjitike, dhe shkëmbim eksperience për praktika të mira; kërkohet më tepër bashkëpunim për projekt-propozime dhe për partneritete në thirrjet në kuadër të programeve IPA dhe programe të tjera.

### 3.8 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

“Vlerat themelore të BE përfshijnë zbatimin e ligjit dhe shtetin e të drejtës dhe respektimin e të drejtave njerëzore. Një sistem gjyqësor funksional dhe një luftë efektive kundër korrupsionit janë kondita të një rëndësie të madhe, ashtu siç është respektimi i të drejtës themelore me ligj dhe në praktike”<sup>96</sup>.


Progresi në ushtrimin e funksioneve dhe rolit të NJQV për këtë fushë vlerësohet mbi bazën e 47 treguesve të performancës për gjashtë objektiva specifike.

*Objektivi specifik: forcimi i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*

Në nivel të politikave të qeverisjes qendrore, është hartuar axhenda kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2017-2020 që përmban tre shtylla kryesore: (i) Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, (ii) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve që synon ngritjen e një sistemi të integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet një kuadri ligjor dhe institucional të përmirësuar ndjeshëm, (iii) Sisteme dhe shërbime miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve: arsimimi, drejtësia, shëndeti, ushqyerja dhe mbrojtja sociale.

- Dokumentohet progres në krijimin e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në administratën vendore nga 91.8 % e bashkive, ose 1.8 p.p. më i lartë se në vitin 2018. Njësitë nuk janë ngritur ende në bashkitë Mat, Roskovec dhe Bulqizë, ndërkohë që bashkitë e Memaliajt, Pustecit dhe Malësisë Madhe nuk kanë dhënë informacion mbi këtë tregues.


Grafiku 72: NJMF e ngritur në NJQV




Harta 33



Grafiku 73: Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijë, 2017-2019



Harta 34: Shkalla e urdhërave për mbrojtje të lëshuara ndaj rasteve të identifikuar



- Sistemi i monitorimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve në territorin e bashkisë është funksional nga 68.85%; tregon përmirësim në krahasim me vitin 2017 (+ 19.85 p.p.); rreth 27.8% e bashkive nuk e kanë funksional systemin e monitorimit të rasteve; 2 bashki nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme për treguesin<sup>97</sup>.
- Mesatarisht janë kryer 10.85 takime të përbashkëta të grupeve ndërdisiplinore në nivel bashkie (N = 55) për rastet e shkeljes së të drejtave të fëmijëve, që është në nivel të njëjtë me vitin 2018<sup>98</sup>.
- Numri gjithsej i rasteve të identifikuar dhe të trajtuara për shkelje të të drejtave të fëmijëve është raportuar 1,267, ose mesatarisht 21.84 raste (N=58). Në vitin 2019 raportohen më pak raste në krahasim me vitin 2018 (mesatarisht 24 raste të identifikuar)<sup>99</sup>.
- Shkalla mesatare e urdhërave për mbrojtje të lëshuara ndaj numrit të rasteve të identifikuar është rreth 30.31%.
- Referuar shërbimeve të posaçme, mesatarisht për 31.86% të rasteve të identifikuar të fëmijëve, bashkitë kanë mundur ofrimin e shërbime të veçanta.
- Mesatarisht, 4.04% e buxhetit për mbrojtjen sociale është përdorur nga NJQV për rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve (N=57)<sup>100</sup>; treguesi është në nivel të njëjtë me vitin 2018.
- Numri i Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) është miratuar 235 në të gjithë vendin. Gjithsesi, ky numër nuk përfaqëson ngritjen e të gjitha strukturave të nevojshme në përputhje me përcaktimet ligjore<sup>101</sup>. Bashkitë kanë raportuar 159 nëpunës vendore në strukturat PMF për vitin 2019, ose mesatarisht 2.6 nëpunës (N=61); treguesi në vitin 2018 është raportuar më i lartë (mesatarisht 3 nëpunës vendorë).

97 Bashkia Belsh dhe Himarë

98 Gjashtë bashki nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme – Bashkia e Vaut të Dejës, Përrenjas, Ura Vajguore, Memaliaj, Himarë dhe Konispol


99 Tre bashki nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme – Bashkia Përrenjas, Memaliaj dhe Himarë

100 Katër bashki nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin -Bashkia Malësi e Madhe, Përrenjas, Memaliaj, Himarë

101 Burim: Raporti Monitorimi i Observatorit të Fëmijëve (2019)




Grafiku 74: Aktivitete për promovimin e të drejtave të fëmijëve të organizuara nga NJQV



- Në vitin 2019, janë organizuar 570 aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve (166 aktivitete më shumë se në 2018), ose mesatarisht 10 aktivitete (N = 57).

Grafiku 75: Aktivitete të organizuara nga NJQV për promovimin e të drejtave të fëmijëve, 2017-19



### Problemet dhe sfidat

- Nevoja e zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të nëpunësve vendorë dhe stafeve të qendrave komunitare, dhe aktorëve të tjerë të përfshirë lidhur me sistemin e menaxhimit të mbrojtjes së fëmijëve.
- Qëndrueshmëria e stafeve të bashkive dhe atyre në qendrat komunitare
- Përmirësimi i buxhetimit për menaxhimin e rasteve në nivel vendor dhe rritja e kapaciteteve financiare për të siguruar shërbimet e duhura që ofrohen.
- Plotesimi i strukturave me nëpunës sipas numrit të planifikuar dhe forcimi i kapaciteteve të monitorimit dhe inspektimit bazuar në standarde të përditësuara.
- Forcimi i bashkëpunimit me OJF, mediat dhe aktorë të tjerë vendorë në respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Edukimi qytetar për të drejtat e fëmijëve.


## Rekomandime

- Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe përmirësimi i shërbimeve publike, shërbimeve ligjore dhe psikologjike për mbrojtjen e fëmijëve.
- Krijimi i një qendre të specializuar për ofrimin e shërbimeve për fëmijët që kanë përjetuar dhunë fizike, psikologjike dhe seksuale, dhe fëmijëve që janë lënë pas dore.
- Sigurimi i programeve dhe i politikave të reja për punësimin e prindërve, fëmijët e të cilëve kanë probleme të ndryshme (në mënyrë që ata të punojnë dhe të kujdesen për fëmijët e tyre).
- Ndërgjegjësimi dhe mobilizimi i institucioneve publike dhe jopublike në nivel qendror dhe vendor për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës.
- Rritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor në lidhje me zbatimin e legjislationit, procedurat e mbrojtjes së fëmijëve, identifikimin proaktiv dhe bashkëpunimin ndër-sektorial.
- Sigurimi dhe ofrimi i shërbimit të ndërhyrjes dhe të pritjes për të ndihmuar fëmijët 24 orë në ditë nga të gjitha bashkitë në nivel kombëtar.
- Krijimi i grupeve ndër-sektoriale (shumë-disiplinore) për të ofruar shërbime për fëmijë në secilën bashki dhe njësi administrative.
- Krijimi i grupeve të punës (nga punonjësit e institucioneve ose të organizatave vendore) për të identifikuar fëmijët në situatë rruge në të gjithë bashkitë.
- Monitorimi dhe kontrolli i mediave që publikojnë raste që kanë të bëjnë me çështjet e fëmijëve (për të ruajtur parimin e konfidencialitetit dhe për të shmangur ri-viktimizimin e fëmijës).

### Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”


- Trajnimet për nëpunësit vendorë mbi ligjin 10221/2010 dhe aktet nën ligjore kanë vijuar në vitin 2019, por më pak persona janë trajnuar; gjithsej, 150 persona të trajnuar ose mesatarisht 2.5 në 2019, krahasuar me vitin 2018 (6 mesatarisht); 36% e bashkive nuk kanë ndjekur trajnime mbi ligjin kundër diskriminimit.

Grafiku 76: Nëpunës vendor të trajnuar mbi ligjin e mbrojtjes nga diskriminimi




- Sistemi i monitorimit të rasteve të identifikuar të diskriminimit është ngritur nga 36% e bashkive (+3.2 p.p. më i lartë krahasuar me 2018). Sistemi i monitorimit të rasteve është një instrument për trajtimin efektiv të rasteve nga nëpunësit vendorë në bashkërendim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Grafiku 77: Krijimi i një sistemi të monitorimit të rasteve për diskriminim të ndodhur brenda territorit të Bashkise




- Fushata ndërgjegjësuere nga NJQV në shkolla dhe komunitete për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI janë organizuar nga 14.75% e bashkive<sup>102</sup>; gjithsej 14 fushata; më pak fushata ndërgjegjësimi të organizuara në 2019, krahasuar me vitin 2018.


Grafiku 78: Sistemi i monitorimit të rasteve për diskriminim i ngritur




Harta 35



Grafiku 79: Sistemi i monitorimit për shkelje të të drejtave të pakicave i ngritur në NJQV



Harta 36




102 Bashkia Tiranë, Durrës, Krujë, Elbasan, Gramsh, Vlorë, Klos, Gjirokastër, Librazhd



Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 96/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e pakicave etnike”

- Sistemi i monitorimit për shkelje të të drejtave të pakicave është ngritur dhe është funksional në 19.6 % të bashkive në vitin 2019. Bashkitë Libohovë, Peqin, Lushnjë dhe Selenicë raportojnë bërjen funksionale të sistemit në 2019, ndërsa Bashkia Korçë, Librazhd, Elbasan dhe Gramsh raportojnë ‘Jo’ krahasuar me ‘Po’ në 2018.
- Rreth 44.3% e bashkive kanë organizuar 174 aktivitete të ndryshme kulturore dhe fushata ndërgjegjësimi për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike<sup>103</sup> (-2.7 p.p.më pak krahasuar me 2018).
- Rreth 8% e bashkive kanë raportuar mbi ofrimin e shërbimit publik me dy gjuhë i cili rregullohet me ligjin për mbrojtjen e pakicave.


Grafiku 80: Nëpunës vendor të trajnuar mbi PKVIRE




Grafiku 82: PV për Integrimin e pakicave



Grafiku 81: Aktivitete ndërgjegjësuese nga NJQV në mbështetje të të drejtave të pakicave etnike




103 Java e Kulturës Rome (2-8 Prill), 1 Qershor - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, 17 Tetor - Dita Ndërkombëtare Kundër Varfërisë, 10 Dhjetori - Dita Ndërkombëtare e Tolerancës, dhe aktivitete të tjera



Objektivi specifik: Përmirësimi i koordinimit të punës ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e minoriteteve Rome dhe Egjiptianë 2016-2020


- Forcimi i kapaciteteve të nëpunësve socialë, të cilët punojnë me pakicat etnike rome dhe egjiptiane, ka vijuar në vitin 2019; rreth 23% e bashkive kanë marrë pjesë në programe trajnimi, më pak nëpunës vendorë të trajnuar për masat e zbatimit në nivel vendor të planit kombëtar (-3.27 p.p.), krahasuar me vitin 2018.
- Në linjë me Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane 2014-2020, tetë bashki punuan për hartimin e planit vendor për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane gjatë vitit 2019 me OJF dhe ekspertë të jashtëm. Bashkitë Elbasan, Pogradec, Fier, Lushnjë, Roskovec, Gjirokastrë, Përmet, Vlorë u mbështetën nga ROMACTED, një projekt i financuar nga KE. Takime me grupet e pakicave dhe grupin ndërinstitucional, u organizuan për priorizimin e masave dhe treguesit sipas fushave përkatëse. Drejtoritë e Përkrahjes Sociale në bashkitë janë përgjegjëse për monitorimin dhe raportin vjetor.
- Rreth 34.4% e bashkive kanë raportuar se plani i veprimit për integrimin e pakicave etnike rome dhe egjiptiane në nivel vendor është hartuar dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak, ose është në proces miratimi; treguesi ka rritje me +3.2 p.p. në krahasim me 2018.

Grafiku 83: Plan Vendor për Integrimin e pakicave, 2017-19




- Trajnime për grumbullimin e të dhënave dhe raportimin në kuadër të sistemit ROMALB janë ndjekur nga 44.26% e bashkive, 46 nëunës të trajnuar; treguesi është në nivel të krahasueshëm me vitin 2018. Mesatarisht 1.7 trajnime për bashkitë pjesëmarrëse (N=27); treguesi varion nga 6 (vlera max) në 1 (vlera minimale).

Grafiku 84: Trajnime për systemin ROMALB



- Shfrytëzimi i rregullt i sistemit ROMALB për statistika dhe analiza, si dhe raportim për vendimmarrjen e Bashkisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është raportuar nga 49% e bashkive.
- Rreth 824 individë nga pakicat rome dhe egjiptiane kanë përfituar nga programi i strehimit social, kryesisht me mbështetjen e bonusit të qerasë, ose mesatarisht 33 individë (N=25).

Grafiku 85: Persona përfitues të pakicave etnike nga programet e strehimit



- Në vitin 2019, 65 projekte janë zbatuar në mbështetje të pakicave rome dhe egjiptiane nga 27 bashki (ose 49% e bashkive), ose mesatarisht 2.4 projekte për bashkitë përfituese. Treguesi varion nga 10 (vlera max) në 1 projekt (vlera min).
- Numri i përgjithshëm i punëkërkesve të regjistruar pranë zyrave vendore dhe rajonale të të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim ka qenë 7362 (N = 47), ose rreth 3145 punëkërkes me shumë krahasuar me vitin 2018. Numri i të punësuarve nga komunitetet rome dhe egjiptiane ka qenë 427 persona.
- Numri i të punësuarve të pakicave rome dhe egjiptiane nga shërbimet e bashkisë dhe në projekte publike ka qenë 217, ose 50.8% e numrit gjithsej të të punësuarve nga këto komunitete në vitin 2019.


### Problemet dhe sfidat

- Burime të pakta financiare për të mbuluar shërbimet ligjore në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Organizata të shoqërisë civile të specializuara, me anë të projekteve, mundësojnë ofrimin e disa shërbimeve për qytetarët në luftën kundër diskriminimit dhe njohjen e të drejtave të minoriteteve. Mbetet sfida qëndrueshmëria financiare me përfundimin e projekteve.
- Mbetet sfida rritja e bashkërendimit të veprimeve ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore në zbatim të kartës evropiane të të drejtave të njeriut dhe edukimi qytetar.
- Rritja e burimeve njerëzore pranë shërbimit social të bashkive për çështjet e pakicave rome dhe egjiptiane për të kryer vizitat në terren, përdorimi i sistemit ROMALB nga të gjitha bashkitë.
- Planifikimi i planeve vendore për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane në PBA.
- Krijimi i infrastruktures në shkolla (ndërtimi i menceve) për të konsumuar një vakt ushqimi dhe mbulimi i fëmijëve rome dhe egjiptiane me vakt falas.


Objektivi specifik: forcimi i sistemit për sigurimin e barazisë gjinore

- Sektori i barazisë gjinore është krijuar nga 68.85% e bashkive; treguesi ka rënie të lehtë me -3.14 p.p. në krahasim me vitin 2018, e cila mund të jetë për shkak se dy bashki Himarë dhe Shijak nuk kanë ofruar të dhëna për këtë tregues.
- Nëpunës vendor i caktuar në kapacitetin e koordinatorit lokal për çështjet gjinore është ngarkuar nga 81.96% që evidenton rënie të lehtë krahasuar me vitin 2018 (-1.03 p.p.). Bashkitë Prrenjas dhe Shijak nuk kanë ofruar informacion lidhur me emërimin e kordinatorit në bashkitë e tyre. Aplikimi i mekanizmave në kuadër të harmonizimit të masave për të luftuar dhunën në familje është funksional në 85% të bashkive; treguesi evidenton përmirësim me +2 p.p., krahasuar me vitin 2018.
- Përfitues të programeve të trajnimit për çështjet e barazisë gjinore (programe të ofruara nga ASPA dhe ofrues të tjerë) kanë qene 172 persona në vitin 2019, ose mesatarisht 3 persona për bashki; treguesi tregon më pak trajnime të kryera në këtë fushë, krahasuar me vitin 2018 (mesatarisht 4 trajnime për bashki), por është më i lartë se në vitin 2017 (mesatarja 1 trajnim).
- Për rastet e raportuara dhe të identifikuara të viktimave të dhunës në familje, bashkitë ofrojnë shërbime të specializuara në qendra komunitare të përkuqdesit social, shërbime me psikologë dhe trajtime të tjera; në vitin 2019, janë raportuar 138 shërbime të specializuara nga 36 bashki, mesatarisht 2.66 (N=56); treguesi evidenton rënie të numrit të këtyre shërbimeve me -22.9 p.p. , krahasuar me vitin 2018.


Grafiku 86: Sektor i Barazisë Gjinore i ngritu



Harta 39




Grafiku 87: Mekanizmi i sistemit të referimit ndaj dhunës në familje



Harta 40




Grafiku 88: Shërbime të specializuara të ofruar nga NJQV për viktimat e dhunës në familje



- Bashkitë përditësojnë të dhënat rregullisht në sistemi REV-ALB dhe raportojnë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; vlera mesatare e raportimeve nga bashkitë (N=31) është 11 raporte në vit<sup>104</sup> (pra raportim çdo muaj); treguesi është në të njëjtin nivel krahasuar me vitin 2018.
- Raportime për çështje të barazisë gjinore në MSHMS janë kryer nga 59% e bashkive; më pak bashki kanë raportuar në vitin 2019, krahasuar me 2018 (-29.9 p.p.). Vlera mesatare e raportimeve për çështje të barazisë gjinore në nivel vendor ka qenë 4.6 raportime (N=35) (më pak raportime në 2019, krahasuar me 2018 për çështje të barazisë gjinore).
- Progres është bërë lidhur me buxhetimin gjinor; 31.15% e bashkive kanë përgatitur buxhetin vjetor bazuar në metodologjinë që merr në konsideratë aspektin gjinor, treguesi shënon rritje me +6.16 p.p., krahasuar me vitin 2018.
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile për organizimin e aktiviteteve kundër diskriminimit gjinor është realizuar nga 54% e bashkive (+2.46 p.p. më i lartë në krahasim me vitin 2018); mesatarisht 6.24 aktivitete (N=33); 36% e bashkive nuk kanë patur aktivitete.

Grafiku 89: Buxhetimi gjinor nga NJQV




Harta 41



104 Bashkia Durrës ka raportuar 352 raste; për llogaritjen e mesatares se 31 bashkive të tjera, nuk është përfshirë vlera e lartë e raportuar nga Bashkia Durrës (352).




Grafiku 90: Aktivitete të Bashkive dhe OSHC për diskriminimin gjinor, 2019



- Në vitin 2019, gjithsej janë raportuar 230 shërbime për menaxhimin e rastit, ose mesatarisht 4.34 shërbime (N=53); ndërsa mesatarja e shërbimeve për grupin e bashkive raportuese<sup>105</sup> (N=30) ka qenë 8 shërbime për menaxhimin e rastit<sup>106</sup>.

Grafiku 91: Numri i shërbimeve sipas menaxhimi të rastit, 2019




- Rreth 1,032 kopshte dhe çerdhe kanë patur shërbime për mirëmbajtje dhe rindërtimi nga bashkitë (N=58) gjatë vitit 2019, ose mesatarisht 18 për bashki, qe rezulton pak më e lartë (+1) krahasuar me vitin 2018<sup>107</sup>.
- Bashkitë kanë alokuar një fond vendor për çështje të mbrojtjes së viktimave nga dhuna në familje, për të ofruar shërbime në mbrojtje sociale për personat që qëndrojnë në strehëzat e mbrojtjes për femrat, mesatarisht 25.53% te fondit vendor për sektorin e mbrojtjes dhe përkrahjes sociale, në 2019 (N=47).
- Aktivitete për promovimin e barazisë gjinore dhe në zbatim të Kartës Evropiane për barazinë e personave M/F në jetën vendore janë kryer nga 35 bashki (ose 57.3%), ose mesatarisht 5.66 aktivitete; 32.7% e bashkive nuk kanë organizuar të tilla aktivitete. Treguesi është në të njëjtin nivel me vitin 2018.

105 Përfshihen bashkitë që kanë raportuar >0 shërbime për menaxhimin e rastit


106 Bashkia e Vau të Dejës, Krujës, Kavajës, Prrenjas, Pustec, Devoll, Himare dhe Gjirokastrë nuk kanë ofruar të dhëna

107 Bashkia e Durrësit dhe Vaut të Dejës nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin

Grafiku 92: Aktivitete të organizuara nga NJQV për promovimin e të drejtave gjinore



Grafiku 93: Aktivitete promovimi per barazine gjinore, 2017-19



### Problemet dhe sfidat

- Mbetet sfidë zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të nëpunësve vendorë dhe personelit të qendrave komunitare (strehëzave) dhe rritja e buxhetit vendor për ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e rasteve.
- Aplikimi i mekanizmave në nivel vendor në kuadër të harmonizimit të masave për të luftuar dhunën në familje duhet të jetë funksional në 100% të bashkive.
- Përdorimi i sistemit REV-ALB nga të gjitha bashkitë dhe raportimi i rregullt në MSHMS.
- Aktivitetet e promovimit të barazisë gjinore me mbështetje dhe koordinim me OSHC të realizohen nga të gjitha bashkitë.
- Zbatimi efektiv i masave të Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2016-2020 në nivel vendor, dhe rritja e vëmendjes të organeve të larta drejtuese të bashkive për të bashkënduar veprimet.

## Rekomandime

- Ekziston nevoja për iniciativa të mëtejshme në funksion të vetëdijësimit të publikut dhe të zbatimit të parimit të pavarësisë dhe konfidencialitetit në lidhje me të drejtat e personave lezbikë, homoseksual, biseksual, transgjinjor dhe interseks ose “hermafroditë” (LGBTI) si dhe të drejtat e personave me HIV/AIDS, pasi stigmatizimi i këtij komuniteti është i lartë dhe pranimi i tyre në shoqëri vazhdon të mbetet në nivele të ulëta.
- Rritja e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje përmes funksionimit të mirë të sistemit të referimit. Është e rëndësishme të sigurohet pjesëmarrja e krerëve të institucioneve vendore në takimet bashkiake për politikën e menaxhimit të dhunës në familje.
- Duhet të punojnë edhe me komunitetin, veçanërisht në zonat rurale duke rritur vetëdijësimin për rastet e dhunës në familje, pasi shumë raste të dhunës në zonat rurale në Njësitë Administrative nuk raportohen.
- Sigurimi i ndihmës për rastet e identifikuar të grave që janë viktime të dhunës në familje si e drejtë e tyre, sepse shumë bashki nuk e realizojnë këtë të drejtë.
- Rritja e numrit të bashkive që caktojnë buxhet të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe e bashkive që kanë një buxhet/PBA me ndjeshmëri gjinore.
- Përmirësimi i raportimit dhe bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Organizimi i fushatave vetëdijësuese (në zonat urbane dhe rurale) për mbrojtjen nga çdo formë diskriminimi, për çështje të barazisë gjinore, për mbrojtjen e komuniteteve romë dhe egjiptiane, si dhe për njohjen e të drejtave të minoriteteve dhe të drejtave të njeriut.
- Krijimi i shërbimeve fleksibile dhe lehtësisht të arritshme për komunitetet romë dhe egjiptiane për të ndërtuar një sistem besimi dhe sigurie për integrimin e tyre në shoqëri (të kenë akses pa pengesa në shërbimet sociale, në shërbimin shëndetësor, të nxitet arsimiti i të rinjve romë dhe egjiptianë dhe të sigurohet dhe të mbështetet punësimi dhe promovimi i modeleve pozitive).

*Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara”*


- Në vitin 2019, aktivitete ndërgjegjësimi dhe trajnime mbi standartet e aksesueshmërisë nga personat me aftësi ndryshe (PAK) janë realizuar 221 ose mesatarisht 4.02 (N=55).
- Sektori për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit është ngritur nga 39.34% e bashkive (N=60), duke mbetur në të njëjtin nivel me vitin 2018, por +23.34 p.p. krahasuar me vitin 2017.
- Plani Vendor për Përfshirjen Sociale të Personave me Aftësi Ndryshe dhe planifikimi i tij në PBA është kryer nga 54.09% e bashkive (N=60), ose +11.48 p.p. më i lartë më krahasim me 2018. Bashkitë që raportojnë mbi miratimin e Planit Vendor në 2019 janë Bashkia Kukës, Vau i Dejës, Delvinë dhe Pukë, ndërsa Bashkitë e Malësisë së Madhe, Vorë, Gjirokastër dhe Konispol kanë raportuar pozitivisht në 2018 por raportojnë “Jo” në 2019.
  - Në 2019, bashkitë kanë hartuar dhe dërguar gjithsej 115 raporte 6-mujore për çështjet e personave me aftësi ndryshe në MSHMB (N=52), ose mesatarisht 2 raporte në vit<sup>108</sup>.
  - Mesatarja e rritjes së alokimit të fondit buxhetor vendor për heqjen e pengesave mjedisore dhe përmirësimin e infrastrukturës në kopshte, shkolla dhe institucione publike me qëllim të përmirësimit të aksesueshmërisë nga PAK është raportuar me rritje +7.65% në raport me vitin 2018 (+2.3% në raport me 2017).
  - Mesatarisht 27% e shkollave të sistemit para-universitar kanë infrastrukturë të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe (N=58), ose -7 p.p. më e ulët në krahasim me 2018. Treguesi varion në një shkallë mjet të gjerë nga 100% në 1%; 28% e bashkive kanë raportuar zero përqind (14 bashki) dhe tre bashki nuk kanë ofruar të dhëna<sup>109</sup>.

108


Bashkia Durrës, Shijak, Pustec, Devoll, Selenicë, Himarë, Tepelenë dhe Delvinë nuk kanë ofruar të dhëna për indikatorin

109


Bashkia Himarë, Prrenjas dhe Devoll nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin





Harta 42: Aktivitete ndërgjegjësimi dhe trajnime mbi standartet e aksesueshmërisë




Grafiku 94: Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Ngritur



Grafiku 95: PV për Përfshirjen Sociale të personave me aftësi ndryshe




Grafiku 96: Progresi në hartimin e Planeve të Veprimit për përfshirjen sociale të personave me aftësi ndryshe







- Nëpunës vendorë të punësuar në strukturat e përkrahjes dhe mbrojtjes sociale për PAK kanë qenë 193 gjithsej, ose mesatarisht 3.33 për bashki (mesatarja 4 nëpunës në 2018); treguesi varion nga 13 (vlera max) në 1 (vlera minimale); Gjashtë bashki kanë raportuar zero nëpunës për PAK dhe tre bashki nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme.



Grafiku 100: Nëpunës vendor për çështje të përonave me aftësi ndryshe



Grafiku 101: Shkalla e rrjetit urban e aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe



- Rreth 23.4% është mesatarja e infrastrukturës rrugore e aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe në raport me gjatësinë e rrjetit urban në territorin e bashkisë (e shprehur në përqindje të km rrugë urbane<sup>110</sup> rreth 40.9% kanë raportuar zero përqind rrugë urbane të aksesueshme, ndërsa 11.5% e bashkive nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme. Bashkitë Roskovec dhe Vau i Dejës raportojnë se 100% e rrugëve urbane janë të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe.

### Problemet dhe sfidat

- Mungesë e burimeve të mjaftueshme njerëzore për të mbuluar nevojat e këtij grupi të synuar në nivelin vendor.
- Zyrat e punës kanë mungesë ekspertize të dedikuar dhe të profilizuar për të orientuar PAK, dhe numri i të punësuarve PAK është i ulët<sup>111</sup>.
- Mungesë e një databaze në nivel kombëtar me qëllim mbledhjen e të dhënave për PAK<sup>112</sup>.
- Mbetet sfida sigurimi i aksesueshmërisë së plotë nga PAK në shkolla, institucione publike dhe shërbimet, dhe i infrastruktures rrugore.

### Rekomandime

- Ngritja e strukturave të profilizuara dhe standartizimi i modeleve për “përshtatje të arsyeshme të vendit të punës në përputhje me nevojat dhe aftësitë për punë të PAK.
- Pavarësisht miratimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016 - 2020, rekomandohet përafrimi i legjislacionit të brendshëm me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, veçanërisht në lidhje me zotësinë juridike për realizimin e veprimeve ligjore. Gjithashtu, Ofruesit e Shërbimit të Mediave Audiovizive (kombëtare dhe vendore) duhet të bëjnë progres për sa i përket garantimit të përdorimit të gjuhës së shenjave për personat me aftësi të kufizuara të dëgjimit në përputhje me detyrimin e parashikuar në Ligjin Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në mënyrë që të lehtësohet akses i PAK (Personat me Aftësi të Kufizuara), si dhe i infrastrukturës shkollore që përmbush standardet për fëmijët me aftësi të kufizuara.


## PËRFUNDIME MBI GJYQËSORIN DHE TË DREJTAT THEMELORE

**Progres i lehtë evidentohet në krijimin e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në administratën vendore nga 91.8% e bashkive, ose 1.8 p.p. më i lartë se në vitin 2018; sistemi i monitorimit të rasteve nuk është funksional nga të gjitha bashkitë (mungon në 27.8% të tyre); takime të përbashkëta të grupeve ndërdisiplinore në nivel bashkie kanë qenë në nivel të krahasueshëm me vitin 2018, ose mesatarisht 11 takime për bashki. Numri i rasteve të identifikuara dhe të trajtuara për shkelje të të drejtave të fëmijëve ka qenë më i vogël, krahasuar me vitin 2018 - vlera mesatare 21.84 raste në 2019, krahasuar me 24 të raportuar në 2018. Fondi vendor në 2019 për rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve ka qenë në nivel të ngjashëm me vitin 2018 - mesatarisht 4% e alokimit të buxhetit për mbrojtjen sociale. Ndonëse numri i punonjësve për**

110 Treguesi është me zbritje -7.51% krahasuar me 2018;

111 Raport monitorimi, USAID dhe Fondacioni Shqiptar për Personat me Aftësi Ndryshe.

112 Raport monitorimi, USAID dhe Fondacioni Shqiptar për Personat me Aftësi Ndryshe



Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) është miratuar 235 në të gjithë vendin, burime njerëzore për këtë funksion në nivel vendor janë 159 (ose 67.7%).

**Në funksion të zbatimit efektiv të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”**, dhe akteve nënligjore më pak nepunës vendorë të trajnuar në 2019 krahasuar me vitin 2018 – gjithsej 150 persona; 36% e bashkive nuk kanë ndjekur trajnime mbi ligjin kundër diskriminimit. Sistemi i monitorimit të rasteve në nivel vendor në zbatim të ligjit ka shënuar përmirësim me +3.2 p.p. më i lartë krahasuar me vitin 2018; vetëm 14.75% e bashkive kanë organizuar fushata ndërgjegjësuese në shkolla dhe komunitete, pra më pak fushata në krahasim me 2018.

**Në funksion të zbatimit efektiv të Ligjit 96/2017 “Për Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike”**, sistemi i monitorimit për shkelje të të drejtave të pakicave është ngritur dhe është funksional në 19.6 % të bashkive në vitin 2019. Vetëm 44.3% e bashkive kanë organizuar 174 aktivitete kulturore dhe fushata ndërgjegjësimi për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike, pra më pak fushata ndërgjegjësimi në 2019, krahasuar me 2018 (-2.7 p.p.); rreth 8% e bashkive kanë siguruar ofrimin e shërbimeve publike në dy gjuhë.

**Progres është bërë për integrimin e pakicave rome dhe egjiptianë në nivel vendor** – më pak nepunës vendorë të trajnuar në 2019 krahasuar me vitin 2018, për zbatimin e masave të Planit Kombëtar (PKIRE) nga 23% e bashkive, ose -3.27p.p. më pak; rreth 34% e bashkive kanë hartuar plane vendore për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane - treguesi ka rritje me +3.2 p.p. në krahasim me 2018; 824 individë nga pakicat rome dhe egjiptiane kanë përfituar nga programi i strehimit social; më shumë projekte në mbështetje të komunitetit R/E janë realizuar nga organizata të SHC në partneritet me shërbimet e bashkive (49% e bashkive). Mbetet sfida integrimi i ketyre pakicave nëpërmjet formimit profesional dhe integrimi i tyre në tregun e punës; 427 persona nga komunitetet rome dhe egjiptiane të punësuar në 2019, nga të cilët rreth 50% nga shërbimet e bashkisë.

**Verësimi i treguesve për barazinë gjinore evidenton përmirësim në disa masa dhe ulje në disa të tjera në 2019, krahasuar me vitin 2018:** Aplikimi i mekanizmave në kuadër të harmonizimit të masave për të luftuar dhunën në familje është funksional në 85% të bashkive, duke evidentuar përmirësim me +2 p.p., krahasuar me vitin 2018; rreth 230 shërbime të raportuara për menaxhimin e rastit. Progres është bërë lidhur me buxhetimin gjinor, rreth 31.15% e bashkive kanë përgatitur buxhetin vjetor bazuar në metodologjinë me ndjeshmëri gjinore, ose +6.16 p.p., krahasuar me vitin 2018. Tregues me rënie të lehtë janë strukturat (sektori për barazinë gjinore) i krijuar në 68.65% të bashkive, ose me -3.14 p.p. në krahasim me 2018, koordinator lokal për çështjet gjinore në 81.96%, ose -1.03 p.p. (2018); 172 nepunës vendor të trajnuar ose mesatarisht 3 persona (1 person më pak mesatarisht në 2019 krahasuar me 2018); më pak raportime në MSHMS nga bashkitë në 2019 në krahasim me 2018, rreth 59% e bashkive kanë raportuar rregullisht. Bashkëpunimi me shoqërinë civile për organizimin e aktiviteteve kundër diskriminimit gjinor është realizuar nga 54% e bashkive (+2.46 p.p. më i lartë në krahasim me vitin 2018). Mbetet sfida zhvillimi i kapaciteteve të nepunësve vendorë, aplikimi i buxhetimit gjinor horizontalisht në të gjitha bashkitë dhe menaxhimi i rastit nga shërbimi social në bashki në bashkëpunim me profesionistë të fushës.

**Progres të moderuar ka patur në sigurimin e zbatimit efektiv të Ligjit 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi ndryshe”.** Ngritja e strukturave për PAK ose Sektorin për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit në administratën vendore është ngritur nga 39.34% e bashkive, ose +3.34 p.p. më i lartë, krahasuar me vitin 2018; 193 nepunës vendorë të caktuar për çështjet e PAK, ose mesatarisht 3.33 për bashki (-0.67 më pak se në 2018); rreth 54% e bashkive kanë hartuar dhe miratuar planin vendor për përfshirjen sociale të personave me aftësi, ose +11.48 p.p. më i lartë në krahasim me 2018. Fondi vendor për çështje të PAK është rritur në 2019 (mesatarisht +7.65% të fondit të planifikuar për sektorin e mbrojtjes sociale). Problem për integrimin e PAK është aksesueshmëria e kufizuar në shkolla (mesatarisht



27% e shkollave të sistemit para-universitar janë të aksesueshme), 29.48% e institucioneve që ofrojnë shërbime publike, 23.4% mesatarisht e infrastrukturës rrugore urbane. Mbeten sfida zhvillimi i një databaze në nivel kombëtar për grumbullimin e të dhënave për PAK, rritja e nivelit të aksesueshmërisë në shkolla, institucione publike dhe shërbime të ndryshme, përmirësimi i infrastrukturës rrugore, si dhe standartizimi i modeleve për “përshtatje të arsyeshme” të vendit të punës në përputhje me nevojat dhe aftësitë për punë të PAK me qëllim rritjen e punësimit të tyre.

### 3.9 Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

Lufta kundër krimit të organizuar është një nga objektivat e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017-2020 në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë.

*Objektivi specifik: Avancimi i luftës kundër krimit të organizuar*



- Grupi i punës për zbatimin e Planit të Veprimit për luftën kundër krimit të organizuar në nivel vendor është krijuar në rreth 41% të bashkive; treguesi është në nivel të ngjashëm me 2018. Bashkitë e Memaliaj, Gramsh, Korçë, Devoll dhe Pustec raportojnë ngritjen e grupit të punës gjatë 2019, ndërsa Bashkitë Durrës, Malësi e Madhe, Tropojë Mat, Librazhd, Këlcyrë dhe Përmet kanë raportuar se në vitin 2018 e kishin ngritur grupin e punës, ndërsa në 2019 raportojnë negativisht për këtë tregues.

- Progres është bërë lidhur me hartimin e strategjisë për sigurinë publike në nivel vendor, 42.62% e bashkive kanë miratuar këtë dokument të politikave të sigurisë publike, ose +16.4 p.p. më shumë bashki, krahasuar me vitin 2018. Bashkitë Vau i Dejës, Pukë, Pogradec, Maliq, Pustec, Devoll, Roskovec dhe Vlorë




Grafiku 102: Grup pune për zbatimin e PV kundër krimit të organizuar

■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna




Grafiku 103: Strategji për Sigurinë Publike në nivel vendor

■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna




Grafiku 104: Hartimi i Strategjive të Sigurisë Publike



raportojnë se në 2019 kanë hartuar strategjinë vendore mbi sigurine publike.


- Progres është bërë nga bashkitë për ngritjen e Këshillave Komunitare (KK) gjatë 2019, 49.18% e bashkive kanë ngritur strukturën si një mekanizëm në luftën kundër krimit të organizuar, ose +18.03 p.p. më shumë krahasuar me 2018. Bashkitë Kukës, Vau i Dejës, Prrenjas, Pogradec, Konispol dhe Selenicë raportojnë mbi ngritjen për herë të parë të KK gjatë 2019. Megjithatë mund të thuhet që ende nuk janë bërë hapat e duhur që ngritja e KK të mundësohet në të gjithë bashkitë e vendit.

Grafiku 106: Ngritja e Këshillave Komunitarë ne luften kunder krimit te organizuar



Grafiku 105: Këshill Komunitar kundër krimit të organizuar

Po Jo Nuk ka të dhëna



### Problemet dhe sfidat

- Për disa bashki mbetet sfida krijimi i grupit të punës në luftën kundër krimit të organizuar dhe kultivimit e trafikimit të bimëve narkotike dhe hartimi i strategjisë për sigurinë publike në nivel vendor.
- Takime më të shpeshta me komunitetin dhe grupin e punës dhe Këshillat Komunitare të krijuara.
- Këshillat Komunitare të operojnë në mënyrë të organizuar dhe eficiente.

## Rekomandime

- Rritja e kapaciteteve të Këshillave Vendore të Sigurisë Publike për të funksionuar mirë dhe për të pasur një ndikim real në sigurinë e bashkisë duke përfshirë përfaqësues të institucioneve vendore që merren direkt me çështje të sigurisë dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, komunitetet fetare, komuniteti i biznesit, shkollat, etj.
- Vendosja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm midis të gjithë aktorëve vendorë, përfshirë shoqërinë civile, policinë, shërbimet sociale, etj., për të identifikuar sfidat e komunitetit vendor për sa i përket sigurisë personale dhe për të rritur sigurinë publike.
- Të ofrohet mbështetje me ekspertizë për të rritur aftësitë e anëtarët të Grupeve të Punës dhe KK si struktura vendore në luftën kundër krimit të organizuar.
- Rritja e nivelit të ekspertizës në këtë fushë brenda bashkisë.
- Identifikimi i faktorëve që mund të kenë një efekt ndikues në arritjet e pushtetit vendor në luftën kundër krimit.
- Bashkitë duhet të rrisin dhe forcojnë integritetin e administratës publike (transparenca dhe deklaratat e pasurive).
- Hartimi, zbatimimi dhe monitorimi i nismave ligjore për parandalimin dhe reduktimin e korrupsionit në të gjitha nivelet, si dhe rritja e vetëdijësimit se si të shmangen format e korrupsionit, dhe, nga ana tjetër, rritja e vetëdijësimit për shtimin e denoncimeve të veprimeve korruptive nga të gjithë.

### Kutia 10 : Praktika të mira në luftën kundër krimit të organizuar

**Bashkia Cërrik:** Funksionon grupi i punës në luftën kundër kundër kanabis.

**Bashkia Devoll:** Këshillit Vendor për Sigurinë Publike është një organ konsultues për çështje të sigurisë, që në bashkëpunim me policinë dhe institucione të tjera sigurie shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë në territorin e bashkisë.

**Bashkia Dibër:** Grupi i punës është ngritur dhe miratur Plani i Veprimit për Luftën Kundër Krimit të Organizuar me ndihmën dhe mbështetjen e OSHC-ve. Grupi i punës përbëhet nga përfaqësues të institucioneve lokale.

**Bashkia Elbasan:** Komisioni Vendor i Sigurisë Publike, i cili drejtohet nga Kryetari i Bashkisë, mbledhet periodikisht me aktorë të ndryshëm të sigurisë që operojnë në territorin e bashkisë.

**Bashkia Fushë-Arrëz:** Grupi i punës në bashkëpunim me policinë e shtetit ka marrë disa masa për ruajtjen e qetësisë publike dhe sensibilizimin e qytetarëve për luftën kundër krimit të organizuar; është miratur një plan masash për parandalimin e bimëve narkotike në të gjitha e Njësite administrative të bashkisë.

**Bashkia Këlcyrë:** Është ngritur grupi i punës për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabis sativa, dhe me vendim të KB është ngritur Komisioni Vendor i Sigurisë Publike, dhe miratur Plani për parandalimin e Azil kërkusve.

**Bashkia Kurbin:** Policia bashkiake ka një plan bashkëpunimi me Policinë e Shtetit për Luftën Kundër krimit të Organizuar.

**Bashkia Roskovec:** Në vitin 2017 është ngritur grupi multidisiplinar për luftën kundër kanabisit.

**Bashkia Shkodër:** Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi është ngritur dhe funksionon grupi i punës për luftën kundër krimit të organizuar.

**Bashkia Vlorë:** Grupi i punës është ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr.60 / 2018 me përbërje të gjerë, mbi 40 persona që përfshin Kryetarin e Bashkisë, Kryetarin e Këshillit të Bashkisë, Drejtorin e Policisë të Qarkut Vlorë, drejtues nga Prokuroria, drejtues të tjerë vendorë, nëpunës të administratës, përfaqësues nga shoqëria civile dhe media, komunitetet etnike, fetare; 3 takime për sigurinë publike janë zhvillura gjatë vitit 2019.

## PËRFUNDIME MBI DREJTËSINË LIRINË DHE SIGURINË

Në Deklaratën e Komisionit Evropian<sup>113</sup> i cili rekomandoi hapjen e negociatave me Shqipërinë, vlerësohet progresi në luftën kundër korrupsionit, kultivimit dhe trafikut të drogës dhe pastrimit të parave. Në 2019, progres është bërë në dy nga tre masat kryesore në luftën kundër krimit të organizuar në nivel vendor: Grupi i punës për zbatimin e Planit të Veprimit për luftën kundër krimit të organizuar në nivel vendor është krijuar në rreth 41% të bashkive, duke qëndruar në nivel të ngjashëm me 2018. Bashkitë e Memaliaj, Gramsh, Korçë, Devoll dhe Pustec raportojnë ngritjen e grupit të punës gjatë 2019, ndërsa shtatë bashki raportojnë negativisht për këtë tregues por në 2018 kanë raportuar pozitivisht për grupin e punës. Rreth 42.62 % të bashkive kanë hartuar dhe miratuar strategjinë për sigurinë publike në nivel vendor, ose +16.4 p.p. në krahasim me 2018.

Këshillat Komunitare (KK) janë krijuar nga 49.18% e bashkive ose +18.03 p.p. më shumë bashki, krahasuar me 2018, megjithatë mund të thuhet që ende nuk janë bërë hapat e duhur që ngritja e KK të mundësohet në të gjithë bashkitë e vendit.

### 3.10 Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura

Në 2019, janë miratuar ligje ose akte nën-ligjore në fushën e arsimit para-universitar që implikojnë NJQV me përgjigjësi dhe detyra: VKM Nr.666/2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriteve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”<sup>114</sup>; Udhëzim i MASR për normat mësimore<sup>115</sup>, dhe udhëzim<sup>116</sup> për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë punë i cili duhet të zbatohet dhe nga NJQV për emërimin e mësuesve, edukatorëve dhe drejtuesve të institucioneve të arsimit parashkollor dhe kopshteve që janë në varësi dhe administrim të plotë nga Bashkitë.

Në arsimin parashkollor, miratuar ligji nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” mbi fondet e pagave për edukatorët të cilat ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve: 60% e fondeve për pagat e edukatoreve mbi bazën e numrit të fëmijëve (me moshë 3-6 vjeç) dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve. Reforma siguron një ndarje më të përshtatshme të fondeve, duke u bazuar në numrin e fëmijëve që duhet t’u ofrohet edukimi parashkollor, por njëkohësisht siguron një tranzicion gradual që minimizon kostot, duke ruajtur 40% të sistemit aktual<sup>117</sup>.


113 Deklarata e KE për Shqipërinë, datë 2 Mars 2020

114 Burim: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Vendimi pritet të ketë impakt në 8,000 nxënës të arsimit parauniversitar dhe për herë të parë janë përfshirë nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, me ndikim në uljen e nivelit të “braktisjes shkollore”; këta fëmijë janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë; gjithashtu, është futur kriteri i rezultateve të arritura, për përfitimin e bursës të nxënësve që ndjekin arsimin profesional.


115 Udhëzim i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 13, datë 22.5.2019 “Për Normat Mësimore”

116 Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 13, datë 22.5.2019 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”

117 Burim: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë



Grafiku 107: Raporti mësues - nxënës




Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Objekti i specifik: rritja e pjesëmarrjes në klasa përgatitore për arsimin parashkollor

- Në vitin 2019, kanë funksionuar 1614 kopshte, ose mesatarisht 26.5 kopshte (N=61), pak më i ulët nga 2018 (1,693 kopshte ose mesatarisht 27 kopshte).


Grafiku 108: Numri i kopshteve sipas NJQV




- Kapaciteti akomodues në nivel kombëtar i kopshteve, ka qenë 57,507, ose mesatarisht 942.7 fëmijë.
- Është përmirësuar regjistrimi i fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç në arsimin parashkollor në nivel kombëtar, në vitin e raportimit ka qenë 75% (N = 55). Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve në partneritet me Zyrën e UNICEF-it Shqipëri dhe shërbimet e bashkive, ka punuar gjatë periudhës 2018-2019 për identifikimin, regjistrimin dhe krijimin e kushteve që fëmijët nga shtresat sociale në nevojë të regjistrohen dhe të ndjekin arsimin e detyrueshëm<sup>118</sup>.

118 Në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 7522 prot., datë 12.07.2018, ndërmjet Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Brendshme, si dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor"

Grafiku 86: Shkalla e rregjistrimit të fëmijëve të grup moshës 3-5 vjec, 2019




Grafiku 110: Shkalla e rregjistrimit të fëmijëve të grup moshës 3-5 vjec, 2019



Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar me përjashtim të shkollave profesionale, si dhe administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshtë dhe çerdhe<sup>119</sup>.

Grafiku 111: Fond vendor për ndërtimin /rindërtimin e kopshteve



119 Ligji 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 23

Rreth 49.2% e Bashkive kanë raportuar zero përqind fond nga buxheti vendor për rindërtimin e kopshteve ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja, përfshirë një bashki që nuk ka ofruar të dhëna të vlefshme; 50.8% e bashkive kanë raportuar alokim të fondit vendor më vlerë mesatare 6.73% të buxhetit vendor për 2019; Treguesi evidenton progres në krahasim me 2018 (mesatarja e fondit vendor ekuivalent me 2.9% e buxhetit vendor).

Në 2019, numri gjithsej i fëmijëve të rregjistruar në arsimin bazë që i përkasin grupeve të marxhinalizuara është raportuar rreth 19,917<sup>120</sup>.


**Objektivi specifik: rritja e pjesëmarrjes në institucionet e arsimit të detyrueshëm për fëmijët e grupeve të marxhinalizuara**

- Në 2019, numri i raportuar i fëmijëve të grup-moshës së arsimit të detyrueshëm që i përkasin grupeve të marxhinalizuara ishte 12,664 fëmijë, nga të cilët 6,688 (ose 52.8%) kanë ndjekur rregullisht shkollën<sup>121</sup>.
- Mesatarisht është alokuar rreth 1.62% e buxhetit vendor për sektorin e arsimit për rregjistrimin dhe frekuentimin e shkolles nga fëmijët që i përkasin grupeve të marxhinalizuara.
- Nuk ka të dhëna të vlefshme për treguesin “fëmijë braktisës të shkollës të grup moshës së arsimit baze që i përkasin grupeve të marxhinalizuar<sup>122</sup>”.


**Objektivi specifik: përmirësimi i infrastrukturës shkollore të arsimit parauniversitar**

- Fond vendor për përmirësimin e infrastrukturës shkollore për fëmijët me aftësi ndryshe është planifikuar nga 67.2% e bashkive; treguesi është në të njëjtin nivel me vitin 2018.

Grafiku 112: Parashikim i infrastrukturës për PAK në projektet për ndërtimin / rindërtimin e shkollave



Harta 51



Harta 52



120 Në vitin 2018, treguesi ka rezultuar 9984 fëmijë nga grupet e marxhinalizuara që frekuentuan arsimin e detyrueshëm për vitin shkollor 2018


121 Treguesi evidenton një vlerë mesatare prej 138 fëmijë që braktisin shkollën, e cila rezulton e lartë krahasuar me 2018 (mesatarisht 7 fëmijë).

122 Matrica e treguesve të performancës (ref. 3.26.2.4)


Harta 53



Grafiku 113: Përfaqësues të Bashkive në vendimarrjen e shkollave, 2019



Grafiku 114: Përfaqësues i bashkisë në vendimarrjen e shkollave




- Bashkitë kanë planifikuar më shumë fond nga buxheti vendor në vitin 2019 për rindërtimin e shkollave ekzistuese ose ndërtimin e shkollave të reja, mesatarisht 7.55% ose +4.07 p.p. më shumë se 2018 (N=58); Rreth 19.67 % e bashkive (N = 61) kanë raportuar zero fond ose nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin.

Objektivit specifik: Përmirësimi i procesit të vendimarrjes në shkollat e arsimit parauniversitar

- Përmirësim të lehtë ka përfaqësimi i nëpunësit të bashkisë në bordin e shkollës, 91.8% e bashkive kanë përfaqësim në borde, ose +1.64 p.p. më shumë, në krahasim me 2018<sup>123</sup>.

123

Nuk ka të dhëna të vlefshme për treguesin “nisma të bashkisë për të mbështetur ngritjen e komunikimit shkollë-prindër-qeveri”.





## Problemet dhe sfidat


- Investimet kapitale në kopshte dhe shkolla, projektet e paraqitura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë cilësi jo të mirë, vonesa në prokurim, dhe paraqiten kërkesa për të shtuar punime të paparashikuara.
- Shpallja me vonesë e procedurave të prokurimit nga NJQV, mbas miratimit të projektit dhe fondeve nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve dhe në pak raste mosshpallja e procedurës së prokurimit duke vonuar ose “djegur” fondet<sup>124125</sup>.
- Moszbatimi i grafikut të punimeve për objektet duke zbatuar kontratat nga autoriteti kontraktor nga njësitë e vetëqeverisjes vendoreose Kontraktorët e punimeve.
- Mosraportimi nga NJVV, sipas standardeve të përcaktuara në ligjin vjetor, apo në udhëzimet e ministrit përgjegjës për financat<sup>126</sup>.
- Moskryerja në kohë e pagesave për kontribut në financimin e projektit, në masën e përcaktuar të angazhimit nga NJVV, apo miratuar me vendim nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve.
- Shtimi i fondeve në bashkitë të cilat kanë një nevojë reale dhe të menjëhershme për shtimin e numrit të edukatoreve duke ulur madhësinë maksimale të grupeve nga 26 apo 23 fëmijë për një edukatore në 18 fëmijë për edukatore, një parakusht për përmirësimin e cilësisë së edukimit për fëmijët nga 3-6 vjeç që ndjekin kopshtet publike<sup>127</sup>.
- Ruajtja e nivelit aktual të fondeve për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht “të lartë” edukatorësh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera.
- Fonde shumë të pakta nga disa bashki për ndërtimin dhe rikonstrukcionin e ndërtesave të për kopshtet dhe shkollat e arsimit parauniversitar, prandaj sfidë mbetet rritja e fondit vendor.
- Burime financiare shtesë për krijimin e kushteve (infrastrukturës) shkollore për menca që do tu mundësonte fëmijëve të konsumonin një vakt në kushte të përshtatshme.
- Koordinim më i mirë institucional në nivel lokal dhe aplikimi efektiv i mekanizmave për të mundësuar përfundimin e arsimit bazë nga të gjithë fëmijët romë dhe egjiptianë.
- Rritja e kapaciteteve të administratës vendore për monitorimin dhe raportimin vjetor mbi përgjegjësitë dhe detyrat e NJQV në mirëadministrimin e kopshteve dhe shkollave ; bërja publike e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të bashkisë.

124 Burim: MASR, Bashkia Durrës, Prrenjas

125 Pezullimi nga Komisioni i Prokurimit Publik për disa procedura të Bashkia Prrenjas “Projekti Ndërtimi i Fushës së Sportit”, problematika me pronësinë pasi kanë filluar punimet në objekt.

126 Burim: MASR

127 Burim: MASR



## Rekomandime


- Marrjen në kohë të vendimeve të Këshillit Bashkiak me qëllim që nxënësit dhe familjarët të përfitojnë sipas VKM<sup>128</sup> “Për kuotat financiare të ushqimit në menca e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”.
- Përmirësimi i kopshteve dhe i aksesit në arsimin parashkollor në zonat rurale. Është e rëndësishme të sigurohet infrastruktura e nevojshme dhe aksesit në zona të thella pa arsim parashkollor, në mënyrë që të përmirësohen mundësitë e arsimimit të të gjithë fëmijëve brenda territorit të bashkisë.
- Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave duke planifikuar dhe akorduar më shumë buxhet për këtë qëllim.
- Hartimi i politikave për barazimin e mundësive arsimore për fëmijët që janë pjesë e grupeve vulnerabël.
- Krijimi i një sistemi arsimor të sigurimit të cilësisë (standardet, vlerësimi i brendshëm, etj.).
- Bashkitë duhet të ndërmarrin nisma për të rritur vetëdijësimin shoqëror në lidhje me rëndësinë e arsimit të hershëm përmes mjeteve të ndryshme të shpërndarjes.
- Gjetja e mekanizmave vendorë për të ndërtuar me sukses kanale komunikimi ndërmjet prindërve, mësuesve dhe bashkisë në mënyrë që të rriten njohuritë dhe vetëdijësimi për arsimin, si dhe ngritja e zërit për shqetësime të ndryshme.
- Zhvillimi i një sistemi vendor (veprime konkrete) për përfshirjen sociale të fëmijëve të pafavorizuar.
- Përmirësimi i sistemit të monitorimit për rastet e braktisjes së shkollës, pasi të dhënat zyrtare nuk korrespondojnë me situatën reale në shkolla.
- Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave, pajisja me laboratorët e mësimdhënies, arritja e standardit për numrin e fëmijëve në klasë, krijimi i shkollave miqësore për fëmijë, prindër dhe komunitet.
- Krijimi i qendrave rinore për të rinjtë, të cilët nuk kanë pothuajse asnjë ambient argëtimi në qytetet e vogla.
- Ndërtimi i bibliotekave/ose bërja funksionale e atyre ekzistuese, ndërtimi i fushave të sportit.

*Objektivi specifik: Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo-materiale, thesari kombëtar i gjenerimit të popullit shqiptar*

NJQV kanë përgjegjësi dhe detyra për zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve; organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave e të ambjenteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve; organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve<sup>129</sup>.

128 VKM Nr.666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave

129 Ligji 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 25 mbi Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese




- Rastet e shkeljeve dhe ndërtimeve të paligjshme në zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore janë raportuar nga 7 bashki (ose 11.47%), gjithsej 16 raste; numri i shkeljeve varion nga 6 në 1<sup>130</sup>; treguesi qëndron në të njëjtin nivel me vitin 2018.
- Në vitin 2019, trembëdhjetë (13) bashki<sup>131</sup> kanë ndërmarrë gjithsej 978 masa kundër shkeljeve dhe masa të tjera për ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore; numri i masave varion në një shkallë të gjerë nga 909 masa (Bashkia Tiranë), pasuar nga Bashkia Kuçovë (37), Bashkia Gramsh (9) dhe në vlera më të vogla, për Bashkinë Pogradec, Këlcyrë, Fier dhe Tropojë me 1 masë.
- Mesatarja e fondit të alokuar për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore ka qenë 1.22% e buxhetit vendor për 2019, ose -0.77 p.p. më e ulët krahasuar me 2018 (N=60); 1 bashki nuk ka ofruar të dhëna për treguesin<sup>132</sup>.

*Objektivi specifik: mbështetja e krijimtarisë dhe veprimtarisë krijuese të artistëve shqiptarë përmes forcimit të veprimtarisë kulturore dhe përfshirjes së artistëve*

- Në vitin 2019, gjithsej u planifikuan 793 aktivitete kulturore për promovimin e kulturës dhe traditës lokale si dhe në mbështetje të veprimtarisë krijuese të artistëve shqiptarë (N=60), por u realizuan më shumë aktivitete, gjithsej 807, ose mesatarisht 13 aktivitete për bashki (N=61). Treguesi varion në një shkallë të gjerë nga 138<sup>133</sup> në 1 aktivitet; Më shumë aktivitete kulturore u organizuan në 2019, krahasuar me vitin 2018.

Grafiku 115: Aktivitete kulturore të organizuara nga NJQV



- Mesatarisht, 11.38% e fondit për sektorin e trashëgimisë kulturore është përdorur në mbështetje të organizimit të aktiviteteve kulturore dhe krijimtarisë të artistëve gjatë vitit 2019 (N=58); Nuk mund të bëhet krahasim për trendin e treguesit sepse të dhënat e raportuara nga bashkitë për 2018 nuk kanë qenë të sakta

130 Bashkia Gramsh me 6 raste të shkeljeve, Bashkia Kucovë -2 raste, Bashkia Pogradec, Fier, Elbasan, Patos, Tropoje - 1 rast.

131 Bashkia Tiranë, Bashki Kucovë, Bashki Gramsh, Bashkia Korçë, Bashkia Peqin, Bashkia Elbasan, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Patos, Bashkia Pogradec, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Fier, Bashkia Tropojë

132 Bashkia Memaliaj


133 Bashkia e Tiranës

## Kutia 11 Aktivitetet Kulturore dhe Artistike – Bashkia Shkodër

Bashkia Shkodër ka mbështetur organizimin gjatë vitit 2019 të 60 aktiviteteve kulturore e artistike. Të tilla aktivitete janë Dita ndërkombëtare e Jazzit; “Kumarxhiu” - Komedi - Teatri Migjeni, “Zona e pritjes” - Tragjikomedi - Teatri “Migjeni”, Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë - Edicioni 56, Festivali letrar i Shkodrës - Biblioteka “Marin Barleti”, Teatër Kukullash “Tre derrkucët” etj.

Përveç aktivitete të buxhetuara nga Bashkia Shkodër, mbeshten teknikisht edhe aktivitete të tjera kulturore, artistike dhe rinore përmes institucioneve të saj të varësisë. Në vitin 2019 u mbështetën mbi 50 projekte, te individeve apo subjekteve të ndryshme, të cilat kanë patur në fokus promovimin dhe zhvillimin e këtij sektori.

Grafiku 116: Fond vendor për aktivitete kulturore në % të buxhetit për sektorin e kulturës e trashëgimisë kulturore



### Problemet dhe sfidat

- Banorët e disa zonave dhe qyteteve të mbrojtura gjenden midis nevojës për përmirësim të kushteve të banesave dhe kërkesave për ruajtjen e autenticitetit të trashëgimisë kulturore. Kosto e lartë e mirëmbajtjes së banesave.
- Kapacitete të kufizuara nga NJQV për ndjekjen e rasteve të shkeljeve.
- Mungesë të fondeve për të inspektuar si dhe për të ngritur një strukturë operative në Bashki.
- Parandalimi i ndërtimeve të paligjshme jo vetëm, në zonat e trashëgimisë kulturore.
- Burime të kufizuara financiare nga NJQV për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore përveç fondeve nga qeveria.
- Mungesa e bazës së të dhënave nga disa bashki për objektet e trashëgimisë kulturore në territorin e tyre.

## Kultura:

- Evidentimi më i detajuar sipas llojit të monumentit dhe objektit me vlera të trashëgimisë kulturore.
- Bashkitë duhet të hartojnë Strategjitë Kulturore Vendore që ofrojnë politika të nevojshme për mbështetjen dhe forcimin e strukturave përgjegjëse për menaxhimin e trashëgimisë kulturore, me qëllim zhvillimin, promovimin dhe konservimin e burimeve të trashëgimisë kulturore në nivelin vendor. Këto dokumente strategjike duhet të parashikohen në programet buxhetore afatmesme në mënyrë që të zbatohen në mënyrë të efektshme.
- Aplikimi i skemave financiare mbështetëse që të mundësojnë ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore që janë në pronësi të qytetarëve

## PËRFUNDIME PËR ARSIMIN DHE KULTUREN

**Është zhvilluar legjislacioni për sektorin e arsimit parauniversitar** me impakt në nxënësit që vijnë nga shtresat e marxhinalizura dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike<sup>134</sup>, për normat mësimore<sup>135</sup>, dhe për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit dhe drejtuesve të institucioneve të arsimit parashkollor dhe kopshteve. Është përmirësuar regjistrimi i fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç në arsimin parashkollor në nivel kombëtar, shkalla e rregjistrimit ka qenë 75% (N = 55).


Bashkitë kanë rritur alokimin e fondeve për rindërtimin e kopshteve ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja - mesatarisht u përdor 6.73% e buxhetit vendor në 2019 nga 50.8% e bashkive, ose +3.83 p.p. më i lartë se fondi i përdorur në 2018. Mesatarisht është alokuar rreth 1.62% e buxhetit vendor për sektorin e arsimit për rregjistrimin dhe frekuentimin e shkolles nga fëmijët që i përkasin grupeve të marxhinalizuara, ose 1.2 p.p. më shumë se në vitin 2018; treguesi për fondin vendor për përmirësimin e aksesueshmërisë në shkollat e fëmijëve më aftësi ndryshe ka mbetur në nivelin e vitit 2018; rreth 67.2% e bashkive parashikuan fond për përmirësimin e infrastrukturës shkollore për fëmijët me aftësi ndryshe në 2019; më shumë fond nga buxheti vendor është përdorur për rindërtimin e shkollave ekzistuese ose ndërtimin e shkollave të reja, mesatarisht 7.55% e buxhetit vendor, ose +4.07 p.p. më shumë se 2018 (N=58).

Mbetet sfidë rritja e fondit vendor për rindërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore dhe parashkollore, ulja e madhësisë së grupeve të fëmijëve në kopshte për një edukatore, rritja e numrit të edukatorëve, rritja e kapaciteteve të administratës vendore për përgatitjen e projekteve për infrastrukturën shkollore, si dhe kapacitetet e menaxhimit të prokurimit publik dhe zbatimin efektiv të projekteve dhe kontratave.

**Dokumentohet e njëjta performancë e bashkive lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mbështetje për krijimtarinë e artistëve** - 16 raste të shkeljeve në objekte më vlera të raportuara nga 6 bashki; 74% e bashkive kanë patur zero raste të shkeljeve në objekte më vlera të trashëgimisë kulturore;

134 Burim: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Vendimi pritet të ketë impakt në 8,000 nxënës të arsimit parauniversitar dhe për herë të parë janë përfshirë nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, me ndikim në uljen e nivelit të "braktisjes shkollore"; këta fëmijë janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë; gjithashtu, është futur kriteri i rezultateve të arritura, për përfitim të bursës të nxënësve që ndjekin arsimin profesional.

135 Udhëzim i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 13, datë 22.5.2019 "Për Normat Mësimore"



978 masa kundër shkeljeve dhe masa të tjera të ndërmarra nga 13 bashki për ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore; mesatarisht është alokuar 1.22% e buxhetit vendor për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, ose -0.77 p.p. më e ulët krahasuar me 2018 (N=60). Mbeten sfida rritja e fondit vendor për restaurimin e objekteve me vlera të veçanta përveç fondit të Qeverisë, rritja e kapaciteteve inspektuese të NJQV për të parandaluar shkeljet dhe ndërtimet e paligjshme.

### 3.11 Kapitulli 27: Mjedisit dhe ndryshimi i klimës


*Objektivi specifik: Rritja e ndërgjegjësimit dhe ngritja e kapaciteteve të qeverive vendore për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe menaxhimit të pyjeve*

Përgjegjësitë e NJQV në fushën e mbrojtjes së mjedisit lidhen më sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja, sigurimin e masave për mbrojtjen nga ndotja akustike, dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese mbi mbrojtjen e mjedisit në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Mjedisin 2018-2030.


*“Bashkimi Evropian promovon masat e forta klimatike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Ligji i BE-së përmban dispozita që adresojnë ndryshimin e klimës, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e integruar të mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndotjen nga mbetjet industriale, kimikatet, ndotjen akustike dhe mbrojtjen civile.*

Shqipëria tregon njëfarë niveli të përgatitjes në këtë fushë. Progres i kufizuar është evidentuar në përafrimin e politikave dhe legjislacionit me *acquis*, në fushën e administrimit të ujërave, dhe përpjekje të konsiderueshme nevojiten në zbatimin e masave që lidhen me direktivat kryesore të ujit, përsheptimin e zhvillimit të kapaciteteve të agjencive kombëtare për menaxhimin e burimeve ujore dhe për furnizimin me ujë, kanalizimeve dhe infrastrukturës së mbeturinave; të marrë masa të menjëhershme për të rishikuar dhe përmirësuar vlerësimet mjedisore dhe strategjike të ndikimit në projekte, plane dhe programe ekzistuese dhe të planifikuara, veçanërisht në sektorët e hidrocentraleve, ndërtimeve, turizmit dhe minierave; të fillojë zbatimin e Marrëveshjes së Parisit duke miratuar një strategji dhe legjislacion kombëtar për ndryshimin e klimës”<sup>136</sup>.

- Në 2019, gjithsej janë trajnuar gjithsej 88 nëpunës vendorë mbi legjislacionin dhe zbatimin e masave të politikave qendrore në fushën e mjedisit, ose mesatarisht 1.47 (N=60); treguesi evidenton më pak trajnime të kryera (19 nëpunës më pak krahasuar me vitin 2018).
- Bashki pjesëmarrëse në trajnime kanë qene 47 (ose 77%), një bashki më shumë krahasuar me 2018 (46).




Grafiku 117: Nëpunës vendor të trajnuar mbi legjislacionin e mjedisit




- Bashkitë kanë organizuar më shumë fushata ndërgjegjësimi në mbrojtje të mjedisit dhe minimizimin e ndotjes në bashkëveprim më aktorë të tjerë vendorë dhe OSHC, në 2019: gjithsej 332 fushata, mesatarisht 5.93 (N=56), ose 91 fushata më shumë të realizuara në vitin 2018.

Grafiku 118: Fushata ndërgjegjësimi për publikun e gjerë për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes organizuar nga Bashkitë



Grafiku 119: Fushata ndërgjegjësimi për ruajtjen e mjedisit



*Objektivi specifik: Edukimi i gjeneratave të reja për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes*

Në 2019, nga bashkitë janë organizuar 282 fushata ndërgjegjësimi për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes me shkollat e mesme dhe 9-vjeçare, në bashkëveprim me institucione të tjera dhe aktorë vendorë, përfshirë organizata të shoqërisë civile; me shumë fushata të kryera +91, në krahasim me 2018; mesatarisht 4.95 fushata (N=57) në 2019. Trendi është në rritje, në 2018 (mesatarisht 4 fushata), në 2017 (3 fushata). Numrin më të madh të aktiviteteve e kanë realizuar Bashkitë Përmet (16), Bashkia Tropojë (15) dhe Bashkia Finiq (15). Ndërsa gjashtë bashki: Klos, Kavajë, Dropull, Devoll, Has dhe Kamëz nuk raportojnë asnjë fushatë të realizuar.


*Objektivi specifik: hartimi i planit të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit mjedisor në nivel lokal*

- Bashkitë duhet të hartojnë planet vendore në zbatim të politikave qendrore. Në 2019, rreth 19.67% e bashkive kanë hartuar plan vendor për përmirësimin e cilësisë së ajrit<sup>137</sup>. Bashkitë Shkodër dhe Pustec raportojnë për hartimin e planit vendor gjatë 2019, ndërsa Bashkitë Dibër, Librazhd, Ura Vajguore dhe Patos raportojnë negativisht por në vitin 2018 kanë raportuar që e kanë miratuar PV mbi përmirësimin e cilësisë së ajrit në territorin e bashkisë.
- Pothuajse të gjitha bashkitë të cilat kanë hartuar planin vendor për përmirësimin e cilësisë së ajrit, kanë bërë planifikimin e masave në PBA (13 bashki); treguesi evidenton një ulje me -6.6 p.p.<sup>138</sup> krahasuar me 2018, por përmirësim me +1.3 p.p. në krahasim me vitin 2017.


137 Në 2018, kanë raportuar 15 bashki mbi planin vendor për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Mungesa e të dhënave nga 5 bashki mund të jetë arsye e mungesës së koherencës në të dhënat e treguesit.

138 Mund të ketë një pasaktësi në vlerën e treguesit meqenë 8 bashki nuk kanë ofruar të dhëna

Harta 54



Harta 55: Fushata ndërgjegjësimi për ruajtjen e mjedisit në shkolla







## Problemet dhe sfidat

- Hartimi i planeve vendore për cilësinë e ajrit nuk është në prioritetet dhe vëmendjen e organeve vendimarrëse të bashkive.
- Kapacitete njerëzore dhe burime financiare të vogla për zhvillimin e planit vendor për cilësinë e ajrit dhe organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit të qytetarëve.
- Forcimi i kapaciteteve teknike dhe profesionale të administratës vendore për marrjen e njohurive në fusha specifike të mbrojtjes të mjedisit dhe trajnime të lidhura me zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimaterike.

Harta 56 PV për përmirësimin e cilësisë së ajrit



Harta 57: Integrimi i masave për cilësinë e ajrit ne PBA



## Rekomandime

- Rritja e numrit të nëpunësve vendorë që kanë si funksion mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, në disa bashki.
- Rritja e fondit specifik për trajnime nga buxheti vendor për trajnimin e punonjësve të bashkisë në fushën e mjedisit dhe standarteve evropiane.
- Edukimi qytetar, edukimi i të rinjve në shkolla dhe rritja e bashkëveprimit më aktorë të tjerë në nivel vendor dhe organizatat e shoqërisë civile.


*Objektivi specifik: Përmirësimi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve*

“Kuatru ligjor për mjedisin dhe mbrojtjen e tij është pjesërisht i përafëruar (acquis). Përpjekje duhet të bëhen për mbylljen e 199 fushave të depozitimit të mbetjeve që nuk plotësojnë standartet; të fillojë grumbullimi i diferencuar i mbetjeve sipas rrymave, të rritet riciklimi dhe ripërdorimi, dhe të fillojë kompostimi i mbetjeve bio. Vetëm 65% e mbetjeve mbledhet në vend dhe nuk ka riciklim të mbetjeve nga prishjet (demolition). Instrumentet ekonomike për të promovuar riciklimin dhe parandalimin e gjenerimit të mbetjeve mbeten të kufizuara. Ndërtimi i inceneratorit në Elbasan dhe fillimi i procedurave për ndërtimin e dy inceneratorëve të tjerë në Tiranë dhe Fier paraqesin shqetësime për sa i përket pajtueshmërisë me Direktivat e BE-së për Mbetjet; parimi i hierarkisë së mbetjeve me djegie është opsioni më pak i preferuar për menaxhimin e mbetjeve, dhe me objektivat e BE-së për riciklimin<sup>139</sup>”.

- Rreth 46% e bashkive (ose 26 bashki<sup>140</sup>) kanë hartuar planin vendor për menaxhimin e mbetjeve (PVMIM)<sup>141</sup>.

Harta 58: PV per MIM i hartuar

Harta 59: Mbetjet riciklohen sipas PVMIM




- 65.6% e bashkive kanë raportuar se mbledhja e mbetjeve dhe depozitimi i tyre në landfield dhe fushat e depozitimit të miratuara është kryer sipas sipas planit vendor të menaxhimit të mbetjeve. Bashkitë e Devollit , Rogozhinës dhe Vaut të Dejës, paraqesin një situatë në rënie krahasuar me vitin 2018, pasi ne vitin 2019 raportojnë që mbledhja e depozitimi i mbetjeve nuk bëhet sipas planit vendor të miratuar.

139 Raport Progresi për Shqipërinë nga KE (2019), Kapitulli 27


140 Nga të dhënat e raportuar nga bashkitë, 25 janë plane vendore të miratuara, nga burime të tjera rezultojnë të jenë 26 bashki; mungesa e të dhënave nga 4 bashki, mund të jetë burim i mungesë së koherencës në shifrën.

141 Treguesi rezulton të jetë – 6 p.p. më i ulët se shifra e raportuar në 2018.




- Mbetjet e riciklueshme depozitohen sipas objektivave të planit vendor për menaxhimin e mbetjeve (PVMIM) nga 16.39% e bashkive në 2019, ose +8 p.p., krahasuar me vitin 2018.
- Në 2019, janë raportuar 140 vend-depozitime të paautorizuara nga 17 bashki (ose 27.8% e bashkive); bashkitë e tjera (72%) kanë raportuar zero vend-depozitime të pa-autorizuara.

Grafiku 124: Vend-depozitime të mbetjeve të paautorizuara sipas NJQV



- 58 vend-depozitime të autorizuara janë përdorur nga bashkitë për depozitimin e mbetjeve në 2019<sup>142</sup>.

Grafiku 125: Vend-depozitime të autorizuara



- Mbetjet ndahen në burim në 2 kosha sipas legjislacionit vetëm nga tre bashki (ose 4.9 % e bashkive), në krahasim nga 2 bashki të raportuara për 2018, përkatësisht nga Bashkia Krujë, Kamëz dhe Libohovë.
- Largësia mesatare e qendrës së Bashkisë nga vend-depozimi i miratuar është 17.97 km; treguesi është në të njëjtin nivel me vitin 2018.


142 Burim: Matrica e treguesve të Bashkive në procesin e integrimit evropian (2018), raportuar 71 vend-depozitime

Harta 60




Grafiku 126: Mbetjet ndahen në burim

■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna



Grafiku 127: Largësia maksimale e qëndrës së bashkisë nga vend-depozitimi më i afërt



## Problemet dhe sfidat

- Mungesë e kapaciteteve institucionale të qeverisjes vendore për zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve, grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bashkiake dhe depozitimin në vende të miratuara dhe që përmbushin standartet.
- Mbyllja e të gjitha vend-depozitimeve që nuk përmbushin standartet.
- Rritja e tarifës nga NJQV për të mundësuar një shërbim kundrejt standarteve.
- Monitorimi i vazhdueshëm nga Bashkia e shërbimeve të kompanive private të cilat janë kontraktuar për ofrimin e shërbimit të grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve.

## Rekomandime

- Monitorimi i zbatimit të masave të PVMIM dhe parashikimi i tij në PBA.
- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe komunitetit në përgjithësi dhe edukimi qytetar që në moshe të vogël nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit në bashkëveprim me organizata të shoqërisë civile.
- Hartimi i planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve nga të gjitha NJQV.
- Përdorimi më i mirë i fondeve për administrimin e integruar të mbetjeve urbane, pasi organet e qeverisjes vendore vazhdojnë të përballen me fonde të pamjaftueshme dhe në disa raste janë identifikuar disa shkelje duke shkaktuar ndotje të konsiderueshme të hapësirës publike, veçanërisht në shtretërit e lumenjve.


*Objektivi specifik: Forcimi i zbatimit të vendimit për ngritjen e task forcës për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare*

Njësitë e Qeverisjes Vendorë kanë detyra që rrjedhin nga Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendorë”, ligji 9774/2007 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis”, dhe detyrime në zbatim të planit kombëtar të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Mjedisin 2018-2030:


- Bashkitë janë pjesë e task forcës për ndotjen akustike dhe caktojnë personel të tyre si pjesë e saj; gjithsej, janë raportuar 114 nëpunës vendorë si pjesë e task forcës, ose mesatarisht 2 (N=57).

Treguesi evidenton rritje të numrit të inspektorëve për ndotjen akustike, (+22 persona) më shumë në 2019, krahasuar me vitin 2018.

Grafiku 128: Inspektorë të policisë bashkiake në task forcën për ndotjen akustike, 2019



Grafiku 129: Numri i Inspektorëve të policisë bashkiake përfaqësues në task forcën e ngritur për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike



- Nëpunës vendorë dhe inspektorë, të trajnuar për ndotjen akustike, legjislaionin dhe masat e zbatimit të detyrimeve rrjedhëse kanë qenë 20 në vitin 2019, ose 13 nëpunës vendorë më shume, krahasuar me vitin 2018.
- Pak bashki kanë raportuar që kanë ndjekur e trajnime<sup>143</sup> për ndotjen akustike ne 2019, rreth 14.7% e tyre.

#### Problemet dhe sfidat

- Caktimi i inspektorëve për ndotjen akustike nga të gjitha bashkitë.
- Rritja e pjesëmarrjes në trajnime të nëpunësve vendorë për ndotjen akustike.
- Paisja e inspektorëve me mjetet e nevojshme për zbatimin efektiv të ligjit për ndotjen akustike dhe marrja e sanksioneve për individët dhe subjektet që shkelin normat e lejuara.

*Objektivi specifik: Integrimi i rreziqeve të ndryshimeve klimatike në planet vendore në përputhje me përparësitë dhe objektivat kombëtare.*

- Në përputhje me prioritetet dhe masat kombëtare për zbutjen e rreziqeve të ndryshimit të klimës, kërkohet që bashkitë, me risk më të madh, të hartojnë dhe përditësojnë planin vendor të masave për zbutjen e rreziqeve; rreth 13% e bashkive kanë plan vendor të masave; treguesi është në të njëjtin nivel me vitin 2018.

*Qëllimi specifik: Rritja e aftësisë për t'u përshtatur me efektet sfiduese të ndryshimit të klimës në nivelin lokal*


- Në zbatim të detyrimeve kombëtare që rrjedhin nga nënshkrimi i Konventës Ndërkombëtare për ndryshimet klimaterike, në nivel vendor, vetëm 7% e bashkive kanë raportuar mbi mbledhjen dhe regjistrimin e të dhënave mbi klimën, emetimet e CO<sub>2</sub>, dhe raportimin e tyre në institucionet qendrore; treguesi është në të njëjtin nivel më vitin 2018. Duhet theksuar që Bashkitë Tiranë, Kukës dhe Maliq të cilat në vitin 2018 kanë raportuar që grumbullojnë të dhënat lidhur me ndryshimet klimatike, për vitin 2019 kanë raportuar që nuk i mbledhin më këto të dhëna.
- Zhvillimi i kapaciteteve të nëpunëve të bashkisë në zbatim të masave të politikave kombëtare për ndryshimet klimatike është i kufizuar, gjithsej 19 nëpunës janë trajnuar nga 13 Bashki. Treguesi

143 Bashkia Kavajë, Vlorë, Pogradec, Prrenjas, Devoll, Pustec, Memaliaj, Kolonjë, Kamëz

është në nivel të krahasueshëm me vitin 2018, por më pak bashki kanë marrë pjesë në trajnime në 2019, krahasuar me 2018 (- 8 p.p. më i ulët).

- Të dhënat në lidhje me fonde nga buxheti vendor të alokuar për projekte miqësore ndaj ambientit dhe ndryshimeve klimaterike janë të pakta dhe nuk mund të përgjithësohen në nivel kombëtar; Vetëm 4 bashki kanë raportuar për këtë tregues: Bashkia Krujë, Bashkia Shkodër, Bashkia Sarandë dhe Bashkia Maliq.


Harta 61: Hartimi PV për ndryshimet klimatike



Harta 62 Mledhja dhe rregjistrimi i të dhënave nga NJQV mbi ndryshimet klimaterike




Grafiku 130:



■ Po ■ Jo ■ Nuk ka të dhëna

Grafiku 131:






### **Kutia 12: Masat e ndërmarra nga Bashkia e Tiranës për përmirësimin e impaktit të ndryshimeve klimatike**

Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e impaktit të ndryshimeve klimatike, uljen e ndotjes në mjedis dhe tranzicionin drejt energjisë së qëndrueshme. Fokusi ka qënë në:

- **Planifikim të qëndrueshëm dhe përmirësim i monitorimit:** Në 2019 me mbështetjen e GIZ nisi hartimi i Planit të Qëndrueshëm të Lëvizshmërisë Urbane i cili përqendrohet në planifikimin e masave dhe investimeve që përmirësimin e cilësisë dhe teknologjisë së transportit publik dhe uljen e përdorimit të makinave private, rritjen e përdorimit të çiklizmit, promovimin e ecjes duke siguruar që shërbimet esenciale të jenë sa më pranë qendrave të banimit për të patur sa më pak nevojë në përdorimin e makinës, etj. Në bashkëpunim me Vodafone Albania, janë instaluar 4 pika monitoruese “IoT Smart Air Quality Meters” nëpër qytet të dhënat e të cilave janë të aksesueshme për publikun nëpërmjet aplikacionit “Tirana lme”.
- **Politika nxitëse dhe nisma bashkëpunimi me komunitetin:** (i) Nisur nga v.2017 subjektet private dhe juridike me taksi ekologjike (elektrike apo hibride) e marrin licencën e tyre brenda 24 orësh. Në 2019 numëroheshin mbi 40 subjekte (kompani apo person juridik) të regjistruara me taksi elektrike. Gjithashtu u është bërë thirrje dhe kompanive e institucioneve të ndryshme për të ndryshuar flotat e tyre të automjeteve. Thirrjes ju bashkua Posta Shqiptare me 12 taksi ekologjike gjatë v.2019 si dhe Coca Cola Albania i dhuroi bashkisë një mjet ekologjik në funksion të pastrimit dhe mirëmbajtjes së Parkut të Liqenit. (ii) Në v.2019 u miratuan rreth 27 Projekte si pjesë e nismës “Fondi i Komunitetit” (50% financim nga Bashkia dhe 50% nga komuniteti) që synon përmirësimin e efikasitetit të energjisë nëpër pallatet rezidenciale duke investuar në termoizolim të tyre. Në zonën e Pyllit Orbital në territore/kufij të pronarëve privatë të cilët nuk mund të ndërtojnë në atë zonë, Bashkia e Tiranës u ofron mundësinë pronarëve të përfitojnë nga projekti duke u dhënë mundësinë të zgjedhin llojin e pemëve frutore apo ullishte të cilat do mbillen tek toka e tyre duke ju mundësuar përfitime ekonomike.
- **Investime dhe bashkëpunime me donatorë:** Në 2019 Bashkia e Tiranës numëronte 10 Pika rimbushje elektrike publike përveç atyre të vendosura nga kompanitë private. Në 2019 Bashkia nënshkroi marrëveshje me BERZH për financimin e pjesës më të madhe të Pyllit Orbital duke financuar jo vetëm një pjesë të madhe të mbjelljeve por gjithashtu dhe studimin për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik-social të zonës. Pylli Orbital konsiderohet si një nga projektet më ambicioze të Bashkisë Tiranë pro klimës pasi hyn në kategorinë e Nature Based Solutions, duke ulur rrezikun e përmytjeve dhe erozionit, krijuar mikroklima të favorshme për uljen e temperaturave në qytet, përmirësimin e cilësisë së ajërimit dhe uljen e gazërave serë, reduktimin e ndotjes akustike por edhe përmirësimin e shëndetit mendor të qytetarëve si pasojë e rritjes së numrit të parqeve dhe hapësirave të gjelbra Brenda dhe jashtë qytetit. Projekti parashikon mbjelljen e 2 milion peme në gjurmët e pyllit orbital.

*Objektivi specifik: Pyllëzimi i zonave të degraduara përmes riciklimit të destinacionit të burimeve pyjore dhe eliminimi i borxheve të subjekteve që veprojnë në fondin pyjor*


Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë detyra që lidhen me administrimin e fondit pyjor vendor (nivel planifikimi), të tilla si hartimi i strategjive, planin e menaxhimit për fondin pyjor, programin e zhvillimit të sektorit dhe planin e mbarështimit të pyjeve vendore.





- Rreth 47.5% e bashkive kanë hartuar planin për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullësor, i cili integron dhe masat e mbarështimit të pyjeve, kullotave dhe bimëve mjekësore; treguesi evidenton rënie të performancës ose pasaktësi në raportimin e të dhënave në vitin 2018 (-11.4 p.p. më i ulët treguesi, krahasuar me 2018). Bashkitë Malësi e Madhe, Korçë, Lezhë, Dibër kanë raportuar pozitivisht për PV në 2018, ndërsa raportojnë për mungesë të planit për 2019; Bashkia Gjirokastrë, Shijak, Memaliaj dhe Kavajë raportojnë për hartimin e planit gjatë 2019.

Grafiku 132: PV mbi menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor




Harta 63




- Numri i përgjithshëm i specialistëve vendorë për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave ka qenë 426 gjithsej në 2019, ose mesatarisht 7 punonjës. Në vitin 2018 rreth 74% e bashkive nuk kane ofruar të dhëna të vlefshme, si rrjedhim nuk mund të bëhet një krahasim i besueshëm me vitin e mëparshëm të raportimit. Siç shihet nga grafiku Bashkia Tirane (34) dhe Bashkia Tropojë (31) kanë edhe numrin më të madh të specialistëve të punësuar ndërsa bashkitë Vorë, Devoll, Roskovec dhe Shijak raportojnë se nuk kanë asnjë specialist të punësuar për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave.

Grafiku 106: Shkalla e punësimit të specialistëve të fondit pyjor sipas legjislacionit




- Ndërmjet detyrave dhe përgjegjësi të NJQV që lidhen me ushtrimin e funksionit të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave është krijimi i databazës mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari dhe krijimi i kadastrës së fondit pyjor dhe kulllosor. Në 2019, 39 bashki (ose 64%) kanë ngritur databazën. Treguesi tregon rënie me 3 p.p., krahasuar me 2018, ose mund të ketë një pasaktësi në raportim nga Bashkitë Delvinë, Konispol, Himarë, Polican, Mirditë, Malësia Madhe dhe Ura Vajgurore të cilat në vitin 2018 kanë raportuar për krijimin e databasës.

Harta 64



Grafiku 134: Databazë i ngritur për subjektet që ushtrojnë aktivitet mbi fondin pyjor dhe kulllosor



### Kutia 13 : Prioritete të NJQV për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave

**Bashkia Divjakë:** Ndërgjegjësimi i qytetarëve për ruajtjen e pyjeve.

**Bashkia Durrës:** Hartimi i Planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për NJA Ishëm, Manëz, Katund i Ri, Currila, dhe hartimi i Planit Vjetor për mbrojtjen e fondit pyjor dhe kulllosor, si dhe vleresimet sasiore e cilësore të prodhimeve të dyta pyjore e jo pyjore për një menaxhim të qëndrueshëm të tyre.

**Bashkia Elbasan:** Rritja e performancës në mbrojtjes të fondit pyjor.

**Bashkia Fier:** Hartimi i Planit të Veprimi 2020 -2025

**Bashkia Kavajë:** Plan vendor për mbarështimin e fondit pyjor dhe kulllosor.

**Bashkia Mallakastër, Mirditë:** hartimi i Plan Veprimi (PV) vendor për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kulllosor.

**Bashkia Shkodër:** Plotësimi i strukturës së Administrimit të Fondit Pyjor dhe Kulllosor me numrin e specialistëve sipas dispozitës ligjore.

## Problemet dhe sfidat


- Ka mungesë ligjore: rekomandohet miratimi i VKM, në zbatim të nenit 41/1 e Ligjit nr.9385/2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar dhe udhëzimet për mënyrën e hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve dhe për caktimin e rregullave për kullotje<sup>144</sup>.
- Hartimi i planit vendor për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor dhe mbarështimit të pyjeve dhe kullotave si pjesë e tij nga të gjitha bashkitë.
- Parashikimi i kostove shoqëruese të masave të planit vendor në dokumentin e planifikimit të buxhetit afat-mesëm (PBA)
- Rritja e numrit të punonjësve vendorë për administrimin dhe inspektimin e duhur të Fondit Pyjor dhe Kullor sipas standartit të përcaktuar me ligj.
- Sigurimi i trajnimeve për punonjësit vendorë për të rritur nivelin e profesionalizmit dhe zbatimin efektiv të kompetencave vendore.
- Rekrutimi i specialistëve për administrimin e fondit pyjor dhe kullor të bëhet sipas kërkesave ligjore dhe në nivelin e kuotave të kërkuara.

## Rekomandime

- Mbulimi i territorit bashkiak me stacione monitorimi të ujit, ajrit, tokës ose burimeve të tjera të ndotjes së mjedisit si akustikë, frekuenca telekomunikimi, radioaktivitet, etj.
- Interpretimi i indikatorëve nga ekspertë përkatës dhe publikimi i rregullt i të dhënave për informimin e qytetarëve për situatën mjedisore në territorin ku ata jetojnë.
- Bashkia duhet të botojë një raport vjetor me të dhëna të monitorimit të mjedisit që janë gjithëpërfshirëse dhe këshilluese për qytetarët.
- Përdorimi më i mirë i fondeve për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, pasi organet e vetëqeverisjes vendore vazhdojnë të përballen me fonde të pamjaftueshme dhe në disa raste janë identifikuar disa shkelje duke shkaktuar ndotje të konsiderueshme të hapësirës publike, veçanërisht në shtretërit e lumenjve.
- Hartimi i kritereve të decentralizimit asimetric të çështjeve të ndryshme në interes të qeverisë qendrore në lidhje me mjedisin dhe ndryshimin e klimës në mënyrë që ky funksion të realizohet më mirë.
- Forcimi i bashkëpunimit midis bashkisë dhe qytetarëve për t'i përfshirë ata në aksione për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në veprime që synojnë monitorimin dhe ndikimin e ndotjes së mjedisit nga operatorët ekonomikë, dhe ushtrimi i presionit mbi ta për të ndërmarrë masa për të shmangur ndotjen.

## PËRFUNDIME MBI MJEDISIN DHE NDRYSHIMIN E KLIMËS

**Progres i kufizuar është evidentuar në ushtrimin e funksioneve të NJQV për mbrojtjen e mjedisit**, hartimin e projekteve miqësore me mjedisin dhe ndryshimet klimaterike, grumbullimin e diferencuar të mbetjeve dhe depozitimin e tyre në fusha dhe landfill që përmbushin standartet e BE. Më pak trajnime janë kryer në



vitin 2019 për nëpunësit vendorë për legjislacionin dhe zbatimin e masave të plan veprimit, gjithsej 88 persona nga 77% e bashkive të vendit. Në nivel kombëtar, janë kryer **më shumë fushata ndërgjegjësimi në mbrojtje të mjedisit** dhe minimizimin e ndotjes në bashkëveprim më aktorë të tjerë vendorë dhe OSHC, krahasuar me 2018, gjithsej 332 fushata, ose mesatarisht 5.93. Mbetjet e riciklueshme depozitohen sipas objektivave të planit vendor PVMIM nga 65.6% e bashkive, ose +8 p.p., krahasuar me vitin 2018. Mbeten sfida hartimi i planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve nga të gjitha bashkitë, zbatimi efektiv i masave për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve dhe depozitim të tyre në vende të miratuara dhe me standarte, rritja e nivelit të riciklimit të mbetjeve, forcimi i kapaciteteve të bashkive për monitorimin efektiv të shërbimit të ofruara nga kontraktorë të jashtëm për shërbimin e mbetjeve dhe rritja e ndërgjegjësimit qytetar në mbrojtje të mjedisit.

**Progress të ngadaltë ka patur për sa i përket hartimit të planit të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe marrjen e masave për zbutjen e rreziqeve të ndryshimit të klimës**, 13% e bashkive kanë miratuar Plan Veprimi në nivel vendor me masa për zbutjen e risqeve nga ndryshimet klimatike, që evidenton të njëjtën situatë me vitin 2018. Niveli i pjesëmarrjes së bashkive në trajnime mbi zbatimin e masave të politikave kombëtare për ndryshimet klimatike ka qenë i kufizuar dhe në nivel të krahasueshëm me vitin 2018, gjithsej 19 nëpunës nga 21% e bashkive.


**Progres i kufizuar në raport me vitin 2018 evidentohet lidhur me performancën e bashkive për administrimin e fondit pyjor vendor**, si në nivel planifikimi ashtu për krijimin e databazës për subjektet private dhe kadastrën e pyjeve dhe kullotave: 47.5% e bashkive kanë hartuar planin për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor. Kanë vijuar trajnimet për zhvillimin profesional të punonjësve të fondit pyjor dhe kullosor dhe nëpunësve të bashkive, 426 persona të trajnuar në 2019, ose 7 persona që është një rezultat shumë i mirë; rreth 64% e bashkive kanë ngritur databazën për subjektet që ushtrojnë veprimtari, i cili është në nivel të krahasueshëm me vitin 2018. Zhvillimi legjislacionit me akte nën-ligjore dhe udhëzime do të ndihmojë bashkitë për zbatimin efektiv të ligjit<sup>145</sup> dhe ushtrimin e funksionit mbi administrimin e pyjeve dhe kullotave; mbeten sfida hartimi i planit vendor për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor nga të gjitha bashkitë, parashikimi i tij në dokumentin e buxhetit afat-mesëm (PBA), si dhe rritja e burimeve njerëzore për këtë funksion sipas dispozitave ligjore.

## 3.12 Kapitulli 32: Kontrolli financiar

*“BE promovon reformën e sistemeve të qeverisjes kombëtare për të përmirësuar përgjegjshmërinë menaxheriale, menaxhimin e shëndoshë financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kontrollin e jashtëm të fondeve publike. Gjithashtu, rregullat e kontrollit financiar mbrojnë më tej interesat financiare të BE-së kundër mashtrimit në menaxhimin e fondeve të BE-së dhe euros kundër falsifikimit.*

Shqipëria është përgatitur mesatarisht në këtë fushë. Përparim është arritur me miratimin ligjor të një mekanizmi për koordinim, monitorim dhe raportim të reformave kryesore për qeverisjen e mirë, përfshirë kontrollin e brendshëm financiar publik (PIFC), dhe me miratimin e një qasje të auditimit të jashtëm të bazuar në rreziqet. Sidoqoftë, Shqipëria nuk ka miratuar ende një dokument gjithëpërfshirës i politikave të KBFP (PIFC), që mbetet për tu miratuar dhe të fillojë zbatimin e tij me fokus specifik në përcaktimin dhe zbatimin e përgjegjësive menaxheriale, të sigurojë monitorimin dhe raportimin e koordinuar të të gjitha reformave të

145 Ligji nr.9385/2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar




ndërlidhura, si dhe të sigurojë zbatimin më sistematik të rekomandimeve të auditimit të jashtëm.

Përgjegjësia menaxheriale nuk është ngulitur ende mirë në kulturën administrative. Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin përcakton përgjegjshmërinë vetëm në lidhje me menaxhimin financiar. Legjislacioni për kontrollin e brendshëm është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Menaxhimi i rrezikut është ende në një fazë të hershme; **Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë bërë përparimin më të vogël në përgatitjen e regjistrave të rreziqeve.** Deklaratat e sigurimit (declaration of assurance) nënshkruhen sistematikisht nga zyrtari i lartë i autorizuar, por në mungesë të një kornize të delegimit, kjo mbetet më shumë një ushtrim formal<sup>146</sup>.

Në vitin 2019, janë rritur të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të NJQV, të cilat përfshijnë të ardhurat nga pasuria (ndërtesat), taksa mbi biznesin e vogël dhe taksa lokale; të ardhurat faktike nga taksat dhe tarifatat vendore në vitin 2019 kanë qenë 23,102 Milion lek, ose 5.7% më shumë kundrejt vitit 2018.

- Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë (ndërtesat) në vitin 2019 kanë qenë 5,208 Milion Lek, pa ndryshim rritje kundrejt 2018.
- Të ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogël (BV) kanë qenë në nivelin e 355 milion Lek, me një ritëm ndryshimi prej 12%.
- Të ardhurat nga taksa lokale kanë qenë 17,539 Milion Lek më një ritëm ndryshimi prej 7%.


Grafiku 135: Ndryshimi i të ardhurave vendore, 2007 - 2019



Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar, në 2019, ka qenë në nivelin e 17,632 Milion Leke, me një ritëm ndryshimi prej 6%.

Grafiku 136: Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar, 2010 - 2019



Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


146 Progres Raporti për Shqipërinë i KE (2019), kapitulli 32 'Kontrolli Financiar'

**Niveli i realizimit të të ardhurave të NJQV në 2019 kundrejt planifikimit** vjetor ka variuar ndërmjet bashkive, ndërsa niveli mesatar ka qenë 71.7% (N=54).

Në vitin 2019, niveli i shpenzimeve<sup>147</sup> ka qenë 55,212 Milion Lek, ose 5606 Milion lek më shumë kundrejt 2018 (ose 11.3% më të larta) për të gjitha NJQV:


- Shpenzimet për paga dhe sigurime në vitin 2019 ka qenë 21,838 Milion Lek (ose 39.5% të shpenzimeve të përgjithshme) kundrejt 20,689 Milion Lek në 2018 (ose 41.7% të shpenzimeve të përgjithshme); Shpenzimet për paga dhe sigurime në 2019 kanë qenë -2.1 p.p. më të ulëta krahasuar me 2018.
- Për të gjitha bashkitë (nivel kombëtar), shpenzimet kapitale kanë përberë 31.7% të totali të shpenzimeve në 2019 (17.537 miliardë lekë), krahasuar me 14.2 miliardë lekë ose 28.6% të shpenzimeve të qeverisjes vendore në 2018, ose +3.09 p.p. më të lartë kundrejt 2018.

Grafiku 137: Shpenzimet e NJQV, 2018 - 2019




- Ndërsa në nivel kombëtar, ritmi i ndryshimit të shpenzimeve ka qenë 11.3% në 2019 kundrejt 2018, treguesi varion në një shkallë të gjerë ndërmjet bashkive, nga -33%<sup>148</sup> në 102%<sup>149</sup> (shkalla e ndryshimit në 2018 ka qenë -44% në 50%).


Grafiku 138: Ndryshimi i Shpenzimeve nga NJQV 2019 / 2018



147 Shpenzimet përfshijnë pagat, sigurimet, shpenzime operative, subvencione, të tjera dhe shpenzimet kapitale  
 148 Bashkia Libohovë  
 149 Bashkia Vau i Dejës



Harta 67: Ndryshimi i borxhit të prapambetur të NJQV (2019 / 2018)



- Në nivel kombëtar për të gjitha NJQV, në 2019, **shkalla e realizimit të shpenzimeve kundrejt planifikimit vjetor** ka variuar ndërmjet bashkive, por mesatarisht ka qenë 78.2% (N=55).
- Mesatarisht, rreth 38.7% ka qenë shkalla e proporcionalitetit të alokimit të fondeve të buxhetit vendor për të financuar projektet në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit sipas Planeve të Planifikimit dhe Rregullimit të Territorit, dhe planeve të tjera të veprimit.
- Rreth 27% është mesatarja e **ndryshimit të borxheve të prapambetura** të NJQV ndaj palëve të treta (në vitin 2019 kundrejt 2018).



#### Kutia 14. Vështirësi specifike për planifikimin strategjik dhe shlyerjen e borxheve të prapambetura

**Bashkia Berat:** Nevojë për fuqizimin e Drejtorisë së Zhvillimit Strategjik

**Bashkia Devoll:** Mungesa e planeve të mirëfillta të zhvillimit vendor

**Bashkia Divjakë:** Zbatimi i alokimit të buxhetit dhe rritja e projekteve strategjike

**Bashkia Kavajë:** Rritja e proporcionalitetit të alokimit të fondeve të buxhetit lokal me prioritetet strategjike të dokumenteve strategjike të zhvillimit të Bashkisë

**Bashkia Përmet:** Buxhet i limituar për investime.

**Bashkia Mirditë:** Pamjaftueshmëria e fondeve si rrjedhojë e transfertës së pakushtëzuar jo e mjaftueshme për të realizuar prioritetet e zhvillimit vendor në një shkallë më të lartë; Reduktimi mëtejshëm i borxhit të Bashkisë në vitin pasues.

**Bashkia Roskovec:** Mungesa e planit të përgjithshëm vendor dhe ndarja e të ardhurave sipas qytet/fshat. Vendosja e kesh limitit nga MFE konsistoi në mosshlyerjen e disa detyrimeve ndaj të tretëve.

**Bashkia Sarandë:** Mungesa të fondeve dhe zbatimi i planifikimit territorial dhe planit strategjik të zhvillimit

**Bashkia Shkodër:** Fonde të pamjaftueshme për të financuar projektet të mëdha strategjike. Investimet kapitale kalojnë përtej mundësive dhe kapaciteteve financiare të bashkisë. Programet e zhvillimit kombëtar dhe rajonal të qeverisë duhet të marrin në konsideratë zhvillimin e harmonizuar të rajoneve; nuk ka borxh të prapambetur.

**Bashkia Tropojë:** Fonde të pamjaftueshme për të financuar projektet të mëdha strategjike. Sfidë mbetet shlyerja e borxhit.


**Bashkia Vorë:** Rritja e shkallës së realizimit të të të ardhurave dhe shpenzimeve.

**Bashkia Belsh:** Rritjen e nivelit të të ardhurave për mos krijimin e detyrimeve të prapambetura.

**Bashkia Mallakastër:** Është parashikuar në PBA që borxhi i prapambetur të shlyhet 100% deri 2021.

**Bashkia Klos:** Eliminimi i borxhit të prapambetur.

**Bashkia Ura Vajgurore:** Po punohet që të minimizohet borxhi i prapambetur, që është reflektuar në buxhetin e vitit 2020.



## Problemet dhe sfidat

- Realizimi i të ardhurave të planifikuara për të mundësuar kryerjen e shpenzimeve dhe financimin e investimeve të reja në nivel vendor.
- Kapacitete të dobta të bashkive për planifikimin strategjik dhe menaxhimin e shpenzimeve publike.
- Vonesat dhe limitimi i fondeve në çeljen e llogarive nga ana e Thesarit, dhe vonesat në procedurat e prokurimit krijojnë pengesa në zbatimin e buxhetit dhe realizimin e shpenzimeve.
- Marrja e masave efektive nga NJQV për shlyerjen e borxheve të prapambetura dhe moskrijimin e borxheve të reja.
- Aplikimi efektiv dhe sistematik i parimeve dhe instrumentave për menaxhimin e shëndoshë financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kontrollin në përdorimin e fondeve publike dhe fondeve të BE.

## Rekomandime

- Rritja e kapaciteteve vendore për administrimin efikas të taksave dhe tarifave vendore.
- Vlerësimi i aftësisë së administratave vendore për të arritur potencialin e tyre duke identifikuar kufizimet kryesore të kapacitetit të mbledhjes së taksave të vetëqeverisjes vendore.
- Nxitja e mbledhjes më të madhe të të ardhurave duke rritur kapacitetin vendor për të mbledhur sa më shumë të ardhura vendore, për të analizuar potencialin e tyre dhe për të zbatuar një menaxhim të efektshëm të të ardhurave vendore.
- Hartimi dhe zbatimi i një sistemi të integruar të standardizuar në secilën bashki për sistemin e taksave dhe tarifave vendore. Sistemi i unifikuar jo vetëm që do të standardizojë mënyrën e mbajtjes së të dhënave për detyrimet vendore, por do të prodhojë të dhëna të sakta dhe në kohë reale, duke ndihmuar në këtë mënyrë në rritjen e performancës së mbledhjes së të ardhurave dhe duke kontribuar në kontrollin e brendshëm me qëllim menaxhimin efikas dhe modern të taksave vendore.
- Përgatitja dhe përditësimi i planeve strategjike për të gjitha bashkitë e Shqipërisë dhe përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm bazuar në këto plane strategjike.
- Përgatitja e një dokumenti të mirë dhe informues të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) që bën të mundur që Këshilli Bashkiak dhe qytetarët të kuptojnë lehtësisht se ku investohet buxheti dhe çfarë do të prodhohet (realizohet) në secilin nga ciklet e Programit Buxhetor Afatmesëm.
- Hartimi i raporteve të performancës bazuar në të dhëna jo-financiare (treguesit e performancës) që shpjegojnë shpenzimet buxhetore për 61 bashki si nevojë për të analizuar performancën e bashkisë dhe përqindjen e realizimit të parashikimeve për periudhën e caktuar buxhetore.
- Realizimi i një formati të thjeshtë dhe unik për 61 bashkitë për hartimin dhe realizimin e buxhetit për të lehtësuar leximin dhe analizën e buxhetit nga komuniteti.
- Rritja e aftësive të pushtetit vendor për të përfituar nga fondet e donatorëve ose politikat e huamarrjes së brendshme për financimin e projekteve kapitale.



## PËRFUNDIME MBI KONTROLLIN FINANCIAR

Gjatë vitit 2019, Këshilli Konsultativ për Qeverisjen Vendore ka marrë pjesë në procesin e konsultimit të dy projektligjeve për “Shërbimet e pagesave” dhe “Për investimet”. **Janë rritur të ardhurat nga njësitë e qeverisjes vendore në vitin 2019** me një ritëm ndryshim prej +5.7% krahasuar me vitin 2018, si dhe **shpenzimet e përgjithshme** në një shkallë 11.3% më shumë kundrejt 2018. Bashkitë kanë kryer më shumë investime gjatë 2019 kundrejt 2018, me +3.09 p.p. Mbeten sfida për NJQV rritja e shkallës së proporcionalitetit të planifikimit të fondeve të buxhetit vendor në përputhje me prioritetet strategjike të bashkive, ulja e borxheve të prapambetura ndaj palëve të tretë, aplikimi i instrumentave për përgjegjësinë menaxheriale jo vetëm në lidhje me menaxhimin financiar, menaxhimi i rrezikut nga Njësitë e Qeverisjes Vendore si një rekomandim i KE për Shqipërinë.

